

L I G J  
Nr.8690, datë 16.11.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR MBROJTJEN E  
MJEDISIT DETAR DHE TË ZONËS BREGDETARE TË DETIT MESDHE, SI DHE TË 6  
PROTOKOLLEVE SHOQËRUESE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese”;

1. Protokollin për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së Detit Mesdhe nga mbeturinat e anijeve dhe të aeroplanëve ose nga djegia e tyre në det.
2. Protokollin për bashkëpunimin për të luftuar ndotjen e Detit Mesdhe nga nafta dhe nga substancat e tjera të dëmshme, në raste emergjente.
3. Protokollin për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotjet e veprimtarive të vendosura në tokë
4. Protokollin për zonat specifike të mbrojtura dhe për diversitetin biologjik.
5. Protokollin për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja që shkaktohet nga eksplorimi dhe shfrytëzimi i shelfit kontinental, i shtratit të detit dhe i nëntokës së tij.
6. Protokollin për parandalimin e ndotjes së Detit Mesdhe nga lëvizja ndërkufitare e mbeturinave të rrezikshme dhe nga depozitimi i tyre.

Neni 2

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit të derdhë kontributin financiar vjetor të Republikës së Shqipërisë, detyrim ky që i lind vendit tonë si palë në këtë konventë dhe në protokollet e saj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2815, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

# KONVENTA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DETAR DHE ZONËS BREGDETARE TË DETIT MESDHE

**Barcelonë 1976**

Palët Kontraktuese,

*duke patur parasysh vlerën ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të mjedisit të Detit Mesdhe,*

*të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj trashëgimie të përbashkët, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm,*

*duke njohur rrezikun që i kanoset nga ndotja mjedisit detar, ekuilibrit të tij ekologjik, burimeve dhe përdorimeve legjitime,*

*duke patur parasysh se konventat ekzistuese ndërkombëtare mbi këtë subjekt nuk mbulojnë, megjithë progresin e arritur, të gjitha aspektet dhe burimet e ndotjes detare dhe nuk plotësojnë tërësisht kërkesat e Detit Mesdhe,*

*duke kuptuar tërësisht nevojën për bashkëpunim të ngushtë midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare të interesuara në fushën e koordinimit dhe mirëkuptimit rajonal për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit detar në zonën e Detit Mesdhe,*

*të vetëdijshëm që Plani i Veprimit për Mesdheun që prej miratimit të tij në 1975 dhe gjatë evoluimit të tij ka ndihmuar në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm në rajonin mesdhetar dhe ka përfaqësuar një mjet të fuqishëm dhe dinamik për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me Konventën dhe Protokollet e saj nga Palët Kontraktuese.*

*duke marrë parasysh rezultatët e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, mbajtur në Rio de Zhaneiro, nga 4deri 14 qershor 1992,*

*duke marrë parasysh edhe Deklaratën e Gjenovës 1985, Kartën e Nikosisë 1990, Deklaratën e Kajros 1992 mbi Bashkëpunimin Euro-Mesdhetar mbi mjedisin brenda pellgut mesdhetar, rekomandimet e Konferencës së Kazablankës 1993 dhe Deklaratën e Tunizisë 1994 mbi zhvillimin e qëndrueshëm të Detit Mesdhe,*

*duke patur në mendje dispozitat e Konventes së Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit në Gjirin Montego në 10 dhjetor 1992,*

Ranë dakord si më poshtë.

## **Neni I**

### **Veprimi në hapësirë**

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, Zona e Detit Mesdhe nënkupton ujrat bregdetare të Detit Mesdhe, përfshirë gjiret dhe detet, të kufizuar në perëndim nga meridiani që kalon mespërmes farit të Kepit Spartel në hyrje të ngushticës së Gjibraltarit dhe në Lindje nga kufijtë jugorë të ngushticës së Dardaneleve midis farit Mehmetick dhe Kumkale.

2. Zbatimi i Konventes mund të shtrihet në zonat bregdetare si është përcaktuar nga Palët Kontraktuese brenda territorit të tyre .

3. Çdo protokoll i kësaj Konvente mund të shtrijë hapësirën e veprimit të saj tej mbulimit gjeografik që i përket një protokollit të caktuar.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Konvente

a) “ndotje” nënkupton futjen nga njeriu, direkt ose indirekt, të substancave ose energjisë në mjedisin detar, duke përfshirë dhe grykat e lumenjve, të cilat rezultojnë ose besohet se sjellin efekte të dëmshme për burimet e gjalla në jetën detare, rreziqe për shëndetin e njeriut, pengesa për aktivitetin detar, duke përfshirë peshkimin dhe përdorime të tjera legjitime të detit, dëmtim të cilësisë të ujrave detare dhe pakësim të bukurive pejsazhistike. .

b) “Organizatë” nënkupton grupin përgjegjës të caktuar për zbatimin e funksioneve të sekretariatit në përputhje me nenin 17 të kësaj Konvente.

## **Neni 3**

### **Dispozita të përgjithshme**

1. Gjatë aplikimit të kësaj Konvente dhe të protokolleve të saj, Palët pjesëmarrëse duhet të veprojnë në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

2. Palët pjesëmarrëse mund të hyjnë në marrëveshje dy ose shumë Palëshe, rajonale ose nënrajonale për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore në Detin Mesdhe, me kusht që këto marrëveshje të jenë në përputhje me këtë Konventë, protokollin dhe ligjin ndërkombëtar. Kopje të këtyre marrëveshjeve duhet t'i jepen Organizatës. Aty ku është e përshtatshme, Palët mund të përdorin marrëveshjet ekzistuese të organizatave në Zonën e Detit Mesdhe.

3. Asgjë në këtë Konventë dhe protokollin e saj nuk mund të çenojnë të drejtat dhe pozitën e ndonjë shteti në lidhje me Konventën e OKB-së mbi Ligjin për Detin të 1982.

4. Palët Kontraktuese mund të ndërmarrin iniciativa individuale ose së bashku, në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare, nëpërmjet organizatave përkatëse ndërkombëtare për të nxitur zbatimin e dispozitave të Konventës dhe Protokolleve të saj nga shtete jo Palë.

5. Asgjë në këtë Konventë dhe protokollin e saj nuk mund të ndikojë në imunitetin sovran të luftanijeve apo anijeve të tjera që janë pronë ose drejtohen nga shteti kur ato janë të angazhuara në veprimtari jo tregëtare. Megjithatë, çdo Palë Kontraktuese duhet të sigurojë që anijet dhe flota ajrore që gëzojnë imunitet të pavarur sipas të Drejtës Ndërkombëtare, të veprojnë në përputhje me këtë protokoll.

## **Neni 4**

### **Detyrimet e përgjithshme**

1. Palët Kontraktuese duhet të marrin në mënyrë individuale ose së bashku masat e duhura në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe protokolleve të saj që janë në fuqi në të cilat ato janë Palë për të parandaluar, për të ulur, për të eliminuar sa të jetë e mundur ndotjen e Detit Mesdhe dhe për të mbrojtur e përmirësuar mjedisin detar në këtë zonë me qëllim për të ndikuar në zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

2. Palët Kontraktuese zotohen të ndërmarrin masat e duhura për zbatimin e Planit të Veprimit të Mesdheut, për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të burimeve natyrore të Detit Mesdhe, si pjesë e pandarë e procesit të zhvillimit, duke plotësuar nevojat e brezit të sotshëm dhe të ardhshëm në mënyrën më të drejtë. Për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, Palët Kontraktuese duhet të kenë parasysh rekomandimet e Komisionit Mesdhetar mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm të ngritur në kuadrin e Planit të Veprimit të Mesdheut.

3. Me qëllim që të mbrojnë mjedisin dhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të Zonës së Detit Mesdhe, shtete Palë:

(a) do të zbatojnë sipas mundësive të tyre parimin e parandalimit në bazë të të cilit kur ekzistojnë kërcënime serioze apo dëme të pakthyeshme, mungesa e sigurisë shkencore nuk mund të jetë arsye për të mos marrë masa efektive për pengimin e degradimit të mjedisit;

(b) do të zbatojnë parimin “ndotësi paguan”, sipas të cilit kostoja e parandalimit, kontrollit dhe pakësimit të ndotjes përballohet nga ndotësi në interes të publikut;

(c) do të ndërmarrin vlerësimin e ndikimit të mjedisit për aktivitetet e propozuara që mund të shkaktojnë një ndikim negativ në mjedisin detar dhe i nënshtrohen një autorizimi nga autoritetet kombëtare kompetente;

(d) të nxisë bashkëpunimin ndërmjet shteteve në procedurat e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në lidhje me aktivitetet nën juridiksionin ose kontrollin e tyre që mund të kenë një efekt të madh negativ në mjedisin detar të shteteve të tjera ose zonave që ndodhen jashtë kufijve të juridiksionit kombëtar në bazë të njoftimit, shkëmbimit të informacionit dhe konsultimit;

(e) të angazhohen për të nxitur menaxhimin e integruar të zonave bregdetare, duke marrë parasysh mbrojtjen e zonave me interes ekologjik dhe pejsazhistik dhe përdorimin racional të burimeve natyrore.

4. Në zbatimin e Konventes dhe protokolleve përkatës, Palët Kontraktuese do të:

(a) miratojnë programe dhe masa që përmbajnë, aty ku duhet, afate kohore për përfundimin e tyre;

(b) të përdorin teknikat ekzistuese dhe praktikat mjedisore më të mira dhe të nxisin zbatimin e aksesit dhe transferimin e teknologjive mjedisore, duke përfshirë teknologji prodhimi të pastra, duke marrë parasysh kushtet sociale, ekonomike dhe teknologjike.

5. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në formulimin dhe miratimin e protokolleve, duke parashkruar masat, procedurat dhe standartet e miratuara për zbatimin e kësaj Konvente.

6. Palët Kontraktuese angazhohen që, brenda kufijve ndërkombëtarë të konsideruar në kompetencë të Palëve Kontraktuese, të nxisin masa në lidhje me zbatimin e programeve të zhvillimit, mbrojtjen, ruajtjen dhe rehabilitimin e mjedisit dhe të burimeve mjedisore në zonën e Detit Mesdhe.

## **Neni 5**

### **Ndotja e shkaktuar nga shkarkimet e anijeve, avionëve apo incenerimi/djegia në det**

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, zbutur në shkallën më të lartë, eliminuar ndotjen e zonës së Detit Mesdhe të shkaktuar nga hedhja e mbeturinave të anijeve dhe avionëve ose incenerimet në det.

## **Neni 6**

### **Ndotja nga anijet**

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të parandaluar, zbutur, luftuar në shkallën më të lartë, eliminuar ndotjen e zonës së Detit Mesdhe të shkaktuar nga mbetjet e anijeve dhe për të siguruar zbatimin efektiv në atë zonë të rregullave që në përgjithësi njihen në nivelin ndërkombëtar në lidhje me kontrollin e këtij tipi ndotjeje.

## **Neni 7**

### **Ndotja që rezulton nga eksplorimi dhe shfrytëzimi i shelfit kontinental dhe të shtratit të detit dhe nëntokës së tij**

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, zbutur dhe luftuar në shkallën më të lartë, për të eliminuar ndotjen e Zonës së Detit Mesdhe që shkaktohet nga shfrytëzimi i shelfit kontinental, shtratit të detit dhe nëntokës së tij.

## **Neni 8**

### **Ndotja nga burimet e ndodhura në tokë**

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, zbutur dhe luftuar në shkallën më të lartë për të eliminuar ndotjen e Zonës së Detit Mesdhe dhe për të hartuar dhe zbatuar plane për reduktimin dhe heqjen nga përdorimi i substancave që janë toksike, persistente dhe që shkaktojnë bioakumulim nga burime të vendosura në tokë. Këto masa do të zbatohen:

(a) për ndotjen nga burime të ndodhura në tokë që e kanë origjinën brenda territoreve të Palëve dhe që përfundojnë në det;

- drejtpërsëdrejti nga shkarkimet në det ose nëpërmjet asgjësimit bregdetar;

- tërthorazi nëpërmjet lumenjve, kanaleve ose rrjedhjeve të ujit, duke përfshirë rrjedhjet e ujrave nëntokësore ose infiltrimeve ujore;

(b) për ndotjet nga burime të ndodhura në tokë që transportohen nga atmosfera.

### **Neni 9**

#### **Bashkëpunimi për të përballuar emergjencat e ndotjeve**

1. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në marrjen e masave të nevojshme për të përballuar emergjencat e ndotjeve në Zonën e Detit Mesdhe, cilët do qofshin shkaqet e këtyre emergjencave, dhe për të pakësuar ose eliminuar dëmin e shkaktuar prej tyre.

2. Çdo Palë Kontraktuese që është në dijeni të çfarëdo emergjence ndotjeje në zonën e Detit Mesdhe duhet të njoftojë pa vonesë organizatën dhe nëpërmjet organizatës, ose drejtpërsëdrejti, çdo Palë Kontraktuese që mund të preket nga një emergjencë e tillë.

### **Neni 10**

#### **Ruajtja e diversitetit biologjik**

Palët Kontraktuese, në mënyrë individuale ose bashkërisht, do të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dhe ruajtur diversitetin biologjik, sistemet e rralla ose delikatë si dhe specie të faunës dhe florës së egër të pakësuar, të kërcënuara ose të rrezikuara dhe habitatet e tyre në zonat në të cilat zbatohet kjo konvenetë.

### **Neni 11**

#### **Ndotja që rezulton nga lëvizjet ndërkontinentale të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimi i tyre**

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, zbutur në shkallën më të lartë, për të eliminuar ndotjen e mjedisit që mund të shkaktohet nga lëvizjet ndërkontinentale, asgjësimi i tyre dhe për të ulur në minimum e në qoftë se është e mundur, të eliminojnë lëvizje të tilla ndërkontinentale.

### **Neni 12**

#### **Monitorimi**

1. Palët Kontraktuese do të përpiqen të vendosin, në bashkëpunim të ngushtë me organizmat ndërkombëtare që ato i konsiderojnë kompetente, programe komplementare ose të përbashkëta, duke përfshirë sipas rastit, programe në nivele dyPalëshe ose shumëPalëshe për monitorimin e ndotjes në zonën e Detit Mesdhe dhe do të përpiqen të ngrenë një sistem monitorimi të ndotjes për këtë zonë.

2. Për këtë qëllim, Palët Kontraktuese do të përcaktojnë autoritetet kompetente përgjegjëse për monitorimin e ndotjes brenda zonave nën juridiksionin e tyre kombëtar dhe do të marrin pjesë aq sa të jetë e praktikueshme në takimet ndërkombëtare për monitorimin e ndotjes në zonat jashtë juridiksionit kombëtar.

3. Palët Kontraktuese marrin përsipër të bashkëpunojnë në formulimin, miratimin dhe zbatimin e anekseve të tilla të kësaj konvente siç mund të kërkohet për të parashkruar procedura dhe standarte të përbashkëta për monitorimin e ndotjes.

### **Neni 13**

#### **Bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik**

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër aq sa të jetë e mundur të bashkëpunojnë drejtpërsëdrejti, ose ku është e nevojshme, nëpërmjet organizatave të tjera kompetente rajonale ose ndërkombëtare në fushat e shkencës, teknologjisë dhe të shkëmbëjnë të dhëna si dhe informacion tjetër shkencor për qëllim të kësaj konvente.

2. Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin kërkimin, aksesin dhe transferimin e teknologjive mjedisore, duke përfshirë teknologji prodhimi të pastra dhe të bashkëpunojnë në formulimin, ngritjen dhe zbatimin e proceseve prodhuese të pastra.

3. Palët Kontraktuese marrin përsipër të bashkëpunojnë për sigurimin e asistencës teknike dhe të ndonjë asistence tjetër të mundur në fushat që kanë lidhje me ndotjen e detit, duke i dhënë prioritet nevojave speciale të vendeve në zhvillim në rajonin a Mesdheut.

### **Neni 14**

#### **Legjisalcioni mesdhetar**

1. Palët Kontraktuese do të miratojnë legjislacion për zbatimin e konventes dhe protokolleve.

2. Sekretariati, me kërkesë të Palës Kontraktuese, asiston Palën në hartimin e legjislacionit mjedisor në përputhje me konventen dhe protokollin.

### **Neni 15**

#### **Inforacioni publik dhe pjesëmarrja e publikut**

1. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që autoritetet kompetente t'i japin publikut aksesin e duhur për informacionin në lidhje me gjendjen e mjedisit në fushën e aplikimit të konventes dhe protokolleve, për aktivitetet ose masat që ndikojnë negativisht ose që mund të ndikojnë negativisht dhe për aktivitetet e zbatuara ose masat e marra në përputhje me konventen dhe protokollin.

2. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që publikut t'i jepet mundësia për të marrë pjesë në procesin e marrjes së vendimeve në fushën e zbatimit të konventes dhe protokolleve siç duhet.

3. Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni nuk duhet të paragjykojë të drejtën e Palëve Kontraktuese për të refuzuar, në përputhje me sistemin e tyre ligjor dhe rregulloret ndërkombëtare të zbatueshme, për të siguruar akses për një informacion të tillë mbi bazë (për shkak) të konfidencialitetit, sigurisë publike, procedurave të hetimit, duke deklaruar arsyet për një refuzim të tillë.

### **Neni 16**

#### **Detyrimi dhe përgjegjësia**

Palët Kontraktuese duhet të marrin përsipër të bashkëpunojnë në formulimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave përkatëse për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompensimit për dëmtimin që rezulton nga ndotja e mjedisit detar në zonën e Detit Mesdhe.

### **Neni 17**

#### **Rregullimet institucionale**

Palët Kontraktuese caktojnë Programin e Mjedisit të Kombeve të Bashkuara (UNEP) si përgjegjës për funksionet e sekretariatit si më poshtë:

(i) të thërrasë dhe të përgatisë mbledhjet e Palëve Kontraktuese dhe konferencat e parashikuara në nenet 18, 21, dhe 22;

- (ii) t'u transmetojë Palëve Kontraktuese njoftimet, raportet dhe informacione të tjera të marra në përputhje me nenet 3, 9 dhe 26;
- (iii) të marrë, të shqyrtojë dhe t'u përgjigjet kërkesave dhe informacioneve nga Palët Kontraktuese;
- (iv) të marrë, të shqyrtojë dhe t'u përgjigjet kërkesave dhe informacioneve nga organizatat joqeveritare dhe publiku kur lidhen me tema të një interesi të përbashkët ose me aktivitete të organizuara në nivel rajonal: në këtë rast duhet të mblidhen Palët Kontraktuese përkatëse.
- (v) të kryejë funksionet e ngarkuara nga protokollet e kësaj konvente;
- (vi) t'u raportojë rregullisht Palëve Kontraktuese për zbatimin e konventes dhe protokolleve,
- (vii) të kryejë funksione të tjera që mund t'i ngarkohen nga Palët Kontraktuese;
- (viii) të sigurojë koordinimin e nevojshëm me organizma të tjerë ndërkombëtarë që Palët Kontraktuese i quajnë kompetente dhe në veçanti, të hyjë në rregullime administrative siç mund të kërkohet për kryerjen efektive të funksioneve të sekretariatit.

## **Neni 18**

### **Mbledhjet e Palëve Kontraktuese**

1. Palët Kontraktuese do të mbajnë mbledhje të zakonshme një herë në dy vjet dhe mbledhje të jashtëzakonshme kur mendohet e nevojshme, me kërkesë të organizatës ose me kërkesë të një Pale Kontraktuese, me kusht që kërkesa të tilla të mbështeten të paktën nga Palët Kontraktuese.

2. Do të jetë funksion i mbledhjeve të Palëve Kontraktuese të vëzhgojnë zbatimin e kësaj konvente e protokollet dhe në mënyrë të vecantë:

- (i) të shqyrtojnë në përgjithësi inventaret e kryera nga Palët Kontraktuese dhe organizatat ndërkombëtare kompetente për gjendjen e ndotjes së detit dhe efektet e saj në zonën e Detit Mesdhe;
- (ii) të shqyrtojnë raportet e paraqitura nga Palët Kontraktuese sipas nenit 26;
- (iii) të miratojnë, shqyrtojnë dhe ndryshojnë sipas nevojës anekset e kësaj kon-vente dhe protokolleve në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 23,
- (iv) të bëjnë rekomandime në lidhje me miratimin e protokolleve shtesë ose të ndonjë ndryshimi të kësaj konvente ose protokolleve në përputhje me nenet 21 dhe 22;
- (v) të ngrejë grupe pune sipas nevojës për të shqyrtuar çështje që kanë lidhje me këtë konvente, protokollet dhe anekset;
- (vi) të shqyrtojnë dhe të ndërmarrin masa shtesë që mund të duhen për arritjen e qëllimeve të kësaj konvente dhe protokolleve;
- (vii) të miratojnë buxhetin e programit.

## **Neni 19**

### **Byroja**

1. Byroja e Palëve Kontraktuese do të përbëhet nga përfaqësues të Palëve Kontraktuese të zgjedhura nga mbledhjet e Palëve Kontraktuese. Në zgjedhjen e anëtarëve të byrosë, mbledhjet e Palëve Kontraktuese do të respektojnë parimin e shpërndarjes gjeografike të barabartë.

2. Funksionet e byrosë, termat dhe kushtet sipas së cilave do të veprojnë, do të përcaktohen në rregulloret e procedurës të miratuara nga mbledhjet e Palëve Kontraktuese

## **Neni 20**

### **Vëzhguesit**

1. Palët Kontraktuese mund të vendosin të pranojnë si vëzhgues në mbledhjet dhe konferencat e tyre:  
(a) çdo shtet që nuk është Palë Kontraktuese e konventes;  
(b) çdo organizatë ndërkombëtare ose organizatë joqeveritare, aktivitete të cilave kanë lidhje me konventen;

2. Vëzhgues të tillë mund të marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote dhe mund të paraqesin çdo informacion ose raport që ka lidhje me objektivat e konventes;

3. Kushtet për pranimin dhe pjesëmarrjen e vëzhguesve do përcaktohen në rregullat e procedurës të miratuara nga Palët Kontraktuese.

## **Neni 21**

### **Miratimi i protokolleve shtesë**

1. Palët Kontraktuese në një konferencë diplomatike mund të miratojnë protokolle shtesë të kësaj konvente në përputhje me paragrafin pesë të nenit 4

2. Konferenca diplomatike me qëllim miratimin e protokolleve shtesë, do të thirret nga organizata me kërkesë të dy të tretave të Palëve Kontraktuese.

## **Neni 22**

### **Amendamentet e Konventës ose të protokolleve**

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë amendamente për konventën. Amendamentet do të miratohen nga një konferencë diplomatike që do të mbahet nga organizata me kërkesë të dy të tretave të Palëve Kontraktuese.

2. Çdo Palë Kontraktuese e kësaj konvente mund të propozojë amendamente për çdo protokoll. Amendamente të tilla do të miratohen nga një konferencë diplomatike që do të thirret nga organizata me kërkesë të dy të tretave të Palëve Kontraktuese për protokollin përkatës.

3. Amendamentet e kësaj konvente duhet të miratohen nga votat e tre të katërtave të shumicës së Palëve Kontraktuese të konventes që përfaqësohen në konferencë diplomatike dhe do të paraqiten nga sekretaria për pranim nga të gjitha Palët Kontraktuese të konventes. Amendamentet për çdo protokoll do të miratohen me votën e tre të katërtave të shumicës së Palëve Kontraktuese për këtë protokoll që përfaqësohen në konferencë diplomatike dhe do t'u paraqiten nga sekretaria për miratim Palëve Kontraktuese për këtë protokoll.

4. Pranimi i amendamenteve njoftohet me shkrim në sekretari. Amendamentet e miratuara në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni duhet të hyjnë në fuqi midis Palëve Kontraktuese që kanë pranuar amendamente të tilla brenda tridhjetë ditëve pas marrjes nga sekretaria të njoftimit të pranimi të tyre nga të paktën tre të katërtat e Palëve Kontraktuese të kësaj konvente ose të protokollit përkatës, sipas rastit.

5. Pas hyrjes në fuqi të çdo amendamenti të kësaj konvente ose të çdo protokollit, çdo Palë Kontraktuese e kësaj konvente ose protokollit, duhet të bëhet Palë Kontraktuese në dokument siç amendohet.

## **Neni 23**

### **Anekset dhe amendamentet e anekseve**

1. Anekset e kësaj konvente ose të çdo protokollit duhet të formojnë një pjesë integrale të konventes ose të protokollit, sipas rastit.

2. Përveç atyre që mund të parashikohen ndryshe në çdo protokoll, procedurat në vazhdim duhet të zbatohen për miratimin dhe hyrjen në fuqi të çdo amendamenti të anekseve të kësaj konvente ose të çdo protokollit, me përjashtim të amendamenteve të aneksit të arbitrazhit.

(i) Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë amendamente në anekset e kësaj konvente ose të çdo protokollit në mbledhjet e përmendura në nenin 18;

(ii) Amendamente të tilla duhet të miratohen me shumicë vote të tre të katërtave të Palëve Kontraktuese për dokumentin në fjalë;

(iii) Sekretaria duhet t'u komunikojë pa vonesë amendamentet e miratuara të gjitha Palëve Kontraktuese;

(iv) Çdo Palë Kontraktuese që nuk mund të miratojë një amendament të anekseve të kësaj konvente ose të çdo protokollit, duhet të njoftojë me shkrim në sekretari brenda periudhës së përcaktuar nga Palët Kontraktuese të interesuara kur miratohet amendamenti:



(v) Sekretaria duhet të lajmërojë pa vonesë të gjitha Palët Kontraktuese për çdo njoftim të marrë në përputhje me nënparagrafin e mësipërm;

(vi) Në mbarim të periudhës të referuar në nënparagrafin (iv) më sipër, amendamenti i aneksit hyn në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese të konventes ose të protokollit përkatës, të cilat nuk kanë paraqitur një njoftim në përputhje me klauzolat e këtij nënparagrafi.

3. Miratimi ose hyrja në fuqi e një aneksi të ri të kësaj konvente ose të çdo protokollit duhet t'i nënshtrohet të njëjtave procedura si për miratimin dhe hyrjen në fuqi të çdo amendamenti të një aneksi në përputhje me kushtet e paragrafit 2 të këtij neni, me kusht që, në qoftë se përfshihet ndonjë amendament në konvente ose në protokollin përkatës, aneksi i ri nuk duhet të hyjë në fuqi për sa kohë që do t'i duhet amendamentit të hyjë në fuqi në konvente ose në protokollin përkatës.

4. Amendamentet në aneksin e arbitrazhit duhet të konsiderohen si amendamente në këtë konvente dhe duhet të propozohen dhe miratohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 22 më sipër.

## **Neni 24**

### **Rregullat e procedurave dhe rregullat financiare**

1. Palët Kontraktuese duhet të miratojnë rregullat e procedurave për mbledhjet dhe konferencat e tyre të parashikuara në nenet 18, 21 dhe 22 më sipër.

2. Palët Kontraktuese duhet të miratojnë rregullat financiare, të përgatitura në konsultim me organizatën, për të përcaktuar në veçanti pjesëmarrjen e tyre financiare në thesar (Trust Fund).

## **Neni 25**

### **Ushtrim i veçantë i të drejtës për votim**

Brenda kufijve të kompetencave të tyre, Komuniteti Ekonomik Evropian dhe çdo grupim ekonomik rajonal i referuar në nenin 30 të kësaj konvente duhet të ushtrojë të drejtën e tij të votimit me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtarë të cilët janë Palë Kontraktuese të kësaj konvente dhe të një ose më shumë protokolleve; Komuniteti Ekonomik Evropian dhe çdo grupim, siç është referuar më sipër, nuk duhet të ushtrojë të drejtën e votës në rastet kur shtetet anëtarë të interesuara e ushtrojnë atë dhe anasjelltas.

## **Neni 26**

### **Raportet**

1. Palët Kontraktuese duhet të paraqesin në organizatë raportet për:

(a) masat ligjore, administrative ose masa të tjera të marra prej tyre për zbatimin e kësaj konvente, protokolleve dhe të rekomandimeve të miratuara në mbledhjet e tyre.

(b) efektivitetin e masave të referuara në nënparagrafin (a) dhe problemet e ndeshura në zbatimin e instrumentave siç përmendet më lart.

2. Raportet duhet të paraqiten në formë dhe intervale të tilla forme siç mund të përcaktohen në mbledhjet e Palëve Kontraktuese.

## **Neni 27**

### **Kontrolli i përputhjes**

Mbledhjet e Palëve Kontraktuese, në bazë të raporteve periodike të referuara në nenin 26 dhe çdo raport tjetër të paraqitur nga Palët Kontraktuese, duhet të vlersojnë përputhjen me konventen dhe protokollin si dhe me masat dhe rekomandimet. Ato duhet të rekomandojnë, kur është e përshtatshme, hapat e nevojshëm për të kryer përputhjen e plotë me konventen dhe protokollin dhe të nxisin zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve.

## **Neni 28**

### **Zgjidhja e kundërshtimeve**

1. Në rastet e kundërshtimeve midis Palëve Kontraktuese si në interpretimin dhe në zbatimin e kësaj Konvente ose Protokolleve, ato duhet t'i zgjidhin kundërshti-met nëpërmjet negociatave ose çdo mjeti tjetër paqësor të zgjedhur prej tyre.

2. Në qoftë se Palët e interesuara nuk zgjidhin dot kundërshtimet midis tyre të përmendura në paragrafin e mësipërm, kundërshtimet duhet të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në aneksin A të kësaj konvente.

3. Megjithatë, Palët Kontraktuese mund të deklarojnë në çdo kohë që ato njohin si *ipso facto* të detyrueshme dhe pa marrëveshje të veçantë, në lidhje me çdo Palë tjetër që pranon të njëjtin detyrim, zbatimin e procedurës së arbitrazhit në përputhje me klauzolat e aneksit A. Deklarime të tilla duhet të njoftohen me shkrim në sekretari, e cila duhet t'ua komunikojë atë Palëve të tjera.

## **Neni 29**

### **Lidhjet midis Konventës dhe protokolleve**

1. Askush nuk mund të bëhet Palë Kontraktuese e Konventes, pa u bërë në të njëjtën kohë Palë Kontraktuese të paktën në një prej protokolleve. Askush nuk mund të bëhet Palë Kontraktuese e një protokollit në qoftë se nuk është apo nuk bëhet në të njëjtën kohë Palë Kontraktuese e kësaj konvente.

2. Çdo protokoll në këtë konvente duhet të jetë i detyrueshëm vetëm për Palët Kontraktuese të protokollit në fjalë.

3. Vendimet që kanë të bëjnë me çdo protokoll në përputhje me nenet 18, 22 dhe 23 të kësaj konvente duhet të merren vetëm nga Palët e protokollit përkatës.

## **Neni 30**

### **Firmosja**

Në Konvente, protokollit për parandalimin e ndotjeve të Detit Mesdhe nga shkarkimet e anijeve dhe të avionëve dhe protokollit që ka të bëjë me bashkë-punimin në luftën ndaj ndotjeve të Detit Mesdhe nga nafta dhe substanca të tjera të dëmshme në rastet e emergjencës, duhet të jenë të hapura për firmosje në Barcelonë në 16 shkurt 1976 dhe në Madrid nga 17 shkurti 1976 në 16 shkurt 1977 nga çdo shtet i ftuar si pjesëmarrës në Konferencën e të Plotfuqishmëve të Shteteve Bregdetare të Rajonit të Mesdheut në Mbrojtjen e Detit Mesdhe, të mbajtur në Barcelonë nga 2-16 shkurti 1976, dhe nga shtetet që kanë të drejtën të firmosin çdo protokoll në përputhje me klauzolat e këtyre protokolleve. Ato duhet të jenë të hapura deri në të njëjtën datë për t'u firmosur nga Komuniteti Ekonomik Evropian dhe nga çdo grupim i ngjashëm ekonomik rajonal ku të paktën një anëtar i tij është shtet i bregdetit të zonës së Detit Mesdhe dhe i cili ushtron kompetencë në fushat që mbulon kjo Konvente, si dhe nga çdo protokoll që vepron mbi to.

## **Neni 31**

### **Ratifikimi, pranimi ose aprovimi**

Kjo Konvente e sidomos çdo protokoll i saj, duhet t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose aprovimi. Instrumentat e ratifikimit, pranimi ose aprovimi duhet të depozitohen në Qeverinë e Spanjës, e cila do të këtë funksionin e sekretarisë.

## **Neni 32**

### **Afrimi**

1. Meqenëse nga 17 shkurti 1977, kjo Konvente, Protokollit për Parandalimin e ndotjeve të Detit Mesdhe nga shkarkimet e anijeve dhe të avionëve si dhe protokollit që ka të bëjë me bashkëpunimin në luftën ndaj ndotjeve të Detit Mesdhe nga nafta dhe substanca të tjera të dëmshme në rastet e emergjencës, duhet të jenë të hapura për të hyrë për shtetet, Komunitetin Ekonomik Evropian dhe çdo grupim siç referohet në nenin 30.

2. Pas hyrjes në fuqi të Konventes ose të çdo Protokollit, çdo shtet që nuk përmendet në nenin 30, mund të hyjë në këtë Konventë dhe çdo Protokoll, me kusht që të miratohet nga tre të katërtat të Palëve Kontraktuese të protokollit të interesuar.

3. Instrumentat e hyrjes duhet të depozitohen në sekretari.

### **Neni 33**

#### **Hyrja në fuqi**

I . Kjo konventë do të hyjë në fuqi në të njëjtën datë kur hyn në fuqi protokollit i parë.

2. Konventa duhet gjithashtu të hyjë në fuqi në lidhje me shtetet, Komunitetin Ekonomik Evropian dhe çdo grupim ekonomik rajonal të përmendur në nenin 30, në qoftë se ato kanë përmbushur kërkesat formale për t'u bërë Palë Kontraktuese të çdo protokollit tjetër që nuk ka hyrë në fuqi.

3. Çdo protokoll i kësaj konvente, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë protokoll, duhet të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë nga data e depozitimit të paktën të gjashtë instrumentave të ratifikimit, pranimit apo aprovimit, ose afrimit me një protokoll të tillë nga Palët e përmendura në nenin 30.

4. Që nga kjo kohë, kjo konventë dhe çdo protokoll duhet të hyjë në fuqi në lidhje me çdo shtet, Komunitetin Ekonomik Evropian dhe çdo grupim ekonomik rajonal të përmendur në nenin 30, në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentave të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo afrimit.

### **Neni 34**

#### **Tërheqja**

I . Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga konventa me anë të dhënies së një njoftimi me shkrim për tërheqje, në çfarëdo kohë pas tre vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj konvente.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund të largohet, në çdo kohë pas tre vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të atij protokollit, me anë të dhënies së një njoftimi me shkrim për tërheqje, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ndonjë protokoll të kësaj konvente.

3. Tërheqja hyn në fuqi 90 ditë nga data që sekretaria ka marrë njoftimin e tërheqjes.

4. Çdo Palë Kontraktuese që tërhiqet nga konventa duhet të konsiderohet e tërhequr nga çdo protokoll ku është Palë.

5. Çdo Palë Kontraktuese e cila, nëpërmjet largimit të saj nga një protokoll, nuk është më Palë në çdo protokoll të kësaj konvente, duhet të konsiderohet e tërhequr nga kjo konventë.

### **Neni 35**

#### **Përgjegjësitë e Sekretarisë**

1. Sekretaria duhet të informojë Palët Kontraktuese, dhe çdo Palë tjetër të përmendur në nenin 30 dhe organizatën:

(i) për firmosjen e kësaj konvente dhe sidomos të çdo protokollit dhe për depozitimin e instrumentave të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo afrimit sipas nenit 30, 31 dhe 32;

(ii) Për datën në të cilën Konventa dhe çdo Protokoll do të hyjë në fuqi sipas kushteve të nenit 33;

(iii) për njoftimet e tërheqjes të bëra sipas nenit 34;

(iv) për amendamentet e miratuara lidhur me Konventën dhe çdo Protokoll, pranimin e tyre nga Palët Kontraktuese dhe datën e hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve sipas klauzolave në nenin 22;

(v) për miratimin e anekseve të reja dhe të amendamentit të çdo aneksi sipas nenit 23;

(vi) Për deklaratimet që njohin si të detyrueshme zbatimet e procedurave të arbitrazhit të përmendura në paragrafin 3 të nenit 28.

2. Origjinali i kësaj konvente dhe sidomos i çdo protokollit duhet të depozitohet në sekretari, Qeverinë e Spanjës, të cilat duhet t'i dërgojnë kopjet e tyre Palëve Kontraktuese, organizatës, dhe Sekretarisë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim sipas nenit 102 të Kartës të Kombeve të Bashkuara.

Në prani të Palëve, nënshkruesi me autorizim të qeverisë së tij, ka firmosur konventen,

Bërë në Barcelonë në 16 shkurt 1976 në një kopje të vetme në gjuhët Arabisht, Anglisht, Frëngjisht dhe Spanjisht, ku të katër tekstet janë ekuivalentë.

## **ANEKSI A**

### **ARBITRAZHI**

#### **Neni 1**

Në qoftë se Palët në konflikt nuk vendosin ndryshe, procedurat e arbitrazhit duhet të kryhen në përputhje me klauzolat e këtij aneksi.

#### **Neni 2**

1. Me kërkesën e adresuar nga njëra Palë Kontraktuese ose tjetra Palë Kontraktuese, sipas kushteve të paragrafit 2 ose 3 të nenit 28 të konventes, duhet të ngrihet një gjykatë arbitrazhi. Kërkesa për arbitrazh duhet të jetë për çështje të aplikimit duke përfshirë, në veçanti, nenet e konventes ose të protokollit, interpretimi apo aplikimi i të cilit është në konflikt.

2. Pala ankuese duhet të informojë organizatën që ka kërkuar ngritjen e Gjykatës së Arbitrazhit, emrin e Palës tjetër në konflikt dhe nenet e konventes ose të protokollit, interpretimi apo aplikimi i të cilave, sipas mendimit të tij, është i kundërshtueshëm. Organizata, këtë informacion të marrë, duhet t'ua nisë të gjitha Palëve Kontraktuese të konventes.

#### **Neni 3**

Gjykata e arbitrazhit duhet të përbëhet nga tre anëtarë: secila prej Palëve kundërshtare duhet të emërojë një gjykatës; dy gjykatësit e emëruar në këtë mënyrë duhet të caktojnë me miratim të përbashkët gjykatësin e tretë, i cili duhet të jetë kryetari i gjykatës. Ky i fundit nuk duhet të jetë bashkëkombës i njërit prej Palëve kundërshtare, as të këtë residencë në një nga territoret e këtyre Palëve, as të jetë i punësuar nga njëri prej tyre, as të ketë të bëjë me çështjen në ndonjë detyrë tjetër.

#### **Neni 4**

1. Në qoftë se kryetari i gjykatës së arbitrazhit nuk është emëruar brenda dy muajve nga emërimi i gjykatësit të dytë, me kërkesën e shumicës së Palëve aktive, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet ta emërojë brenda periudhës së dy muajve pasardhës.

2. Në qoftë se njëra nga Palët kundërshtare nuk emëron një gjykatës brenda dy muajve nga marrja e kërkesës, pala tjetër mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara i cili do të emërojë kryetarin e gjykatës së arbitrazhit brenda periudhës së dy muajve pasues. Me emërimin e tij, kryetari i gjykatës së arbitrazhit duhet t'i kërkojë Palës që nuk ka emëruar gjykatës, ta bëjë këtë brenda dy muajve. Pas kësaj periudhe, ai duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet ta bëjë këtë emërim brenda periudhës së dy muajve të ardhshëm.

#### **Neni 5**

1. Gjykata e arbitrazhit duhet të vendosë sipas rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare dhe në veçanti, të atyre të kësaj konvente apo të protokolleve që lidhen me të.

2. Çdo gjykatë arbitrazhi e ngritur sipas klauzolave të këtij aneksi duhet të vendosë rregullat e veta të procedurës.

#### **Neni 6**

1. Vendimet e gjykatës së arbitrazhit, si në procedurë dhe në substancë, do të merren me shumicë votash të anëtarëve.

2. Gjykata mund të marrë gjithë masat e duhura me qëllim që të gjejë faktet. Me kërkesë të njëjës prej Palëve, mund të rekomandojë masa të përkohshme esenciale për mbrojtje.

3. Në qoftë se dy apo më shumë gjykata arbitrazhi, të ngritura sipas klauzolave të këtij aneksi kanë kërkesë me subjekt identik ose të ngjashëm, ato mund të informojnë njëra tjetrën për procedurat e gjetjes së fakteve dhe t'i marrin ato në konsideratë sa më shpejt të jetë e mundur.

4. Palët në konflikt duhet të sigurojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për realizimin efektiv të procedurave.

5. Mungesa apo mosparaqitja e njëjës Palë kundërshtare nuk duhet të çojë në ndalimin e procedurave.

#### **Neni 7**

1. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të shoqërohet me dhënien e arsyeve. Ai duhet të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët që kanë mosmarrëveshje.

2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve lidhur me interpretimin ose ekzekutimin e vendimit mund t'i paraqitet nga Palët më këmbëngulëse gjykate së arbitrazhit e cila mori vendimin ose, në qoftë se kjo e fundit nuk është e disponueshme, një gjykatë tjetër arbitrazhi për këtë qëllim në të njëjtën mënyrë si e para.

#### **Neni 8**

Komuniteti Ekonomik Evropian dhe çdo grupim rajonal ekonomik sipas nenit 30 të konventes, si çdo Palë Kontraktuese në konvente, ka fuqi të plota të paraqitet si ankues ose si përgjegjës para gjykatës së arbitrazhit.

## **PROTOKOLLI PËR PARANDALIMIN DHE ELEMIMIN E NDOTJES SË DETIT MESDHE NGA SHKARKIMET E ANIJEVE DHE AVIONËVE OSE DJEGIA NË DET\***

Palët Kontraktuese të këtij protokollit,

duke qenë Palë në Konventen për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër ndotjes,

duke njohur rrezikun që i kanoset mjedisit detar nga hedhja ose djegia e mbeturinave ose lëndëve të tjera,

duke patur parasysh që shtetet bregdetare të Detit Mesdhe kanë një interes të përbashkët për të mbrojtur mjedisin detar nga ky rrezik,

duke kujtuar që Kapitulli 17 i Axhendës 21 të UNCED u kërkon Palëve Kontraktuese në Konventen për Parandalimin e Ndotjes Detare nga Shkarkimi i Mbetjeve dhe Lëndëve të tjera (Londër, 1972) të marrin masat e nevojshme për të ndaluar depozitimin në oqean dhe djegien e substancave të rrezikshme,

duke patur parasysh Rezolutat LC 49 (16) dhe LC 50 (16), miratuar nga Mbledhja Konsultative e 16-të e Konventes së Londrës e vitit 1972, e cila ndalon depozitimin dhe djegien e mbetjeve industriale në det,

kanë rënë dakort si më poshtë:

### **Neni 1**

Palët Kontraktuese në këtë protokoll (që më poshtë do të quhen “Palët”) do të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, ulur dhe mënjeluar në maksimum ndotjen e mundshme të Detit Mesdhe të shkaktuar nga shkarkimet prej anijeve dhe avionët ose djegia në det.

### **Neni 2**

Zona ku ky protokoll zbatohet do të jetë Rajoni i Detit Mesdhe siç përcaktohet në nenin 1 të Konventes për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (pas kësaj referuar si “Konventa”).

\* Protokollin për Parandalimin e Ndotjes në Detin Mesdhe nga Shkarkimet e Anijeve dhe Avionëve (Dumping Protokoll) u pranua në 16 shkurt 1976 nga Konferenca e të Plotfuqishmëve të Vendeve Bregdetare të Rajonit Mesdhetar për Mbrojtjen e Detit Mesdhe, mbajtur në Barcelonë. Protokollin hyri në fuqi më 12 shkurt 1978.

Protokollin origjinal u modifikua nga amendamentet e miratuara në 10 Qershor 1995 nga Konferenca e të Plotfuqishmëve të Konventes për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes dhe Protokolleve të saj, mbajtur në 9 dhe 10 qershor 1995 (UNEP (OCA)/ MED/ IG/7). Protokollin i përmirësuar, i regjistruar si “Protokollin për Parandalimin dhe Mënjanimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Shkarkimet prej Anijeve dhe Avionëve ose Djegia në Det”, nuk ka hyrë akoma në fuqi.

### **Neni 3**

Për qëllimet e këtij Protokollin:

1. “Anije dhe Avion” do të kuptohet çdo lloj mjeti lëvizës në ujë ose në ajër i çdo lloji tipi. Kjo shprehje nënkupton çdo lloj mjeti lëvizës në ajër ose ujë, që përdor vetë lëndë djegëse ose jo, dhe platformat ose strukturat e tjera në det dhe pajisjet e tyre të ndërtuara nga njeriu.

2. “Mbetje ose lëndë të tjera” do të thotë materiale ose substanca të çdo lloji, forme apo paraqitjeje.

3. “Shkarkim” do të thotë:

(a) Çdo asgjësim i qëllimshëm i kryer në det i mbeturinave ose lëndëve të tjera prej anijeve ose avionëve ;

(b) Çdo asgjësim i qëllimshëm i kryer nga anijet ose avionët në det;

(c) Çdo asgjësim i qëllimshëm ose ruajtje dhe varrim i mbetjeve ose lëndëve të tjera në shtratin e detit ose në shtresën në sipërfaqen tokësore të detit nga anijet ose avionët.

4. “Shkarkimi” nuk përfshin

(a) Asgjësimin në det të mbetjeve ose lëndëve të tjera të lidhura me funksionimin normal të mjeteve detare ose avionëve dhe pajisjeve të tyre, ndryshe nga mbetjet ose lëndë të tjera të transportuara nga mjetet ose avionët që punojnë për të asgjësuar lëndë të tilla, ose që rrjedhin nga trajtimi i këtyre mbetjeve ose lëndëve të tjera në këto mjete detare ose avionë,

(b) Vendosja e materialeve për qëllime të tjera përveç asgjësimit të thjeshtë të tyre, me kusht që kjo vendosje të mos jetë në kundërshtim me qëllimet e kësaj Konvente.

5. “Djegia në det” do të thotë djegia e qëllimshme e mbetjeve ose lëndëve të tjera në ujrat detare të Detit Mesdhe, duke synuar shkatërrimin termik dhe nuk përfshin aktivitetet që lidhen me operimin normal të anijeve ose avionëve.

6. “Organizatë” do të thotë organizëm që përmendet në nenin 17 të Konventes.

### **Neni 4.**

1. Ndalohet hedhja e mbetjeve ose lëndëve të tjera, duke përjashtuar ato të listuara në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Më poshtë është lista që i referohet paragrafit të mësipërm:

- (a) Materiali i thellimit (nga dragat);
- (b) Mbetje të peshkut ose të materialeve organike që rrjedhin nga përpunimi i peshkut ose organizmave të tjera detare
- (c) Mjetet detare, deri në 31 Dhjetor 2000;
- (d) Platformat ose strukturat e tjera të prodhuara nga njeriu, me kusht që materialet që krijojnë hedhurina që mund të notojnë ose që ndryshe kontribuojnë në ndotjen e mjedisit detar janë shmangur në maksimum , pa cënuar klauzolat e protokollit që lidhen me Ndotjen që Rezulton nga Kërkimi dhe Shfrytëzimi i Shelfit Kontinental, Shtratit të Detit dhe nënshtresës së tij,
- (e) materialet gjeologjike inerte të pakontaminuar, a përbërësit kimikë të cilëve mund të çlirohen në mjedisin detar.

#### **Neni 5**

Hedhja e mbetjeve ose lëndëve të tjera të listuara në nenin 4.2 kërkon paraprakisht një leje speciale nga autoritetet kompetente kombëtare.

#### **Neni 6**

1. Leja e cituar në nenin 5 do të lëshohet vetëm pas një shqyrtimi shumë të kujdesshëm të gjithë faktorëve të parashtruar në aneksin e këtij protokollit ose në kriteret, udhëzimet dhe procedurat e përshtatshme të miratuara nga Palët Kontraktuese duke ndjekur paragrafin 2 më poshtë:

2. Palët Kontraktuese do të hartojnë dhe miratojnë kriteret, udhëzime dhe procedura për hedhjen e mbeturinave ose lëndëve të tjera të listuara në nenin 4.2 në mënyrë që të parandalojnë, ulin dhe shmangin ndotjen.

#### **Neni 7**

Ndalohej djegia në det.

#### **Neni 8**

Dispozitat e neneve 4, 5 dhe 6 nuk do të zbatohen në rastin e forcave madhore për shkak të motit ose ndonjë arsye tjetër kur kërcënohet jeta e njeriut ose siguria e një anijeje ose një avioni. Të tilla shkarkime menjëherë duhet t'i raportohen organizatës dhe ose nëpërmjet organizatës, ose direkt, çdo Pale ose Palëve që mund të preken bashkë me të gjitha detajet e rrethanave, natyrës dhe sasive të mbetjeve ose lëndëve të tjera të hedhura.

#### **Neni 9**

Në qoftë se një Palë, në një situatë kritike të një natyre të jashtëzakonshme, vlerëson se mbetjet ose lëndët e tjera që nuk përmenden në nenin 4.2 të këtij protokollit nuk mund të asgjësohen në tokë me rrezik ose dëmtim të pranueshëm, mbi të gjitha për sigurinë e jetës njerëzore, pala në fjalë, duhet të konsultohet me organizatën. Organizata, pasi të konsultohet me Palët e këtij protokollit, do të rekomandojë metodat e ruajtjes ose mënyrat më të kënaqshme të shkatërrimit ose asgjësimit në rrethanat që ekzistojnë. Pala duhet të informojë organizatën mbi hapat e marrë në përputhje me këto rekomandime. Palët zotohen të ndihmojnë njëra tjetrën në situata të tilla.

#### **Neni 10**

1. Çdo Palë duhet të caktojë një ose më shumë autoritete kompetente për:
  - (a) të nxjerrë lejet e nevojshme për nenin 5;
  - (b) të regjistrojë natyrën dhe sasinë e mbetjeve ose lëndëve të tjera të lejuara për t'u depozituar dhe për vendndodhjen, datën dhe metodën e depozitimit.
2. (a) Autoritetet kompetente të çdo pale duhet të nxjerrin lejet e nevojshme për aktivitetet që përfshihen në nenin 5 lidhur me mbetjet ose lëndët e tjera që synohet të shkarkohen të ngarkuara në territorin e tij;
- (b) të ngarkuara nga një anije ose avion i regjistruar në territorin e tij ose që mban flamurin e tij, kur ngarkimi ndodh në territorin e një shteti që nuk është Palë në këtë protokoll.

### **Neni 11**

Çdo Palë duhet të zbatojë masat e kërkuara për të zbatuar këtë protokoll për:

- (a) të gjitha anijet ose avionët e regjistruar në territorin e tij ose që mbajnë flamurin e tij;
- (b) të gjitha anijet dhe avionët që ngarkojnë në territorin e tij mbeturina ose lëndë të tjera që duhet të depozitohen / shkarkohen.
- (c) të gjitha anijet dhe avionët që mendohet se do të angazhohen në shkarkim të mbetjeve në zonat që janë nën juridiksionin e tij për këtë çështje.

### **Neni 12**

Çdo Palë zotohet të nxjerrë udhëzime për anijet dhe avionët e inspektimit detar dhe shërbimeve të tjera të përshtatshme për t'u raportuar autoriteteve të tij çdo rast ose kushtet në zonën e Detit Mesdhe, të cilat të çojnë në mendimin se shkarkimi është kryer ose ka të ngjarë të ndodhë në kundërshtim me kushtet e këtij protokoll. Pala duhet, nëqoftse e konsideron të përshtatshme, t'i raportojë rreth kësaj çdo pale tjetër që mund të jetë e interesuar.

### **Neni 13**

Asgjë në këtë protokoll nuk do të pengojë të drejtën e çdo pale të miratojë masa të tjera, në përputhje me Ligjin Ndërkombëtar, për të parandaluar ndotjen prej shkarkimit të mbetjeve.

### **Neni 14**

1. Takimet e zakonshme të Palëve në këtë protokoll do të mbahen gjatë takimeve të zakonshme të Palëve Kontraktuese në konvente të mbledhura sipas nenit 18 të konventes. Gjithashtu sipas nenit 18 të konventes Palët në këtë protokoll mund të zhvillojnë takime të jashtëzakonshme.

2. Do të jetë funksion i takimeve të Palëve në këtë protokoll:

- (a) Të ndjekin zbatimin e këtij protokoll dhe të shqyrtojnë efektivitetin e masave të marra dhe nevojën për çdo masë tjetër, në veçanti në formën e anekseve;
- (b) Të studjojnë dhe shqyrtojnë regjistrimet e lejeve të lëshuara në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 dhe shkarkimet që kanë ndodhur;
- (c) Të shqyrtojnë dhe të ndryshojnë anekset në këtë protokoll;
- (d) Të plotësojnë funksione që mund të jenë të përshtatshme në këtë protokoll.

3. Miratimi i shtesave në aneksin e këtij protokoll sipas nenit 23 të konventes do të kërkojë tre të katërtat e votave të Palëve.

### **Neni 15**

1. Dispozitat e konventes që lidhen me çdo protokoll do të zbatohen në lidhje me protokollin aktual.

2. Rregullat ose procedurat dhe rregullat financiare të miratuara sipas nenit 24 të konventes do të zbatohen në lidhje me këtë protokoll, në qoftë se Palët në këtë protokoll nuk vendosin ndryshe.

Ky protokoll është firmosur në prani të nënshkruesve të autorizuar nga qeveritë e tyre për këtë qëllim.

Bërë në Barcelonë në 16 shkurt 1976 në një kopje të vetme në gjuhët Arabe, Anglisht, Frëngjisht dhe Spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalentë.

## **ANEKS**

Faktorët që duhen marrë në konsideratë për të vendosur kriteret që do të përcaktojnë lëshimin e lejeve për shkarkimin e lëndëve në det do të mbështeten në nenin 6, përfshijnë:

### **A. KARAKTERISTIKAT DHE PËRBËRJA E LËNDËVE**



1. Sasia e përgjithshme dhe përbërja mesatare e lëndës së depozituar (p.sh.në një vit).
2. Forma (p.sh.e ngurtë, llucë, e lëngët ose e gaztë).
3. Vetitë: fizike (p.sh.tretshmëria dhe densiteti), kimike dhe biologjike (p.sh.prani virusesh, bakteresh, fermentesh dhe parazitësh).
4. Toksiciteti.
5. Qëndrueshmëria: fizike, kimike dhe biologjike.
6. Grumbullimi dhe biotransformimi në materialet dhe sedimentet biologjike..
7. Ndryshueshmëria ndaj ndryshimeve fizike, kimike, biokimike dhe ndërveprimi me mjedisin ujor me materialet e tjera të patretshme organike dhe inorganike.
8. Mundësia e prodhimit të infeksioneve ose ndryshimeve të tjera që pakësojnë tregëtimin e burimeve (peshku, molusqet, etj.).

## **B. KARAKTERISTIKAT E VENDIT TË SHKARKIMIT DHE METODA E SHKARKIMIT**

1. Vendndodhja (p.sh. koordinatat e rajonit të shkarkimit, thellësia dhe distanca nga bregu), vendndodhja në lidhje me zonat tjera (p.sh. zonat piktoreske, moçalet, zonat e rritjes së peshkut dhe ato të peshkimit, zonat e burimeve të shfrytëzueshme).
2. Shkalla e asgjësimit për periudha të veçanta (p.sh. sasia për një ditë, javë, muaj)
3. Metodat e paketimit dhe përmbajtjes, në qoftë se ka.
4. Hollimi fillestar i arritur nga metoda e propozuar për shkarkim, veçanërisht shpejtësia e anijes.
5. Karakteristikat shpërndarëse (p.sh. efektet e rrymave, rrymat dhe erërat në transportin horizontal dhe përzierjen vertikale).
6. Karakteristikat e ujit [p.sh.temperatura, pH, kripshmëria, treguesit oksigjenik të ndotjes, oksigjeni i tretur (DO), nevoja kimike për oksigjen (COD), nevoja biokimike për oksigjen (BOD), azoti i pranishëm në formë organike dhe minerale, duke përfshirë amoniakun, lëndën pezull, ushqyesit e tjerë dhe produktiviteti).
7. Karakteristikat e fundit / shtratit të detit (p.sh. topografia, karakteristikat gjeokimike dhe gjeologjike dhe produktiviteti biologjik).
8. Ekzistenca dhe efektet e depozitimeve të tjera të cilat janë bërë në rajonin e depozitimit (p.sh. fondi i matur i metaleve të rënda dhe përmbajtja e karbonit organik).
9. Kur lëshohet një leje për depozitim, Palët Kontraktuese do të përpiqen të përcaktojnë, nëse ekziston një bazë shkencore e përshtatshme, për të vlerësuar rrjedhojat e një depozitimi të tillë në rajonin në fjalë, në përputhje me dispozitat e parashtruara dhe të marrin parasysh ndryshimet sezonale.

## **C. KONSIDERATA DHE KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

1. Efektet e mundshme në pejsazh (p.sh. prania e materialeve lundruese, turbullira, erërat e papëlqyeshme,

2. Efektet e mundshme në jetën detare, kulturat e peshkut dhe molusqeve, rezervat e peshkut dhe peshkimit në tërësi, bimësinë dhe barërat e tjera detare.

Efekte të mundshme në përdorime të tjera të detit (p.sh. dëmtim i cilësisë së ujit prej përdorimit industrial, gërryerja nënujore e strukturave, interferencave me operacionet e anijeve nga materialet lundruese, interferenca me peshkim ose navigacion nëpërmjet depozitimit të mbetjeve ose objekteve të ngurta në tabanin e detit dhe mbrojtja e zonave të rëndësishme të veçantë për qëllime konservimi.

Realizimi praktik i metodave alternative bazë të trajtimit, asgjësimit ose mënjanimit ose përpjekja për ta bërë lëndën më pak të dëmshme para se të depozitohet në det.

## **PROTOKOLL PËR MBROJTJEN E DETIT MESDHE NGA NDOTJA PREJ BURIMEVE E AKTIVITETEVE TË VENDOSURA NË TOKË**

Palët Kontraktuese të këtij protokollit,

*duke qenë Palë* në Konventen për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja, të miratuar në Barcelonë, më 16 shkurt 1976 dhe amenduar më 10 Qershor 1995,

*duke patur dëshirën* për të zbatuar nenin 4, paragrafi 5 dhe nenet 8 dhe 21 të kësaj konvente,

*duke parë* trysnitë në rritje mbi mjedisin, si rezultat i aktiviteteve njerëzore në zonën e Detit Mesdhe, veçanërisht në fushat e industrializimit dhe urbanizimit, si edhe prej rritjes sezonale të numrit të popullsisë bregdetare si rezultat i turizmit,

*duke njohur* rrezikun që i kanoset mjedisit detar, burimeve të gjalla dhe shëndetit njerëzor nga ndotjet prej burimeve e aktiviteteve të vendosura në tokë dhe problemeve serioze, që rrjedhin prej tyre në shumë ujra bregdetare dhe delta të Detit Mesdhe, kryesisht për pasojë të shkarkimeve të patrajuara, të trajtuara në mënyrë të papërshtatshme apo të pamjaftueshme, urbane apo industriale, të cilat përmbajnë substanca toksike, të qëndrueshme dhe të mundshme për t'u bioakumuluar,

*duke zbatuar* parimin parandalues dhe parimin *ndotësi paguan*, duke ndërmarrë vlerësime të ndikimit në mjedis dhe përdorur teknikat më të mira të disponueshme dhe praktikatat më të mira mjedisore, siç parashikohet në nenin 4 të Konventes,

*duke njohur* dallimin midis niveleve të zhvillimit të shteteve bregdetare dhe duke marrë parasysh nevojat imperative të vendeve në zhvillim,

të vendosur për të ndërmarrë, në bashkëpunim të ngushtë, masat e nevojshme për të mbrojtur Detin Mesdhe nga ndotja e burimeve dhe aktiviteteve të vendosura në tokë,

Duke marrë parasysh Programin Global të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Aktivitetet e Vendosura në Tokë, të miratuar në Washington, D.C, më 3 nëntor 1995,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

### **Neni 1**

#### **Klauzolat të përgjithshme**

Palët Kontraktuese të këtij protokollit (të referuara më tej si "Palët") do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar, shmangur, luftuar dhe eliminuar, në shkallën më të plotë të mundshme, ndotjen e zonës së Detit Mesdhe, që shkaktohet nga shkarkimet prej lumenjve, veprave detare, grykëderdhjeve, ose që rrjedh prej burimeve dhe aktiviteteve të vendosura në tokë brenda territoreve të tyre, duke iu dhënë prioritet eliminimit të futjes së substancave toksike, të qëndrueshme dhe të prirura për t'u bioakumuluar.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Për qëllime të këtij protokollit,

“Konventa” do të thotë Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja, miratuar në Barcelonë më 16 shkurt dhe amenduar më 10 qershor 1995. “Organizatë” nënkupton organin e referuar në nenin 17 të konventes

“Kufi i ujrave të ëmbla” do të thotë një vend në vijat ujore, kur në zbatim dhe periudha të rrjedhjeve të pakta të ujrave të ëmbla, ka një rritje të konsiderueshme të kripëzimit, në sajë të pranisë së ujit të detit

“Basen hidrologjik” do të thotë e gjithë zona e ujëmbledhësit, brenda territorit të Palëve Kontraktuese, e cila kullon në zonën e Detit Mesdhe, siç përcaktohet në nenin 1 të konventes.

## **Neni 3**

### **Zona e protokollit**

Zona për të cilën vepron ky protokoll (e quajtur që këtej si zona e protokollit) do të jetë,

- (a) Zona e Detit Mesdhe, siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës
- (b) Baseni hidrologjik i zonës së Detit Mesdhe
- (c) Ujrat e pjesës tokësore të vijës bazë prej së cilës matet dhe zgjerohet gjerësia e detit territorial, në rastin e vijave ujore, deri në kufirin e ujrave të ëmbla
- (d) Ujrat e kripura, ujrat e kripura bregdetare, përfshirë kënetat dhe lagunat bregdetare, si edhe ujrat nëntokësore që komunikojnë me Detin Mesdhe.

## **Neni 4**

### **Aplikimi i protokollit**

Ky protokoll do t'i referohet:

Shkarkimeve që rrjedhin nga burimet e aktiviteteve pikësore dhe të shpërndara brenda territoreve të Palëve Kontraktuese, të cilat mund të ndikojnë direkt ose indirekt zonën e Detit Mesdhe. Këto shkarkime do të përfshijnë ato që arrijnë në Detin Mesdhe sipas përcaktimit të bërë në nenin 3 a,c,d të këtij protokollit, përmes lumenjve, grykëderdhjeve, kanaleve, vendeve bregdetare ose vijave të tjera bregdetare, përfshirë, rrjedhën e ujrave nëntokësore ose rrjedhjet apo vendet e asgjësimit poshtë shtratit të detit me dalje në tokë.

Hyrjeve të substancave ndotëse të transportuar nga atmosfera në zonën e Detit Mesdhe, të cilat rezultojnë prej burimeve ose aktiviteteve të vendosura në territoret e Palëve Kontraktuese, sipas kushteve të përcaktuara në aneksin III të këtij protokollit.

Ky protokoll do të jetë i zbatueshëm për shkarkimet ndotëse të strukturave fikse të ndërtuara në det nga njeriu, të cilat janë nën juridiksionin e një pale dhe kanë qëllime të tjera përveç eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve minerare të shelfit kontinental dhe shtratit të detit dhe nëntokës së tij.

Palët do të ftojnë shtetet që nuk janë Palë të protokollit dhe kanë në territorin e tyre pjesë të basenit hidrologjik të zonës së Mesdheut për të bashkëpunuar në zbatimin e protokollit.

## **Neni 5**

### **Detyrime të përgjithshme**

Palët angazhohen të eliminojnë ndotjen që rrjedh prej burimeve dhe aktiviteteve, në veçanti për të hequr futjen e substancave toksike, të qëndrueshme dhe të prirura për t'u bioakumuluar, siç listohen në Aneksin I.

Për këtë qëllim, ata do të shtjellojnë dhe zbatojnë në mënyrë individuale ose të përbashkët, siç është e përshtatshme, planet e programet kombëtare dhe rajonale të veprimit, të cilat përmbajnë masa dhe afate për zbatimin e tyre.

Prioritetet dhe afatet për zbatimin e planeve të veprimit, programeve dhe masave do të miratohen nga Palët duke marrë parasysh elementët e vendosura në Aneksin 1 dhe do të shqyrtohen periodikisht.

Gjatë miratimit të planeve të veprimit, programeve dhe masave, Palët do të marrin parasysh, individualisht apo së bashku, teknikat më të mira të disponueshme dhe praktikatat më të mira mjedisore, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, teknologjitë e prodhimeve të pastra, duke patur parasysh kriteret e përcaktuara në Aneksin IV.

Palët do të marrin masa parandaluese për të ulur në minimum rrezikun e ndotjes së shkaktuar nga aksidentet.

## **Neni 6**

### **Autorizimi dhe sistemi i rregullimit**

1. Shkarkimet nga pika e burimit në zonën e protokollit dhe shkarkimet në ujë ose ajër që mbërrijnë në Detin Mesdhe dhe e prekin atë siç përcaktohet në nenin 3 (a), (c) dhe (d) të këtij protokollit, do t'i nënshtrohen autorizimit ose rregullimit nga autoritetet kompetente, duke marrë parasysh dispozitat e këtij protokollit dhe aneksit 11 të tij, si dhe vendimet dhe rekomandimet përkatëse të mbledhjeve të Palëve Kontraktuese.

2. Për këtë qëllim, Palët do të sigurojnë sistemet e inspektimit nga autoritete kompetente për të vlerësuar përputhjen me autorizimet dhe rregulloret.

3. Palët mund të asistohen nga organizata, me kërkesë, për të ngritur struktura kompetente të reja për inspektim për përputhjen me autorizimet dhe rregulloret ose duke forcuar ato ekzistuese, Një asistencë e tillë do të përfshijë training special të personelit.

4. Palët vendosin sanksionet e duhura në rast të mospërputhjes me autorizimet dhe rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre.

## **Neni 7**

### **Udhëzimet; standartet dhe kriteret e përbashkëta**

1. Palët në mënyrë progresive do të formulojnë dhe miratojnë në përputhje me organizatat kompetente ndërkombëtare udhëzimet e përbashkëta, standartet dhe kriteret e përshtatshme që merren në mënyrë të veçantë me:

(a) gjatësinë, thellësinë dhe pozicionin e tubacioneve për derdhjet në det duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë metodat e përdorura për paratrajtimin e efluentëve,

(b) kërkesat speciale për efluentë që kanë nevojë për trajtim të veçantë;

(c) cilësia e ujit të detit e përdorur për qëllime specifike që është i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, burimet e gjalla dhe ekosistemet;

(d) Kontrolli dhe zevëndësimi progresiv i produkteve, instalimeve dhe i proceseve industriale ose proceseve të tjera që shkaktojnë ndotje të madhe të mjedisit detar;

(e) kërkesa specifike në lidhje me sasitë e substancave të shkarkuara (të dhëna në Aneksin 1), përqëndrimi i efluentëve dhe shkarkimi i tyre.

2. Pa paragjykuar dispozitat e nenit 5 të këtij protokollit, këto udhëzime, standarte dhe kriteret të zakonshme do të marrin parasysh karakteristikat lokale ekologjike, gjeografike, dhe fizike, kapacitetin ekonomik të Palëve dhe nevojën e tyre për zhvillim, nivelin e ndotjes ekzistuese dhe kapacitetin real thithës të mjedisit detar.

3. Planet e veprimit, programet dhe masat e përmendura në nenet 5 dhe 15 të këtij protokollit do të miratohen duke marrë parasysh, për zbatimin e tyre progresiv, kapacitetin për të përshtatur dhe rikonvertuar instalimet ekzistuese, kapacitetin ekonomik të Palëve dhe nevojën e tyre për zhvillim.

## **Neni 8**

## **Monitorimi**

Brenda kuadrit të dispozitave dhe programeve të monitorimit të parashikuara në nenin 12 të konventes dhe, në se është e nevojshme, në bashkëpunim me organizatat kompetente ndërkombëtare, Palët do të kryejnë sa më shpejt që të jetë e mundur aktivitetet monitoruese dhe të verë në dispozicion të publikut të dhënat e nxjerra me qëllim që:

(a) Të vlerësojë në mënyrë sistematike sa më shumë të jetë e mundur, nivelet e ndotjes gjatë bregdetit veçanërisht në lidhje me sektorët e aktivitetit dhe kategoritë e substancave të dhëna në aneksin 1, dhe periodikisht të japë informacion në këtë drejtim;

(b) të vlerësojë efektivitetin e planeve të veprimit, programeve dhe masave të zbatuara në këtë protokoll për të eliminuar sa më shumë të jetë e mundur ndotjen e mjedisit detar.

## **Neni 9**

### **Bashkëpunimi shkencor dhe teknik**

Në përputhje me nenin 13 të konventes, Palët do të bashkëpunojnë në fusha shkencore dhe teknologjike në lidhje me ndotjen nga burime dhe aktivitete të ndodhura në tokë, veçanërisht kërkimet për inpute, rrugë dhe efekte të ndotësve dhe për zhvillimin e metodave të reja për trajtimin, pakësimin ose eliminimin e tyre si dhe për zhvillimin e proceseve të prodhimit të pastër për këtë qëllim. Për këtë arsye, Palët në mënyrë të veçantë do të përpiqen:

(a) të shkëmbejnë informacion shkencor dhe teknik;

(b) të koordinojnë programet kërkimore;

(c) të nxisin futjen dhe transferimin e teknologjive të shëndosha mjedisore duke përfshirë teknologjitë e prodhimit të pastër.

## **Neni 10**

### **Asistenca teknike**

1. Palët, drejtpërsëdrejti ose me asistencën e organizatave kompetente rajonale ose ndërkombëtare, në marrëveshje dy apo shumë Palëshe, do të koeporojnë me qëllim që të formulojnë dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të zbatojnë programe të asistencës për vendet në zhvillim, veçanërisht në fushën e shkencës, edukimit dhe teknologjisë me qëllim që të parandalojnë, pakësojnë ose sipas rastit, të heqin nga përdorimi inpute të ndotësve nga burime dhe aktivitete të ndodhura në tokë dhe efektet e tyre të dëmshme në mjedisin detar.

2. Asistenca teknike do të përfshijë në veçanti trainimin e personelit shkencor dhe teknik si dhe blerjen, përdorimin dhe prodhimin nga këto vende të pajisjeve të përshtatshme dhe sipas rastit, teknologji të prodhimit të pastër në kushte favorizuese që do të bihet dakord nga Palët e interesuara.

## **Neni 11**

### **Ndotja ndërkufitare**

1. Në qoftë se shkarkimet nga rrjedhjet e ujit që kalojnë mospërmas territoreve të dy ose më shumë Palëve ose formon një kufi ndërmjet, ka mundësi të shkaktojë ndotje të mjedisit detar të zonës së protokollit, Palët në fjalë duke respektuar dispozitat e këtij protokollit aq sa ato preken, ftohen të bashkëpunojnë me qëllim që të sigurojnë zbatimin e plotë të saj.

2. Pala nuk do të jetë përgjegjëse për ndotjen që e ka origjinën në një shtet jokontraktues. Megjithatë, pala në fjalë do të përpiqet të bashkëpunojë me shtetin në fjalë në mënyrë që të realizojë zbatimin e plotë të protokollit.

## **Neni 12**

### **Zgjidhja e konflikteve**

1. Duke marrë parasysh nenin 18, paragrafi 1, i konventes, kur ndotja nga burimet e ndodhura në tokë e ka origjinën në territorin e njerës prej Palëve, ka mundësi të paragjykoen drejtpërsëdrejti interesat e një

ose më shumë Palëve. Palët e interesuara, me kërkesë të një ose më shumë prej tyre, do të marrin përsipër të hyjnë në konsultim me qëllim që të arrijnë të bëjnë një zgjidhje të kënaqshme.

2. Me kërkesë të Palës së interesuar, çështja do të vendoset në rendin e ditës së takimit të ardhshëm të Palëve që mbahet në përputhje me nenin 14 të këtij protokoll; Mbledhja mund të bëjë rekomandime me qëllim që të arrihet një zgjidhje e kënaqshme.

### **Neni 13**

#### **Raportet**

1. Palët do të paraqesin raporte çdo dy vjet, në qoftë se nuk është vendosur ndryshe nga mbledhja e Palëve Kontraktuese, për masat e marra, rezultatet e arritura dhe sipas rastit për vështirësitë e ndeshura në zbatimin e këtij protokoll. Procedurat për paraqitjen e këtyre raporteve do të përcaktohen në mbledhjet e Palëve.

2. Këto raporte do të përfshijnë ndërmjet të tjerave:

- (a) të dhëna statistikore për autorizimet e lëshuara në përputhje me nenin 6 të këtij protokoll
- (b) të dhënat që rezultojnë nga monitorimi siç parashikohet në nenin 8 të këtij protokoll
- (c) sasitë e ndotësve të shkarkuar në territoret e tyre
- (d) Plane veprimi, programe dhe masa të zbatuara në përputhje me nenet 5, 7 dhe 15 të këtij protokoll.

### **Neni 14**

#### **Mbledhjet**

1. Mbledhjet e zakonshme të Palëve do të mbahen së bashku me mbledhjet e zakonshme të Palëve Kontraktuese të konventes të mbajtur në përputhje me nenin 18 të konventes. Palët mund të mbajnë takime të jashtëzakonshme në përputhje me nenin 18 të konventes.

2. Funksionet e mbledhjeve të Palëve të këtij protokoll do të jenë ndërmjet të tjerave:

- (a) të shqyrtojnë zbatimin e këtij protokoll dhe të shohin efikasitetin e planeve të veprimit, programeve dhe masave të marra;
- (b) të rishikojnë dhe të amendojnë çdo aneks të protokollit, sipas rastit
- (c) të formulojnë dhe miratojnë plane veprimi, programe dhe masa në përputhje me nenet 5, 7 dhe 15 të protokollit;
- (d) të miratojnë në përputhje me nenin 7 të këtij protokoll, udhëzuesit e përbashkët, standarte dhe kriteret në çfarëdo forme të vendosur nga Palët;
- (e) të bëjnë rekomandime në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, të këtij protokoll;
- (f) të shqyrtojnë raportet e paraqitura nga Palët sipas nenit 13 të këtij protokoll;
- (g) të kryejnë funksione të tjera sipas rastit për zbatimin e këtij protokoll.

### **Neni 15**

#### **Miratimi i planeve të veprimit; programve dhe masave**

1. Mbledhja e Palëve do të miratojë me dy të tretat e votave, një plan dhe program veprimi rajonal afatshkurtër dhe afatmesëm që përmban masa dhe afate kohore për zbatimin e tyre siç parashikohet në nenin 5 të këtij protokoll. Programet dhe planet e veprimit rajonal siç përmenden në paragrafin 1, do të formulohen nga organizata dhe do të shqyrtohen e miratohen nga organizma teknike përkatës të Palëve Kontraktuese brenda një viti si maksimum të hyrjes në fuqi të amendamenteve të këtij protokoll. Këto programe dhe plane veprimi rajonale do të futen në rendin e ditës për mbledhjet e mëvonshme të Palëve për miratim. E njëjta procedurë do të ndiqet për çdo plan dhe program veprimi shtesë.

3. Masat dhe afatet kohore të miratuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të njoftohen nga sekretariati të gjitha Palëve. Këto masa dhe afate kohore do të jenë të detyrueshme brenda 180 ditëve duke filluar nga dita e njoftimit të Palëve që nuk e kanë njoftuar sekretariatit për ndonjë kundërshtim brenda 79 ditëve nga data e njoftimit.

4. Palët që kanë njoftuar një kundërshtim në përputhje me paragrafin e mëparshëm do të njoftojnë mbledhjen e Palëve për dispozitat që mendojnë të marrin, duke kuptuar që këto Palë në çdo kohë mund të japin pëlqimin e tyre për këto masa dhe afate kohore.

## **Neni 16**

### **Dispozitat finale**

1. Dispozitat e konventes në lidhje me çdo protokoll do të zbatohen në lidhje me këtë protokoll.
2. Rregullat e procedurës dhe rregullat financiare të miratuara në përputhje me nenin 24 të konventes do të zbatohen në lidhje me këtë protokoll, në qoftë se Palët në këtë protokoll nuk bien dakord ndryshe.
3. Ky protokoll do të jetë i hapur për firmë në Athinë nga 17 maji 1980 në 16 qershor 1980 dhe në Madrid nga 17 qershori 1980 në 16 maj 1981 nga çdo shtet i ftuar në Konferencën e të Plotfuqishmëve të Shteteve Bregdetare të Rajonit Mesdhetar për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes nga Burimet e Ndodhura në Tokë, i mbajtur në Athinë më 12 maj deri më 17 maj 1980. Do të jetë i hapur në të njëjtat ditë për firmë dhe për Komunitetin Ekonomik Evropian dhe për çdo grupim ekonomik rajonal të ngjashëm nga të cilët të paktën një anëtar është shtet bregdetar i zonës së Detit Mesdhe dhe që ushtron kompetencë në fusha të mbuluara nga ky protokoll.
4. Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Spanjës, që do të marrë funksionet e sekretarit.
5. Që nga 17 maj 1981, ky protokoll do të jetë i hapur për afrim nga shtetet e përmendura në paragrafin 3 më sipër, nga Komuniteti Ekonomik Evropian dhe çdo grupim që referohet në atë paragraf.
6. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të paktën e 6 instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit ose afrimit në protokoll nga Palët e referuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Ky protokoll është firmosur në prani të nënshkruesve të autorizuar nga Qeveritë e tyre për këtë qëllim.

Bërë në Athinë më 17 maj 1980 dhe amenduar në Sirakuzë më 7 mars 1996 në një kopje në arabisht, anglisht, frengjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekste në të katër gjuhët janë ekuivalente.

## **ANEKSI 1**

### **ELEMENTËT QË DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË PËR PËRGATITJEN E PLANEVE TË VEPRIMIT, PROGRAMEVE DHE MASAVE PËR ELEMENIMIN E NDOTJES NGA BURIME DHE AKTIVITETE TË NDODHURA NË TOKË**

Ky aneks përmban elementë të cilët duhet të merren në konsideratë për përgatitjen e planeve të veprimit, programeve dhe masave për eliminimin e ndotjes nga burime të ngritura në tokë si dhe aktivitete që referohen në nenet 5, 7 dhe 15 të këtij protokollit.

Këto plane veprimi, programe dhe masa do të synojnë të mbulojnë sektorë të aktiviteteve që jepen në seksionin A dhe do të mbulojnë gjithashtu grupet e substancave që jepen në seksionin C, të përzgjedhura mbi bazën e karakteristikave të paraqitura në seksionin B të këtij aneksi.

Prioritetet për veprim duhen hartuar nga Palët, mbi bazën e rëndësisë relative të ndikimit të tyre në shëndetin publik, mjedisin dhe kushtet kulturore dhe social-ekonomike. Programe të tilla duhet të prekin burimet e Palëvizshëm, burimet difuzive dhe depozitimet atmosferike.

Në përgatitjen e planeve të veprimit, programeve dhe masave, Palët në përputhje me Programin Botëror të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga aktivitete të ngritura në tokë, të miratuar në Uashington, D.C. 1995, do t'u japin prioritetin atyre substancave që janë toksike, të qëndrueshme nga pikëpamja e vetshpërbërjes dhe me veti bioakumuluese, në veçanti NOQ (ndotësit organikë të qëndrueshëm) si dhe trajtimit dhe administrimit të ujrave të përdorur.

## **A Sektorët e aktivitetit**

Sektorët e mëposhtëm të aktiviteteve (që nuk janë paraqitur sipas prioritetit respektiv) do të merren fillimisht në konsideratë për caktimin e prioriteteve dhe për përgatitjen e planeve, programeve dhe masave për eliminimin e ndotjes nga burimet dhe aktivitetet e ndodhura në tokë:

- 1) Prodhimi i energjisë
- 2) Prodhimi i plehrave kimikë
- 3) Prodhimi dhe formimi i biocideve
- 4) Industria farmaceutike
- 5) Rafinimi i naftës
- 6) Industria e letrës dhe përpunimit të saj
- 7) Prodhimi i çimentos
- 8) Industria e lëkurës
- 9) Industria e prodhimit të metaleve
- 10) Minierat
- 11) Industria e ndërtimit dhe riparimit të anijeve
- 12) Operacionet portuale
- 13) Industria e tekstilit
- 14) Industria elektronike
- 15) Industria ricikluese
- 16) Sektorë të tjerë të industrisë kimike organike
- 17) Sektorë të tjerë të industrisë kimike inorganike
- 18) Turizmi
- 19) Bujqësia
- 20) Blegtoria
- 21) Përpunimi i ushqimeve
- 22) Akuakultura
- 23) Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme
- 24) Administrimi i mbetjeve të ngurta urbane
- 25) Trajtimi dhe asgjësimi i shkarkimeve të lëngëta urbane
- 26) Asgjësimi i llumrave të trajtimit të ujrave të zeza
- 27) Industria e administrimit të mbeturinave
- 28) Djegia e mbeturinave dhe administrimi i hirërave të tyre
- 29) Vepra që shkaktojnë ndryshime fizike të gjendjes natyrore të vijës bregdetare
- 30) Transporti

## **B. KARAKTERISTIKAT E SUBSTANCAVE NË MJEDIS**

Për përgatitjen e planeve të veprimit, programeve dhe masave, Palët duhet të marrin në konsideratë karakteristikat e mëposhtme:

- I. Qëndrueshmëria ndaj vetshpërbërjes
2. Toksiciteti ose veti të tjera të dëmshme (vetitë kancerogjene, mutagjene, teratogjenetike)
3. Bioakumulimi
4. Radioaktiviteti
5. Raporti ndërmjet përqendrimeve që mund të maten dhe që nuk mund të maten
6. Rreziku i eutrofikimit me prejardhje antropogjenike
7. Rreziku dhe efekti shëndetësor
8. Rëndësia ndërkufitare e ndikimit në mjedis



9. Rreziku i ndryshimeve të padëshirueshme në ekosistemet detare dhe pakthyeshmëria ose zgjatshmëria e ndikimeve

10. Interferencat në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla ose në përdorime të tjera të ligjshme të detit

11. Ndikimet në shije ose erë të produkteve detare për konsum njerëzor

12. Ndikimet në erë, ngjyrë, transparencë ose veti të tjera të ujit të detit

13. Modeli i shpërndarjes (sasitë e përfshira, modelet e përdorura dhe probabiliteti i arritjes në mjedisin detar).

## **C KATEGORITË E SUBSTANCAVE**

Kategoritë e mëposhtme të substancave dhe burimeve të ndotjes do të shërbejnë si udhëzuese për përgatitjen e planeve të veprimit, programeve dhe masave:

1 - Komponimet organoalogenë dhe substancat të cilat mund të formojnë komponime të tilla në mjedisin detar. Prioritet do t'i jepet aldrinës, klordanit, DDT, diledrin, dioksinë dhe furanit, endrinës, heptaklor, heksaklorbenzen, PCB dhe toksafen;

2 - Komponime organo-fosforike dhe komponime organike dhe substanca të cilat mund të formojnë të tilla komponime në mjedisin detar

3 - Hidrokarburet policiklike aromatike

4 - Metalet e rënda dhe komponimet e tyre

5 - Vajrat lubrifikantë të përdorur

6 - Substancat radioaktive, duke përfshirë dhe mbeturinat e tyre kur shkarkimet e tyre nuk respektojnë parimet e mbrojtjes radioaktive të përcaktuara sipas organizatave kompetente ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit detar.

7 - Biocidet dhe derivatet e tyre.

8 - Mikroorganizmat patogjene

9 - Nafta dhe hidrokarburet me origjinë naftë

10 - Cianuret dhe floruret

11 - Detergjentët e jodegradueshëm dhe substanca të tjera me aktivitet sipërfaqësor jo të degradueshëm

12 - Komponimet e azotit dhe fosforit dhe substanca të tjera që mund të shkaktojnë eutrofikim.

13 - Mbeturina (çdo lëndë e ngurtë e qëndrueshme e prodhuar ose përpunuar që shkarkohet vendoset ose braktiset në mjedisin detar dhe bregdetar);

14 - Substanca jotoksike që kanë një efekt negativ në përmbajtjen e oksigjenit në mjedisin detar.

15 - Shkarkime termike

16 - Substanca jotoksike që mund të intereferojnë me një përdorim legjitim të detit

17 - Substanca jotoksike që mund të kenë efekt negativ në karakteristika fiziko-kimike të ujit të detit.

18 - Komponime acide dhe alkaline që mund të dëmtojnë cilësinë e ujrave

19- Komponime organotine dhe substanca të cilat mund të formojnë komponime të tilla në mjedisin detar.

## **ANEKS II**

### **ELEMENTË PËR T'U MARRË NË KONSIDERATË PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË SHKARKIMEVE TË MBETURINAVE**

Bazuar në nenin 6 të këtij protokollit, lidhur me dhënie e autorizimeve për shkarkimin e mbeturinave që përmbajnë substancat e referuara në këtë nen, vëmendje e veçantë u duhet kushtuar sipas rastit këtyre faktorëve:

#### **A Vetitë dhe përbërja e mbeturinave**

1. Tipi dhe madhësia e burimit statik dhe difuziv (proces industrial)

2. Tipi i shkarkimit (origjina, përbërja mesatare)

3. Gjendja e mbeturinave (e ngurtë, e lëngët, e gaztë, llum)

4. Sasia totale (vëllimi i shkarkuar në vit)

5. Modeli i shkarkimit (i vazhdueshëm, sezonal, i variueshëm, me intervale)

6. Përqëndrimet në përputhje me përbërësit përkatës të substancave të paraqitura në aneksin 1 dhe të substancave të tjera nëse shihet e përshtatshme.

7. Vetitë fizike, kimike dhe biokimike të mbeturinave të shkarkuara

## **B VETITË E PËRBËRËSVE TË SHKARKUAR SIPAS SHKALLIËS SË DËMIT TË TYRE**

1. Qëndrueshmëria fizike, kimike, biologjike në mjedisin detar
2. Toksiciteti dhe efekte të tjera të dëmshme
3. Akumulimi në lëndë biologjike ose sedimente
4. Transformimi biokimik që prodhon komponime të dëmshme
5. Efektet e dëmshme mbi përmbajtjen e oksigjenit dhe bilancin
6. Mundësi të ndryshmeve fizike, kimike, biokimike dhe ndërveprimi në mjedisin ujor me përbërës të tjerë të ujit të detit të cilët mund të prodhojnë efekte biologjike të dëmshme ose efekte të tjera ose përdorime të tjera që jepen në seksionin E që vijon.
7. Të gjitha karakteristikat e tjera siç jepen në aneksin 1, seksioni B.

## **C: KARAKTERISTIKAT E SHKARKIMEVE DHE MJEDISI PRITËS**

1. Karakteristikat hidrografike, meteorologjike, gjeologjike dhe topografike të zonës bregdetare.
2. Vendndodhja dhe tipi i shkarkimit (rrëqe, rrjedhje kanali etj.) dhe lidhja e tij me zonat e tjera (si për shembull zonat pejsazhistike, zona të mbarështimit të vezëve të peshkut, fidanishte, zona peshkimi, zona molusqesh) dhe shkarkime të tjera
3. Hollimi fillestar i arritur në pikën e shkarkimit në mjedisin pritës.
4. Karakteristikat e shpërndarjes si efektet e rrymave, baticave, erërave në transportin horizontal dhe përzierjen vertikale
5. Karakteristikat e ujrave pritës në lidhje me kushtet fizike, kimike, biologjike dhe ekologjike në zonat e shkarkimit.
6. Kapaciteti i mjedisit detar pritës për të pritur shkarkime pa efekte të padëshirueshme.

## **D EKZISTENCA E TEKNOLOGJIVE TË MBETJES**

Metodat e pakësimit të mbetjeve dhe shkarkimet e efluentëve industrialë si dhe ujrave të zeza urbane do të përzgjidhen duke marrë parasysh ekzistencën dhe mundësinë e

- (a) proceseve të trajtimit alternativ,
- (b) ripërdorimit ose metodat e eliminimit;
- (c) alternativave të asgjësimit në tokë;
- (d) teknologjive të përshtatshme me kosto të ulët.

## **E. DËMTIMI POTENCIAL I EKOSISTEMEVE DETARE DHE PËRDORIMET E UJIT TË DETIT**

1. Efektet në shëndetin e njeriut nëpërmjet ndikimit të ndotjes në
  - (a) Organizmat detare që përdoren për konsum
  - (b) Ujrave që përdoren për të bërë banjë
  - (c) Pamjet estetike
2. Efektet në ekosistemet detare, në veçanti burimet e gjalla, speciet e rrezikuara dhe habitatet kritike.
3. Efektet në përdorimet legjitime të detit.

## **ANEKS III**

# **KUSHTET E ZBATIMIT PËR NDOTJEN QË TRANSPORTOHET NËPËRMJET ATMOSFERËS**

Ky aneks përcakton kushtet e zbatimit të këtij protokollit ndaj ndotjes nga aktivitetet e zhvilluara në tokë, që transportohet nga atmosfera sipas nenit 4.1(b) që janë si vijon më poshtë:

1 - Ky protokoll zbatohet për shkarkimet e ndotësve në atmosferë në këto kushte:

a) Substanca e shkarkuar është ose mund të transportohet në Detin Mesdhe në kushte të parashikuara të motit

b) Hyrja e substancave në Detin Mesdhe është e rrezikshme për mjedisin në raport me sasinë e së njëjtës substancë që arrin në këtë zonë me mënyra të tjera.

2 - Ky protokoll zbatohet gjithashtu për shkarkimet ndotëse në atmosferë që ndikojnë në Detin Mesdhe nga aktivitetet e ndodhura në tokë, në territoret e Palëve dhe nga strukturat e fiksuara ose të lëvizëshme në det, që i nënshtrohen nenit 4.2 të këtij protokollit.

3 - Kur ndotet Deti Mesdhe nga aktivitetet e ndodhura në tokë nëpërmjet atmosferës, zbatohen në mënyrë progresive nenet 5 dhe 6 të këtij protokollit për substancat e përshtatshme dhe aktivitete që jepen në aneksin 1 të këtij protokollit siç do të bihet dakord mes Palëve.

4 - Janë subjekt zbatimi të kushteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij aneksi dhe të nenit 7.1 të këtij protokollit edhe:

a) shkarkimet në sasi dhe rendiment i substancave të emetuara në atmosferë mbi bazën e informacionit që disponohet nga Palët lidhur me lokalizimin dhe shpërndarjen e burimeve të ndotjes së ajrit

b) përmbajtja e substancave të rrezikshme në lëndë të djegshme dhe lëndë të para

c) eficienta e teknologjive të kontrollit të ndotjes dhe proceset më eficiente të prodhimit dhe djegjes së karburanteve

d) përdorimi i substancave të rrezikshme në bujqësi dhe pyje

5 - Nenet e aneksit II të këtij protokollit duhet të zbatohen për ndotjen që mund të vijë me rrrugë atmosferike kur kjo është e përshtatshme. Monitorimi dhe modelimi i ndotjes së ajrit që përdor faktorë të përbashkët të shkarkimit dhe metodologjitë duhet të kryhen në vlerësimin e depozitimeve atmosferike të substancave, si dhe në llogaritjen e inventarëve dhe shkallëve të shkarkimeve të ndotësve në atmosferë nga aktivitetet që zhvillohen në tokë.

6 - Të gjithë nenet, duke përfshirë edhe pjesë të këtij protokollit që nuk përmenden në paragrafet 1-5, duhet të zbatohen për ndotjen nga aktivitete të ndodhura në tokë dhe që transportohet nga atmosfera sa herë që kjo është e mundur dhe subjekt i kushteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij aneksi.

## ANEKS IV

### **KRITERE PËR PËRCAKTIMIN E TEKNIKËS MË TË MIRË TË MUNDSHME DHE TË PRAKTIKAVE MË TË MIRA MJEDISORE**

#### **A TEKNIKAT MË TË MIRA TË MUNDSHME**

1 - Përdorimi i teknikave më të mira duhet të theksojë përdorimin e teknologjive që nuk prodhojnë mbetje, nëse është e mundur.

2 - Përdorimi i termit “teknika më të mira” do të thotë shkalla më e fundit e zhvillimit të proceseve, pajisjeve ose metodave të vënies në punë të cilat tregojnë përshtatshmërinë teknike të masave për kufizimin e shkarkimeve, efluentëve dhe mbetjeve. Në përcaktimin nëse një grup procesesh, pajisjesh dhe metodash funksionimi përbëjnë teknikën më të mirë të mundshme në përgjithësi ose raste të veçanta, u duhet kushtuar vëmendje e veçantë këtyre drejtimeve:

a) procese, pajisje ose metoda funksionimi të krahasueshme, të cilat janë provuar në mënyrë të suksesshme,

- b) progresi teknik dhe ndryshimet në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre
- c) mundësitë ekonomike për zbatimin e teknikave të tilla
- d) kohët limit për instalimin e tyre në impiante të reja dhe ekzistuese
- e) natyra dhe vëllimi i efluentëve dhe shkarkimeve të lidhura me to.

3 - Duhet pranuar që çfarë konsiderohet teknikë më e mirë për një proces të veçantë do të ndryshojë me kohën për rrjedhjet të zhvillimeve teknike, faktorëve shoqërorë dhe ekonomikë si dhe ndryshimeve në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre.

4 - Nëse pakësimi i efluentëve dhe shkarkimeve që rezultojnë nga përdorimi i teknikave më të mira nuk çon në rezultatet e pritshme mjedisore, duhen zbatuar masa të tjera.

5 - Termi “teknikë” përfshin si teknologjinë e përdorur edhe mënyrën në të cilën është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, vënë në punë dhe çmontuar impianti.

## **B PRAKTIKAT MË TË MIRA MJEDISORE**

6 - Termi “praktikë mjedisore më e mirë” do të thotë zbatimi i masave dhe strategjive shumë të përshtatshme të kontrollit mjedisor. Në bërjen e zgjedhjeve për raste të veçanta duhen marrë në konsideratë të paktën:

- a) Sigurimi i informacionit dhe edukimi i publikut dhe përdoruesve që pasojat mjedisore mjedisore të një zgjedhjeje të dhënë për aktivitete dhe produkte të veçanta, përdorimi dhe asgjësimi i tyre pas përdorimit;
- b) Zhvillimi dhe zbatimi i kodeve dhe praktikave mjedisore të mira të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e aktiviteteve në jetën e produktit;
- c) Zbatimi i detyrueshëm i etiketave që informojnë përdoruesit për rreziqet mjedisore që lidhen me produktet, përdorimin e tij dhe asgjësimin përfundimtar të tyre pas përdorimit;
- d) Burimet që kursehen, duke përfshirë edhe energjinë;
- e) Grumbullimi kolektiv dhe sistemet e asgjësimit që janë në dispozicion të publikut;
- f) Evitimi i përdorimit të substancave dhe produkteve të rrezikshme ose dhe gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme;
- g) Riqarkullimi, ripërdorimi dhe rikuperimi;
- h) Zbatimi i instrumentave ekonomikë për aktivitete, produkte ose grup;
- i) Ngritja e një sistemi liçensimi, që përfshin një grup kufizimesh dhe ndalimesh;

7- Në përcaktimin se cilat masa të kombinuara përbëjnë praktikat më të mira mjedisore, në përgjithësi ose raste individuale, duhet shqyrtuar veçanërisht:

- a) Rreziku mjedisor i produkteve dhe prodhimeve të tyre, përdorimi dhe asgjësimi përfundimtar;
- b) Zëvendësimi me aktivitete dhe / ose substanca që ndotin më pak;
- c) Shkalla e përdorimit;
- d) Përfitimi mjedisor potencial ose ndëshkim për materialet dhe/ose aktivitetet e zëvendësuara;
- e) Përparimet dhe ndryshimet në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre;
- f) Kohët limit për zbatim;
- g) Implikimet shoqërore dhe ekonomike

8- Duhet pranuar që çfarë konsiderohet praktikë mjedisore më e mirë për një proces të veçantë do të ndryshojë me kohën për rrjedhjet të zhvillimeve teknike, faktorëve shoqërorë dhe ekonomikë si dhe ndryshimeve në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre.

9- Nëse pakësimi i flukseve hyrëse si rezultat i përdorimit të praktikave më të mira nuk çon në rezultatet e pritshme mjedisore, duhen zbatuar masa të tjera dhe ripërcaktuar praktikat më të mira mjedisore.

# **PROTOKOLL PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR NDOTJES SË DETIT MESDHE NGA HIDROKARBURET DHE SUBSTANCA TË TJERA TË DËMSHME NË RASTE EMERGJENCE.**

Palët kontraktuese në protokoll,

Duke qenë Palë të një konvente për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja,

Duke njohur ndotjen e lartë të detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme në hapësirën e Detit Mesdhe, që përbën një rrezik për shtetet bregdetare dhe ekosistemet detare,

Duke konsideruar që bashkëpunimi i të gjitha shteteve bregdetare të Mesdheut është i nevojshëm për të luftuar këtë ndotje,

Duke patur parasysh Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, 1973, Konventën Ndërkombëtare në lidhje me “Ndërhyrjen në Detet në Rastet e Dëmeve nga Ndotja me Hidrokarbure”, 1969, si dhe protokollin në lidhje me “Ndërhyrjen në Detet në Rastet e Ndotjes Detare nga Substanca të Tjera Përveç Hidrokarbureve”, 1973,

Duke patur parasysh më tej Konventën Ndërkombëtare mbi “Përgjegjësinë Civile për Dëmtimet nga Ndotja e Hidrokarbureve”, 1969,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

## **Neni 1**

Palët kontraktuese të këtij protokollit (që këtej e tutje do të quhen “Palë”) do të koprojnë në marrjen e masave të nevojshme në rastet e rreziqeve të mëdha për mjedisin detar, bregdetin ose interesa të lidhura me një ose më shumë Palë për shkak të prezencës së sasive masive të hidrokarbureve ose të substancave të tjera të dëmshme që rezultojnë nga raste aksidentale ose akumulim i shkarkimeve të vogla që ndotin ose kërcënjnë të ndotin detin brenda hapësirës së përcaktuar në nenin 1 të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja (që më poshtë do të quhet “konventa”).

Protokollin në lidhje me “Bashkëpunimin në Luftën Kundër Ndotjes së Detit Mesdhe nga Hidrokarburet dhe Substancat e Tjera të Dëmshme në Rastet e Emergjencës” (Protokollin i Emergjencës) ishte adoptuar më 16 shkurt 1976 nga Konferenca e Plotfuqishme e Shteteve Bregdetare të Rajonit të Mesdheut për Mbrojtjen e Detit Mesdhe, e mbajtur në Barcelonë. Protokollin hyri në fuqi më 12 shkurt 1978.

## **Neni 2**

Për qëllim të këtij protokollit, termi “interesa të lidhura” do të thotë interesa të një shteti bregdetar që ndikohet ose kërcënohet direkt dhe që ka të bëjë, ndërmjet të tjerave, me:

- (a) Aktivitetet në ujrat bregdetare, në portet ose estuaret, duke përfshirë aktivitetet e peshkimit;
- (b) Kërkesat historike dhe turistike të hapësirës së marrë në konsideratë, duke përfshirë sportet ujore dhe aktivitetet çlodhëse;
- (c) Shëndetin e popullsisë bregdetare;
- (d) Ruajtjen e burimeve jetësore.

## **Neni 3**

Palët do të përpiqen të mbajnë dhe të promovojnë, ose individualisht ose nëpërmjet koperimit dypalësh ose shumëpalësh, planet kontigjente të tyre dhe mjetet për luftën kundër ndotjes së detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme. Këto mjete do të përfshijnë, në mënyrë të veçantë, pajisje, anije, avionë dhe forca njerëzore të përgatitura për veprime në raste të emergjencës.

## **Neni 4**

Palët do të zhvillojnë dhe aplikojnë, ose në mënyrë individuale ose nëpërmjet koperimit dypalesh apo shumëpalesh, aktivitete monitorimi që mbulojnë hapësirën e Detit Mesdhe me qëllim që të kenë një informacion sa më të saktë mbi situatën e referuar në nenin 1 të këtij protokollit.

#### **Neni 5**

Në rastet e çlirimit ose hedhjes së substancave të dëmshme nga anijet, të paketuara, në kontenierë, çisterna portabël, çisterna ose vagona çisternë, Palët do të koprojnë sa më praktikisht në shpëtimin dhe rikuperimin e substancave të tilla në mënyrë të tillë që të reduktohet rreziku i ndotjes së mjedisit detar.

#### **Neni 6**

1. Çdo Palë merr përsipër t'i shpërndajë Palëve të tjera informacionin në lidhje me:

(a) Organizatën kombëtare kompetente ose autoritetet përgjegjëse për të luftuar ndotjen e detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme;

(b) Autoritetet kombëtare kompetente përgjegjëse për marrjen e raporteve të ndotjes së detit nga hidrokarburet dhe substanca të tjera të dëmshme dhe për t'u marrë me çështjet që kanë të bëjnë me masat e asistencës ndërmjet Palëve;

(c) Rrugët e reja me anë të të cilave ndotja e detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme mund të shmanget, masat e reja për të luftuar ndotjen dhe zhvillimin e programeve kërkimore.

2. Palët të cilat kanë rënë dakord për të shkëmbyer informacion drejtpërdrejt ndërmjet tyre, megjithatë do ta komunikojnë këtë informacion në qendrën rajonale. Kjo e fundit do t'ia komunikojë këtë informacion Palëve të tjera dhe, mbi bazën e reciprocitetit, shteteve bregdetare të hapësirës së Detit Mesdhe të cilat nuk janë Palë të këtij protokollit.

#### **Neni 7**

Palët marrin përsipër të kordinojnë përdorimin e mjeteve të komunikimit në dispozicion të tyre me qëllim që të sigurohet, me shpejtësinë dhe cilësinë e nevojshme, marrja, transmetimi dhe shpërndarja e të gjitha raporteve dhe informacionit urgjent që lidhet me incidentet dhe situatat e referuara në nenin 1. Qendra rajonale do të ketë mjetet e nevojshme të komunikimit për ta aftësuar atë që të marrë pjesë në këtë përpjekje të kordinuar dhe në mënyrë të veçantë, të përmbushë funksionet e caktuara asaj nga paragrafi 2 i nenit 10.

#### **Neni 8**

1. Çdo Palë do t'i japë instruksione kapitenëve të anijeve që kanë flamurin e saj dhe pilotëve të avionëve të regjistruar në territorin e saj, duke i kërkuar atyre të raportojnë nëpërmjet kanaleve më të shpejta dhe të përshtatshme për rrethanat, dhe në përputhje me aneksin 1 të këtij protokollit, ose të një Pale ose qendre rajonale:

(a) Të gjithë aksidentet që shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të detit nga hidrokarburet ose substancat e tjera të dëmshme;

(b) Prezenca, karakteristikat dhe sipërfaqet ku janë derdhur hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme të vrojtuar në det të cilat përfaqësojnë një kërcënim serioz dhe të dukshëm për mjedisin detar ose bregdetin ose për interesat e një ose më shumë Palëve.

2. Informacioni i mbledhur në përputhje me paragrafin 1 do t'u jetë komunikuar Palëve të tjera që mund të jenë të ndikuara nga ndotja:

(a) Nga pala, e cila ka marrë informacionin, drejtpërdrejt ose në mënyrë të preferueshme, nëpërmjet qendrës rajonale; ose

(b) Nga qendra rajonale.

Në rast të komunikimit direkt ndërmjet Palëve, qendra rajonale do të jetë e informuar për masat e marra nga këto Palë.

3. Si konsekuencë e aplikimit të dispozitave të paragrafit 2, Palët nuk janë të lidhura nga detyrimi i nenit 9, paragrafi 2, i konventës.

#### **Neni 9**

1. Çdo Palë, e përballuar me llojin e situatës së përcaktuar në nenin 1 të këtij protokoll:

(a) do të bëjë vlerësimet e nevojshme të natyrës dhe shtrirjes së dëmeve, emergjencës ose, sipas rastit që mund të paraqitet, tipi dhe sasia e përfaqësuesve të hidrokarbureve ose substancave të tjera të dëmshme dhe drejtimi e shpejtësia e rrjedhjes;

(b) do të marrë çdo masë të praktikueshme, për të shmangur ose reduktuar efektet e ndotjes;

(c) do të njoftojë menjëherë të gjitha Palët e tjera, direkt ose nëpërmjet qendrës rajonale, për këto vlerësime dhe ndonjë veprim që ajo ka marrë ose ka për qëllim të marrë për të luftuar ndotjen;

(d) do të vazhdojë të vëzhgojë situatën sa më gjatë të jetë e mundur dhe ta raportojë atë në përputhje me nenin 8.

2. Atje ku aksioni është ndërmarrë për të luftuar ndotjen që vjen nga një anije, të gjitha masat e mundshme do të merren për të ruajtur personat që ndodhen në bord dhe sa më shumë të jetë e mundur, vetë anijen. Çdo Palë që ndërmerr një aksion të tillë do të informojë Organizatën Ndërqeveritare Detare Konsultative.

#### **Neni 10**

1. Çdo Palë që kërkon asistencë për të luftuar ndotjen nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme që ndotin ose kërcënojnë të ndotin brigjet e saj, mund të kërkojë asistencë nga Palët e tjera, direkt ose nëpërmjet qendrës rajonale të përmendur në nenin 6, duke filluar me Palët të cilat duken të jenë më të ndikuara nga ndotja. Kjo asistencë mund të përfshijë, në mënyrë të veçantë këshillim eksperti dhe paisjen ose vënien në dispozicion të pales së interesuar të produkteve, pajisjeve dhe fasiliteve të lundrimit detar. Palëve që u janë paraqitur kërkesa, do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të bërë të mundur këtë asistencë.

2. Atje ku Palët e përfshira në një aksion për të luftuar ndotjen nuk mund të bien dakord mbi organizimin e operacionit, qendra rajonale, me aprovimin e tyre, mund të kordinojë aktivitetin e pajisjeve të vëna në veprim nga këto Palë.

#### **Neni 11**

Zbatimi i dispozitave përkatëse të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij protokoll në lidhje me qendrën rajonale do të zgjerohet nëse është e nevojshme, për qendrat sub-rajonale me rastin e krijimit të tyre, duke marrë parasysh objektivat dhe funksionet e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me qendrën rajonale.

#### **Neni 12**

1. Takimet e zakonshme të palëve të këtij protokoll do të mbahen në lidhje me takimet e zakonshme të Palëve kontraktuese të konventës, sipas nenit 14 të konventës. Palët e këtij protokoll mundet gjithashtu të mbajnë takime të jashtzakonshme sipas nenit 18 të konventës.

2. Funksioni i takimeve të Palëve të këtij protokoll në mënyrë të veçantë:

(a) Të mbajë nën vërejtje zbatimin e këtij protokoll, dhe të konsiderojë efikasitetin e masave të marra dhe nevojën për ndonjë masë tjetër, në mënyrë të veçantë në formën e anekseve;

(b) Të rishikojë dhe amendojë siç kërkohet ndonjë aneks të këtij protokoll;

(c) Të kryejë disa funksione të tjera që mund të jenë të përshtatshme për zbatimin e këtij protokoll.

#### **Neni 13**

1. Dispozitat e konventës në lidhje me ndonjë protokoll do të aplikohen duke respektuar protokollin prezent.

2. Rregullat e procedurës dhe rregullat financiare të miratuara në përputhje me nenin 24 të konventës do të aplikohen në lidhje me këtë protokoll, në rast se Palët nuk bien dakord ndryshe.

NË PRANI të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kanë firmosur këtë protokoll.

BËRË në Barcelonë më 16 shkurt. 1976 në një kopje të vetme në gjuhët arabe, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalente dhe të vlefshëm.

## **ANEKS I**

### **PËRMBAJTJA E RAPORTIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 8 TË KËTIJ PROTOKOLLI**

1. Çdo raport do të përmbajë, sa më shumë të jetë e mundur, në përgjithësi:
  - (a) Identifikimin e burimit të ndotjes (identitetin e anijes, nëse është e mundur);
  - (b) Pozicionin gjeografik, kohën dhe datën e ndodhjes së incidentit ose të vëzhgimit të tij;
  - (c) Kushtet e erës dhe detit që dominonin në zonë;
  - (d) Atje ku ndotja vjen nga një anije, detajet e duhura në lidhje me kushtet e anijes.
  
2. Çdo raport do të përmbajë, kurdoherë që të jetë e mundur, në mënyrë të veçantë:
  - (a) Një tregues të qartë ose përshkrimin e substancave të dëmshme, duke përfshirë emrat teknikë korrektë të substancave të tilla (emrat tregtarë nuk duhet të jenë të përdorur në vend të emrave korrektë teknikë);
  - (b) Një deklaram ose vlerësim të sasive, koncentrimeve dhe kushtet e mundshme të substancave të dëmshme të shkarkuara ose që mund të shkarkohen në det;
  - (c) Kur ka lidhje, një përshkrim të ngarkesës dhe standartet identifikuese;
  - (d) Emrin e dërguesit, pritësit ose prodhuesit.
  
3. Çdo raport duhet të tregojë qartë, kur është e mundur, nëse substanca e dëmshme e shkarkuar ose që mund të shkarkohet në det është hidrokarbur ose një lëndë helmuese, substancë e ngurtë apo e gaztë, dhe nëse një substancë e tillë ishte ose është transportuar rifuxhio ose në një formë të paketuar, në konteinerë, çisterna portabël, ose çisterna dhe vagona çisternë.
  
4. Çdo raport do të jetë i plotësuar nga një informacion përkatës, të kërkuar nga personi që merr raportin ose nëse konsiderohet e përshtatshme nga personi që e dërgon atë.
  
5. Ndonjë nga personat referuar në nenin 8, paragrafi 1 i këtij protokoll do të:
  - (a) Plotësojë sa të jetë e mundur, raportin fillestar, si të nevojshëm, me informacionin që ka të bëjë me zhvillimet e mëtejshme;
  - (b) Përmbahet sa më shumë të jetë e mundur, kërkesave për informacion shtesë nga shtetet e dëmtuara nga ndotja.

### **PROTOKOLL KU PËRFSHIHEN ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA DHE LLOJSHMËRIA BIOLOGJIKE**

Palët kontraktuese në këtë protokoll

Duke qenë Palë të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja, miratuar në Barcelonë në 16 shkurt 1976,

Të ndërgjegjshëm për ndikimet e mëdha të shkaktuara nga aktiviteti i njeriut në mjedisin detar aktual dhe për më në përgjithësi në ekosistemet mesdhetare që kanë tipare kryesore mesdhetare,

Duke i dhënë rëndësi mbrojtjes dhe si rrjedhim përmirësimit të gjendjes së trashëgimive natyrore e kulturore mesdhetare, veçanërisht nëpërmjet krijimit të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura dhe ruajtjes e mbrojtjes së specieve të rrezikuara,



Duke marrë në konsideratë instrumentet e miratuara nga UNCED dhe veçanërisht nga Konventa për Biodiversitetin (Rio de Zhaneiro 1992),

Të ndërgjegjshëm se kur ekziston rreziku për pakësime të rëndësishme apo humbje të biodiversitetit, mungesa e qartësisë shkencore nuk duhet të justifikojë zvarritjen e masave ndaluese apo minimizuese të rrezikut,

Duke marrë në konsideratë se të gjitha Palët kontraktuese duhet të bashkëpunojnë për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, shëndetin dhe se ato kanë në këtë drejtim përgjegjësi të përbashkëta, por të diferencuara,

Ranë dakord si më poshtë:

## **PJESA I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Përkufizime**

Për qëllimet e këtij protokoll:

(a) “Konventa” nënkupton Konventën për Mbrojtjen e Detit Mesdhe ndaj Ndotjes, miratuar në Barcelonë në 16 shkurt 1976 dhe amenduar në Barcelonë në 1995;

(b) “Biodiversitet” nënkupton Llojshmërinë midis organizmave të gjalla nga të gjitha burimet, përfshi ndërmjet të tjerash, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore si dhe komplekset ekologjike ku bëjnë pjesë; kjo përfshin llojshmërinë brenda specieve, ndërmjet specieve dhe të ekosistemeve.

(c) “Specie të Rrezikuara” nënkupton çdo specie që është në rrezik për t’u zhdukur në të gjithë kufirin apo në pjesë të kufijve që kushtëzojnë ekzistencën e saj.

(d) “Specie endemike” nënkupton çdo specie kufijtë e ekzistencës së të cilave kufizohen në një zonë të kufizuar gjeografike.

(e) “Specie të kërcënuara” nënkupton çdo specie që sipas parashikimeve ka të ngjarë të zhduket në një të ardhme të parashikueshme dhe mbijetesa e të cilave është e pamundur në qoftë se faktorët që çojnë në pakësimin numerik ose degradim të habitatit, vazhdojnë të ekzistojnë.

(f) “Statusi i konservimit të specieve” nënkupton shumën e influencave vepruese tek speciet që mund të ndikojnë në numrin dhe shpërndarjen e qëndrueshme afatgjatë të tyre.

(g) “Palë” nënkupton Palët kontraktuese në këtë protokoll.

(h) “Organizatë” nënkupton organizatën që referohet në nenin 2 të konventës.

(i) “Qendër” nënkupton Qendrën e Aktivitetit Rajonal për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura.

#### **Neni 2**

##### **Mbulimi gjeografik**

1. Zona në të cilën aplikohet ky protokoll do të jetë zona e Detit Mesdhe siç është përcaktuar në nenin 1 të konventës. Aty përfshihet gjithashtu:

- shtrati i detit dhe nëntoka e tij
- ujrat, shtrati i detit dhe nëntoka e tij në pjesën me drejtim nga toka që shërben si linjë kryesore nga e cila matet rritja e territorit detar dhe shtrirja e tij, në rastet e rrjedhave ujore sipërfaqësore tokësore, deri në kufirin e ujrave të ëmbla:
- zonat e territoreve bregdetare, përcaktuar dhe parashikuar nga çdo Palë, përfshi tokat e lagëta.

2. Asgjë në këtë protokoll, ose asnjë akt i miratuar në bazë të këtij protokoll, nuk do të paragjykojë të drejtat, qëllimet dhe synimet legale të çdo shteti për sa i përket ligjit për detin, veçanërisht për natyrën dhe shtrirjen e zonave detare, për ndarjen e zonave detare midis shteteve mes brigjeve përkatëse pranë apo përballë tyre, për lirinë e lundrimit në det të hapur, të drejtën dhe modalitetet e kalimit nëpërmjet kanaleve

të përdorura për lundrim ndërkombëtar dhe të drejtën e kalimit të pafajshëm në detet territoriale si dhe natyrën e shkallën e juridiksionit të shtetit bregdetar, shtetit të flamurit dhe shtetit të portit.

3. Asnjë akt ose aktivitet i ndërmarrë në bazë të këtij protokollit nuk do të përmbajë apo përbëjë baza për padi, kundërshti apo grindje për ndonjë pretendim për sovranitetin apo juridiksionin kombëtar.

### **Neni 3**

#### **Detyrimet kryesore**

1. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme :
  - (a) për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe ekologjike zonat me vlera të veçanta natyrore dhe kulturore, sidomos nëpërmjet krijimit (shpalljes) së Zonave Veçanërisht të Mbrojtura.
  - (b) për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar speciet e kërcënuara ose të rrezikuara të florës dhe faunës.
2. Palët do të bashkëpunojnë, direkt apo nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare. në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike në zonat ku ky protokoll do të aplikohet.
3. Palët do të identifikojnë dhe hartojnë inventarët e komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike që konsiderohen si të rëndësishëm për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre.
4. Palët do të miratojnë strategjitë, planet e programet për konservimin e shumëllojshmërisë biologjike dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve biologjike bregdetare e detare dhe do t'i integrojnë ato nësektorët e tyre përkatës apo në politikat ndërsektoriale.
5. Palët do të monitorojnë komponentet e shumëllojshmërisë biologjik të referuara në paragrafin 3 të këtij neni dhe do të identifikojnë proceset dhe kategoritë e aktiviteteve të cilat kanë apo kanë të ngjarë të kenë ndikime negative të rëndësishme në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike, dhe të monitorojnë efektet e tyre.
6. Çdo Palë do të zbatojë masat e përcaktuara në këtë protokoll pa paragjykuar sovranitetin apo juridiksionin e Palëve apo shteteve të tjera. Çdo masë e marrë nga njëra Palë për përforcimin e këtyre masave do të bëhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

## **PJESA II**

### **MBROJTJA E ZONAVE**

#### **SEKSIONI 1 - ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA**

##### **Neni 4**

##### **Objektivat**

- Objektivi i zonave veçanërisht të mbrojtura është të sigurojë mbrojtjen:
- (a) e tipeve përfaqësuese të ekosistemeve detare dhe bregdetare me përmasa të përshtatshme dhe të pranueshme për të siguruar mbijetesën afatgjatë të tyre dhe të ruajë shumëllojshmërinë biologjik të tyre;
  - (b) e habitateve që janë në rrezik për t'u zhdukur në zonat e shpërndarjes natyrore të tyre në Mesdhe apo që kanë një zonë natyrore shpërndarjeje të reduktuar si pasojë e regresit të tyre ose për arsye të zonave të kufizuara të tyre;
  - (c) e habitateve kritike për të garantuar mbijetesën, riprodhimin dhe përtë-ritjen e specieve endemike, të rrezikuara dhe të kërcënuara të florës e faunës.
  - (d) e zonave me rëndësi të veçantë për interesa shkencore, estetike, kulturore, dhe edukative.

##### **Neni 5**

##### **Shpallja e zonave veçanërisht të mbrojtura**

1. Çdo Palë mund të krijojë zona veçanërisht të mbrojtura në zonat detare dhe bregdetare që janë nën juridiksionin apo sovranitetin e saj.

2. Nëse një Palë, ka për qëllim shpalljen e një zone veçanërisht të mbrojtur në një territor nën juridiksionin dhe sovranitetin e tij, por që kufizohet apo është vazhdim i një zone në sovranitetin dhe juridiksionin e një Palë tjetër, autoritetet kompetente të të dy Palëve duhet të angazhohen në bashkëpunim, me qëllim arritjen e marrëveshjeve për masat që do të ndërmerren dhe veç të tjerash do të vlerësojnë mundësinë e pales tjetër për shpalljen e zonës veçanërisht të mbrojtur korresponduese apo të marrin, masa të tjera të përshtatshme.

3. Nëse një Palë ka për qëllim shpalljen e një zone veçanërisht të mbrojtur në një territor nën juridiksionin dhe sovranitetin e saj dhe që kufizohet apo është vazhdim i një zone nën juridiksionin apo sovranitetin e një Palë tjetër që nuk është Palë në këtë protokoll, pala e parë duhet të përpiqet të bashkëpunojë me shtetin jo anëtar të protokollit sipas paragrafit të mësipërm.

4. Nëse një shtet që nuk është Palë e këtij protokollit ka për qëllim të shpallë një zonë veçanërisht të mbrojtur në kufi të një zone që është nën sovranitetin apo juridiksionin e një shteti që është Palë e këtij protokollit, ky i fundit duhet të përpiqet të bashkëpunojë me të parin sipas paragrafit 2.

## **Neni 6**

### **Masat mbrojtëse**

Palët, duke respektuar ligjin ndërkombëtar dhe duke marrë parasysh karakteristikat e secilës prej zonave veçanërisht të mbrojtura, duhet të marrin masat e nevojshme mbrojtëse dhe në vecanti:

(a) forcimin e zbatimit të protokolleve të tjera të konventës dhe të traktateve të tjera përkatëse në të cilat ato janë Palë;

(b) ndalimin e shkarkimit apo hedhjes së mbetjeve apo substancave të tjera që mund të dëmtojnë direkt ose tërthorazi integritetin e zonës veçanërisht të mbrojtur;

(c) rregulloren e kalimit, ndalimit apo të ankorimit të anijeve;

(d) rregulloren për futjen e çdo specjeje jo indigjene në zonën veçanërisht të mbrojtur, apo futjen e specieve gjenetikisht të modifikuara, si dhe futjen apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë në zonën veçanërisht të mbrojtur;

(e) rregulloren ose ndalimin e çdo aktiviteti ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij;

(f) rregullore për çdo aktivitet shkencor

(g) rregullore apo ndalime të peshkimit, gjuetisë, marrjen e kafshëve dhe korrjen e bimëve apo shkatërrimin e tyre, si dhe tregëtinë e kafshëve, pjesëve të kafshëve, bimëve, pjesëve të bimëve, që gjallojnë apo kanë origjinën në zonën veçanërisht të mbrojtur.

(h) rregullore dhe po qe e nevojshme edhe ndalime për çdo aktivitet apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojë gjendjen e konservimit të ekosistemit apo specieve apo që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore apo kulturore të zonës veçanërisht të mbrojtur;

(i) çdo masë tjetër që ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së proceseve ekologjike e biologjike dhe pejsazhit.

## **Neni 7**

### **Planifikimi dhe menaxhimi**

1. Palët, në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar, miratojnë planifikimin, menaxhimin, masat e mbikqyrjes dhe të monitorimit për zonat veçanërisht të mbrojtura.

2. Këto masa duhet të përfshijnë për çdo zonë veçanërisht të mbrojtur:

(a) zhvillimin dhe miratimin e planit të menaxhimit që specifikon kuadrin ligjor dhe institucional dhe masat menaxhuese dhe mbrojtëse të aplikueshme;

(b) monitorimin e vazhdueshëm të proceseve ekologjike, habitateve, dinamikave të popullatave, pejsazheve, si dhe ndikimet e aktiviteteve të njeriut;

(c) pjesëmarrjen aktive të popullsisë e komuniteteve lokale, sipas rastit, në menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, përfshi asistencën për banorët lokalë që mund të preken nga shpallja e këtyre zonave;

(d) miratimi i mekanizmave për të financuar nxitjen dhe menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura si dhe për zhvillimin e aktiviteteve që sigurojnëse menaxhimi përkon me objektivat e këtyre zonave;

(e) rregulloret e aktiviteteve në përputhje me objektivat për të cilat është shpallur zona e mbrojtur dhe kushtet e lejeve përkatëse.

(f) trainimin e menaxherëve dhe personelit të kualifikuar teknik, si dhe zhvillimin e një infrastrukture të përshtatshme.

3. Palët duhet të sigurojnë që planet kontigjente kombëtare të përfshijnë masa për t'u përgjigjur incidenteve që mund të shkaktojnë dëmtime apo përbëjnë kërcënime në zonat veçanërisht të mbrojtura.

4. Kur shpallen zona veçanërisht të mbrojtura, zona që përfshijnë njëkohësisht territore detare e tokësore, Palët duhet të përpiqen të sigurojnë kordinimin e administrimit dhe menaxhimit si një e pandarë.

## **SEKSIONI 2: ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA ME RËNDËSI PËR MESDHEUN.**

### **Neni 8**

#### **Hartimi i listës së zonave veçanërisht të mbrojtura me rëndësi për Mesdheun**

1. Me qëllim që të nxisë bashkëpunimin në menaxhimin dhe konservimin e zonave natyrore, si dhe në mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe habitateve të tyre, Palët duhet të hartojnë një "Listë të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura me Rëndësi për Mesdheun", e cila që këtej e tutje do të referohet nga ne si në origjinal "Lista SPAMI".

2. Lista SPAMI mund të përfshijë zonat që:

- janë të rëndësishme për konservimin e komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike në Mesdhe;
- përmbajnë ekosisteme specifike në zonën e Mesdheut apo habitate të specieve të rrezikuara;
- paraqesin rëndësi të veçantë në nivelet shkencore, estetike, kulturore apo edukative.

3. Palët bien dakord:

(a) të njohin rëndësinë e veçantë të këtyre zonave për Mesdheun;

(b) të përmbushin masat e aplikueshme për SPAMI-in dhe të mos autorizojnë apo të ndërmarrin ndonjë aktivitet që mund të jetë në kundërshtim me objektivat për të cilat është shpallur SPAMI.

### **Neni 9**

#### **Procedura për hartimin dhe listimin e spami-it**

1. SPAMI mund të krijohet, duke ndjekur procedurën e parashikuar në paragrafin 2 deri 4 të këtij neni, në: (a) zonat detare dhe bregdetare në sovranitetin ose juridiksionin e Palëve; (b) zonat që ndodhen pjesërisht apo plotësisht në detet me rëndësi të lartë ndërkombëtare.

2. Propozimet për përfshirjen në listë mund të paraqiten:

(a) nga pala e interesuar, nëse zona është e vendosur në një hapësirë të përcaktuar, mbi të cilën ajo ushtron sovranitetin dhe juridiksionin e saj-

(b) nga dy apo më shumë Palë kufitare në rast se përfshihen në zona pjesërisht apo plotësisht në detet me rëndësi të lartë ndërkombëtare;

(c) nga Palët kufitare që përfshihen në zonat ku kufijtë e sovranitetit dhe juridiksionit kombëtar nuk janë përcaktuar ende.

3. Palët që bëjnë propozime për përfshirjen në listën SPAMI, duhet të paraqesin në Qendër një raport paraprak që do të përmbajë informacione për vendndodhjen gjeografike të zonës, karakteristikat ekologjike

dhe fizike, statusin e saj legal, planet e menaxhimit dhe mënyrat e zbatimit të tyre, si edhe në vlerësim të gjendjes për të justifikuar rëndësinë në Mesdhe:

(a) Kur propozimi formulohet sipas paragrafit 2(b) dhe 2(c) të këtij neni, Palët e interesuara duhet të konsultohen me njëra-tjetrën me synim sigurimin e vazhdueshmërisë së masave menaxhuese dhe mbrojtëse të propozuara, si dhe për mënyrat e zbatimit të tyre;

(b) Propozimet e bëra në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të tregojnë masat e aplikueshme për mbrojtje dhe menaxhim të zonës si dhe për mënyrat e zbatimit të tyre.

4 Procedura për përfshirjen e zonës së propozuar në listë është si më poshtë:

(a) për çdo zonë, propozimi duhet t'u parashtrohet Pikave Fokale Kombëtare, të cilat duhet të ekzaminojnë konformitetin e saj me udhëzuesin dhe kriteret e përshtatura sipas nenit 16;

(b) nëse një propozim i bërë në përputhje me nënparagrafët 2(a) të këtij neni përmbush udhëzimet dhe kriteret e përbashkëta, pas vlerësimit, organizata do të informojë "Mbledhjen e Palëve" e cila do të vendosë të përfshijë zonën, në listën SPAMI

(c) nëse një propozim i bërë në përputhje me nënparagrafët 2(b) dhe 2(c) të këtij neni përmbush udhëzimet dhe kriteret e përbashkëta, Qendra duhet t'ia kalojë atë organizatës, e cila do të informojë "Mbledhjen e Palëve". Vendimi për përfshirjen e zonës në Listën SPAMI duhet të ndërmerret me mirëkuptimin e Palëve kontraktuese, që gjithashtu do të aprovojnë masat e aplikueshme të menaxhimit në zonë.

5. Palët të cilat propozuan përfshirjen e zonës në listë, duhet të zbatojnë masat mbrojtëse dhe konservuese të specifikuar në propozimet e tyre në përshtatje me paragrafin 3 të këtij neni. Palët kontraktuese duhet të marrin përsipër të respektojnë rregullat e caktuara. Qendra duhet të informojë organizatat ndërkombëtare kompetente për listën dhe masat e marra në SPAMI.

6. Palët mund ta rishikojnë listën SPAMI. Për këtë Qendra duhet të përgatisë një raport.

## **Neni 10**

### **Ndryshimet në statusin e SPAMI-t**

Nuk duhet të bëhen ndryshime në përcaktimet e kufijve apo statusin legal të një zone tashmë të përfshirë në SPAMI, apo në heqjen e një pjesë ose të gjithë kësaj zone, veçse në rastet kur këto ndryshime justifikohen nga arsye të rëndësishme, duke marrë parasysh ruajtjen e mjedisit dhe për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë protokoll, duhet të ndiqet një procedurë e ngjashme për krijimin e SPAMI-t dhe përfshirjen e tij në listë.

## **PJESA III**

### **MBROJTJA DHE RUAJTJA E SPECIEVE**

## **Neni 11**

### **Masat kombëtare për mbrojtjen dhe ruajtjen e specieve**

1. Palët duhet të menaxhojnë speciet e florës dhe faunës me qëllim mirëmbajtjen e tyre në një gjendje të favorshme konservimi.

2. Palët, në zonat që janë nën sovranitetin ose juridiksionin ndërkombëtar të tyre, do të identifikojnë dhe hartojnë listat e specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara të florës e faunës dhe do të japin statusin e mbrojtjes për këto specie. Palët duhet të rregullojnë, dhe kur është e nevojshme të ndalojnë aktivitetet që kanë efekte negative në speciet e lartpërmendura apo habitatet e tyre dhe të realizojnë menaxhimin, planifikimin dhe masa të tjera për sigurimin e një gjendjeje të favorshme konservimi të këtyre specieve.

3. Në lidhje me speciet e mbrojtura të faunës, Palët duhet të kontrollojnë dhe kur është e përshtatshme të ndalojnë:

(a) marrjen, zotërimin apo vrasjen (përfshi këtu sa më shumë të jetë e mundur edhe rastet kur marrja, zotërimi apo vrasja janë rastësore), tregëtimin komercial, transportin dhe ekspozimin për qëllime komerciale të këtyre specieve, vezëve të tyre, pjesëve apo produkteve të tyre;

(b) sa më shumë të jetë e mundur, shqetësimin e faunës së egër, veçanërisht gjatë periudhave të shtimit, inkubacionit, dimërimit apo migrimin, si dhe në periudha të tjera të streseve biologjike.

4. Palët, përveç masave të specifikuar në paragrafët e mësipërme, duhet të kordinojnë përpjekjet e tyre, nëpërmjet aksioneve dy apo shumëpaleshe, duke përfshirë nëse nevojitet, marrëveshjet për mbrojtjen dhe përtëritjen e specieve shtegtare, kufijtë e gjallimit të të cilave shtrihen në zonat ku aplikohet ky protokoll.

5. Në lidhje me speciet e mbrojtura të florës dhe pjesës së produkteve të tyre, Palët duhet të rregullojnë, kur është e nevojshme, të ndalojnë të gjitha format e shkatërrimit apo shqetësimit, përfshi këputjen, mbledhjen, prerjen, shkuljen me githë rrënjë, zotërimin e tyre, tregëtimin komercial, apo transportin dhe ekspozitat për qëllime komerciale të këtyre specieve.

6. Palët duhet të formulojnë dhe miratojnë masa dhe plane me qëllim riprodhimin “ex-situ”, veçanërisht riprodhimin e mbyllur (artificial ose me menaxhim intensiv), të faunës së mbrojtur dhe përhapjen e florës së mbrojtur.

7. Palët duhet të përpiqen, direkt apo nëpërmjet Qendrës, të konsultohen me shtetet kufitare që nuk janë Palë të këtij protokollit, me qëllim kordinimin e përpjekjeve për menaxhimin dhe mbrojtjen e specieve të kërcënuara apo rrezikuara.

8. Palët duhet të bëjnë parashikime, kur ka mundësi, për rikthimin e specieve të mbrojtura të eksportuara apo të marra ilegalisht. Palët duhet të përpiqen për rifutjen e këtyre specieve në habitatet e tyre natyrore.

## **Neni 12**

### **Masat e bashkëpunimit për mbrojtjen dhe konservimin e specieve**

1. Palët duhet të marrin masat e bashkëpunimit për sigurimin dhe konservimin e florës dhe faunës të listuara në anekset e këtij protokollit që lidhen me Listën e Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara dhe listës së specieve, shfrytëzimi i të cilave është i rregulluar me ligj.

2. Palët duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe ripërtëritjen optimale të specieve të faunës dhe florës të listuara në aneksin që i referohet Listës së Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara, duke përshtatur në nivel kombëtar masat e nxjerra për këtë qëllim në paragrafët 3 dhe 5 të nenit 11 të këtij Protokollit.

3. Palët duhet të ndalojnë shkatërrimin apo dëmtimin e habitateve të specieve të listuara në Aneksin e Listës së Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara dhe duhet të formulojnë e zbatojnë planet e veprimit për mbrojtjen dhe ripërtëritjen e tyre. Ato duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë në zbatimin e planeve përkatëse të veprimit tashmë të miratuara.

4. Palët, në bashkëpunim me organet ndërkombëtare kompetente, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e konservimit të specieve të listuara në aneksin e listës së specieve, shfrytëzimi i të cilave është i rregulluar me ligj dhe në të njëjtën kohë të autorizojnë dhe rregullojnë me ligj shfrytëzimin e këtyre specieve, duke siguruar dhe mirëmbajtur në këtë mënyrë një gjendje të favorshme të konservimit të tyre.

5. Kur kufijtë e zonës së një specieje të rrezikuar apo kërcënuar shtrihen në të dy anët e një kufiri kombëtar apo në limitet që ndajnë territoret apo zonat nën sovranitetin e juridiksionin e të dy Palëve të këtij protokollit, këto Palë duhet të bashkëpunojnë me qëllim sigurimin e mbrojtjes e konservimit dhe nëse është e nevojshme, ripërtëritjes së këtyre specieve.

6. Kur parashikohet se nuk ka zgjidhje të tjera të favorshme dhe se përjashtimet nuk dëmtojnë mbijetesën e popullatave të specieve të tjera, Palët mund të pranojnë edhe përjashtime për sa i përket

aktiviteteve të ndaluara të përshkruara, për speciet e listuara në aneksin e protokollit, për qëllime shkencore, edukuese apo menaxhuese, të dobishme për sigurimin e mbijetesës së specieve apo parandalimin e dëmtimeve të rëndësishme. Këto përjashtime duhen t'u njoftohen Palëve kontraktuese.

### **Neni 13**

#### **Futja e specieve jointdigjene ose gjenetikiisht të modifikuara**

1. Palët duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e futjeve të qëllimta apo aksidentale të specieve jointdigjene ose atyre të modifikuara gjenetikiisht në habitatet natyrore dhe të ndalojnë futjen e atyre specieve që mund të kenë ndikime të rënda në ekosistemin, habitatet apo speciet në zonat ku aplikohet ky protokoll.

2. Palët duhet të përpiqen të zbatojnë të gjitha masat e mundshme për të larguar speciet që janë futur ndërkohë, kur nga vlerësimi shkencor rezulton se këto specie shkaktojnë apo mund të shkaktojnë dëmtime në ekosistemin, habitat apo specie në zonat ku zbatohet ky protokoll.

## **PJESA VI**

### **DISPOZITAT E PËRBASHKËTA PËR ZONAT E MBROJTURA DHE SPECIET**

#### **Neni 14**

##### **Amendamentet e anekseve**

1. Procedurat për amendamentet për anekset e këtij protokollit parashtrihen në nenin 23 të kësaj konvente.

2. Të gjitha amendamentet e propozuara të paraqitura për shqyrtim në Mbledhjen e Palëve Kontraktuese do t'i nënshtrohen një vlerësimi paraprak në mbledhjen e Pikave Fokale Kombëtare.

#### **Neni 15**

##### **Inventarët**

Çdo Palë kontraktuese duhet të hartojë inventare të plota të:

(a) zonave në të cilat ato ushtrojnë sovranitetin e juridiksionin dhe përmbajnë ekosisteme të rralla apo të ndjeshme, që janë rezervuare të shumëllojshmërisë biologjike, që janë të rëndësishme për speciet e rrezikuara apo kërcënuara;

(b) specieve të florës dhe faunës që janë të rrezikuara ose të kërcënuara.

#### **Neni 16**

##### **Udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta**

Palët duhet të miratojnë:

(a) kriteret e përbashkëta për zgjedhjen e zonave të mbrojtura detare e bregdetare që duhen përfshirë në Listen SPAMI dhe që do të vihen si aneks në protokoll;

(b) kriteret: të përbashkëta për përfshirjen e specieve të tjera në anekset

(c) udhëzues për shpalljen dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura.

Udhëzuesi dhe kriteret e referuara më sipër në paragrafët (b) dhe (c) mund të amendohen nga mbledhja e Palëve në bazë të propozimeve të bëra nga një ose më shumë Palë.

#### **Neni 17**

##### **Vlerësimi i ndikimit në mjedis**

Në procesin e planifikimit për të marrë vendime për projekte industriale dhe aktivitete që mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në zonat e mbrojtura, speciet dhe habitatet e tyre, Palët do të vlerësojnë dhe marrin në konsideratë ndikimin direkt ose indirekt, të çastit ose afatgjatë, përfshi impaktin e grumbulluar të projekteve dhe aktiviteteve që u përmenden.

## **Neni 18**

### **Integrimi i aktiviteteve tradicionale**

1. Në formulimin e masave mbrojtëse, Palët do të marrin parasysh jetesën tradicionale dhe aktivitetet kulturore të popullatave të tyre lokale. Ato do të bëjnë përjashtime nëse është e nevojshme për të përballuar nevoja të tilla. Asnjë përjashtim i lejuar për këto arsye:

(a) Nuk do të rrezikojë si ruajtjen e ekosistemeve të mbrojtura në bazë të këtij protokollit ashtu dhe proceset biologjike që kontribuojnë në ruajtjen e atyre ekosistemeve;

(b) nuk do të shkaktojë zhdukjen, ose pakësimin e ndjeshëm të numrit të individëve që përbëjnë popullatën ose speciet e florës e faunës, në veçanti speciet shtegtare ose endemike, të rrezikuara ose të kërcënuara.

2. Palët që ofrojnë përjashtime nga masat mbrojtëse do të informojnë Palët kontraktuese.

## **Neni 19**

### **Publiciteti, informimi, ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi**

1. Palët do t'i japin publicitetin e duhur ngritjes së zonave veçanërisht të mbrojtura, kufijve të tyre, rregullave të aplikueshme dhe përcaktimit të specieve të mbrojtura, habitateve të tyre dhe rregullave të aplikueshme.

2. Palët do të përipiqen të informojnë publikun për interesin dhe vlerat e zonave veçanërisht të mbrojtura e speciet dhe për dijet shkencore që mund të fitohen nga pikëpamja e ruajtjes së natyrës dhe këndvështrime të tjera. Ky informacion duhet të ketë një vend të vetin në programet edukative. Palët duhet gjithashtu të përipiqen të nxisin pjesëmarrjen e publikut të tyre dhe të organizatave të ruajtjes në masat që janë të nevojshme për mbrojtjen e zonave dhe specieve respektive, duke përfshirë dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.

## **Neni 20**

### **Kërkimet shkencore, teknike dhe menaxhuese**

1. Palët do të inkurajojnë dhe zhvillojnë kërkime shkencore dhe teknike në lidhje me qëllimet e këtij protokollit. Ato gjithashtu do të inkurajojnë dhe zhvillojnë kërkime shkencore për përdorimin e qëndrueshëm të zonave veçanërisht të mbrojtura dhe menaxhimin e specieve të mbrojtura.

2. Palët do të konsultohen, kur është e nevojshme, me njëra-tjetrën dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente për të identifikuar, planifikuar dhe ndërmarrë kërkime shkencore e teknike dhe programe monitoruese të nevojshme për identifikimin dhe monitorimin e zonave dhe specieve të mbrojtura dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të marra për të zbatuar planet e menaxhimit dhe përmirësimit.

3. Palët do të këmbëjnë, direkt ose nëpërmjet Qendrës, informacion teknik dhe shkencor lidhur me programet kërkimore dhe menaxhuese aktuale të planifikuara si dhe rregullat e tyre. Brenda mundësive maksimale, ato do të koordinojnë programet e tyre kërkimore dhe menaxhuese dhe do të përipiqen së bashku të përcaktojnë ose standartizojnë procedurat e tyre.

4. Në kërkimet teknike dhe shkencore, Palët do të japin prioritet për SPAMI-n dhe speciet e përfshira në anekset e këtij protokollit.

## **Neni 21**

### **Kooperimi reciprok**



1. Palët, direkt ose me asistencën e Qendrës ose organizatave ndërkombëtare të interesuara, do të ndërtojnë programe bashkëpunimi për të koordinuar vendosjen, konservimin, planifikimin dhe menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, si dhe seleksionimin, menaxhimin dhe konservimin e specieve të mbrojtura. Do të këtë shkëmbime të rregullta të informacionit lidhur me karakteristikat e zonave dhe specieve të mbrojtura, eksperiencën e fituar dhe problemet e ndeshura.

2. Palët, në rastin më të parë, do t'u komunikojnë Palëve të tjera, shteteve që mund të jenë të prekura dhe Qendrës, çdo situatë që rrezikon ekosistemet e zonave veçanërisht të mbrojtura ose mbijetesën e specieve të mbrojtura të florës dhe faunës.

## **Neni 22**

### **Asistenca reciproke**

1. Palët do të koeporojnë, direkt ose me asistencën e Qendrës ose të organizatave ndërkombëtare të interesuara, në formulimin, financimin dhe implementimin e programeve të asistencës reciproke dhe asistencës për vendet në zhvillim që shprehin nevojën për këtë asistencë me synim zbatimin e këtij protokollit.

2. Këto programe do të përfshijnë edukimin mjedisor të publikut, trainimin e personelit shkencor teknik dhe menaxhues, kërkimin shkencor, blerjen, përdorimin, hartimin, zhvillimin e pajisjeve të duhura dhe transferimin e teknologjisë mbi kushtet e avantazhit që do to bien dakord Palët e interesuara.

3. Palët, në çështje të asistencës reciproke, do të japin prioritet për SPAMI-n dhe speciet e përcaktuara në anekset e këtij protokollit.

## **Neni 23**

### **Raportet e palëve**

Palët do të paraqesin në mbledhjet e zakonshme të Palëve, raportin për zbatimin e këtij protokollit, veçanërisht për:

- (a) statusin dhe gjendjen e zonave të përfshira në listën e SPAMI-t;
- (b) çdo ndryshim në përcaktimin e kufijve ose statusin ligjor të SPAMI-t dhe specieve të mbrojtura;
- (c) përjashtimet e mundshme të lejuara nga nenet 12 dhe 18 të këtij protokollit.

## **PJESA V**

### **Dispozitat institucionale**

## **Neni 24**

### **Pikat fokale kombëtare**

Secila Palë do të caktojë një Pikë Fokale Kombëtare që do të shërbejë si lidhje me Qendrën për aspektet teknike dhe shkencore të zbatimit të këtij protokollit. Pikat Fokale Kombëtare do të takohen periodikisht për të kryer funksionet që rrjedhin nga ky protokoll.

## **Neni 25**

### **Koordinimi**

#### **Neni 25**

#### **Koordinimi**

1. Organizata është përgjegjëse për kordinimin e zbatimit e këtij protokollit. Për këtë qëllim, do të ketë mbështetje nga Qendra, të cilës mund t'i besojë funksionet e mëposhtme:

(a) ndihmë ndaj Palëve, në bashkëpunim me organizatat kompetente ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, në:

- caktimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura veçanërisht në zonën që aplikohet ky protokoll;
- drejtimin e programeve të kërkimit teknik dhe shkencor siç përcaktohet në nenin 20 të këtij protokollit;

- drejtimin e shkëmbimit të informacionit teknik dhe shkencor midis Palëve siç përcaktohet në nenin 20 të këtij protokoll;
  - përgatitjen e planeve të menaxhimit për zonat dhe speciet veçanërisht të mbrojtura;
  - zhvillimin e programeve të bashkëpunimit në vijim të nenit 21 të këtij protokoll;
  - përgatitjen e materialeve edukative për grupe të ndryshme.
- (b) mbledhjen dhe organizimin e takimeve të Pikave Fokale Kombëtare dhe sigurimin e shërbimeve të sekretarisë.
- (c) formulimin e rekomandimeve për udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta në vijim të nenit 16 të këtij protokoll;
- (d) krijimin dhe aktualizimin e një baze të dhënash për zonat veçanërisht të mbrojtura, speciet e mbrojtura dhe të tjera që i përkasin këtij protokoll;
- (e) përgatitjen e raporteve dhe studimeve teknike që mund të kërkohen për zbatimin e këtij protokoll;
- (f) përpunimin dhe zbatimin e programeve të trainimit të përmendura në nenin 22, paragrafi 2.
- (g) kooperimin me organizatat qeveritare dhe joqeveritare rajonale dhe ndërkombëtare që kanë lidhje me zonat dhe speciet e mbrojtura, me kusht që të respektohen specifikat e çdo organizate dhe nevoja për të shmangur dublimin e aktiviteteve;
- (h) zbatimin e funksioneve të caktuara në planet e veprimit të miratuara në kuadër të këtij protokoll;
- (i) kryerja e çdo funksioni tjetër të caktuar nga Palët.

## **Neni 26**

### **Takimet e palëve**

1. Takimet e zakonshme të Palëve të këtij protokoll do të mbahen në varësi të takimeve të zakonshme të Palëve kontraktuese të konventës mbajtur sipas nenit 18 të Konventës. Palët mundet gjithashtu të mbajnë takime të jashtëzakonshme në përputhje me këtë nen.

2. Takimet e Palëve të këtij protokoll kanë qëllim të veçantë:

- (a) të shqyrtojnë zbatimin e këtij protokoll;
- (b) të mbikqyrin punën e organizatës dhe të Qendrës në lidhje me zbatimin e këtij protokoll dhe të sigurojnë orientim politik të aktiviteteve të tyre;
- (c) të konsiderojnë efikasitetin e masave të marra për menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave dhe specieve, të shohin nevojat për masa të tjera, veçanërisht në formën e anekseve dhe amendamenteve të këtij protokoll dhe anekseve të tij;
- (d) të miratojnë udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta të parashikuara në nenin 16 të këtij protokoll;
- (e) të shqyrtojnë raportet e transmetuara nga Palët sipas nenit 23 të këtij protokoll, si dhe çdo informacion tjetër përkatës, të cilin Palët e transmetojnë nëpërmjet Qendrës;
- (f) t'u bëjnë rekomandime Palëve mbi masat që do të merren për zbatimin e këtij protokoll;
- (g) të ekzaminojnë rekomandimet e takimeve të Pikave Fokale Kombëtare sipas nenit 24 të këtij protokoll;
- (h) të vendosin për përfshirjen e një hapësire në listën SPAMI, në përputhje me nenin 9, paragrafi 4 i këtij protokoll;
- (i) të ekzaminojnë ndonjë çështje tjetër që ka të bëjë me këtë protokoll;
- (j) të diskutojnë dhe vlerësojnë përjashtimet e lejuara nga Palët në përshtatje me nenin 12 dhe 18 të këtij protokoll.

## **PJESA VI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

## **Neni 27**

### **Efektet e protokollit në legjislacionin kombëtar**

Klauzolat e këtij Protokoll nuk do të prekin të drejtën e Palëve për të marrë masa të brendshme më të repta për zbatimin e këtij protokoll.

## **Neni 28**

### **Marrëdhëniet me palët e treta**

1. Palët duhet të ftojnë shtetet që nuk janë Palë të këtij protokollit dhe organizatat ndërkombëtare të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij protokollit.

2. Palët duhet të marrin përsipër miratimin e masave të përshtatshme në përputhje me ligjin ndërkombëtar, për t'u siguruar se askush nuk do të angazhohet në aktivitete që janë në kundërshtim me parimet apo qëllimet e këtij protokollit.

## **Neni 29**

### **Nënshkrimi**

Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Barcelonë me 10 qershor 1995 dhe në Madrid nga 11 qershori 1995 deri më 10 qershor 1996 nga Palët kontraktuese në konventë.

## **Neni 30**

### **Ratifikimi, pranimi ose miratimi**

Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentat e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të jenë të depozituara në Qeverinë e Spanjës, e cila do të marrë përsipër funksionet e sekretariatit.

## **Neni 31**

### **Afrimi**

Që nga 10 qershori 1996, ky protokoll do të jetë i hapur për afrim për çdo shtet dhe grupim ekonomik rajonal i cili është Palë e konventës.

## **Neni 32**

### **Hyrja në fuqi**

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit, miratimit të tij, ose afrimit të protokollit.

2. Nga data e hyrjes në fuqi, ky protokoll do të zëvendësojë Protokollin e Zonave Veçanërisht të Mbrotitura të Mesdheut të vitit 1982, në marrëdhënie ndërmjet Palëve për të dy instrumentat.

Ky protokoll është firmosur në prani të nënshkruesve të autorizuar nga qeveritë e tyre për këtë qëllim. NË DËSHMI nënshkruesit, duke qenë të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

BËRË në Barcelonë, më 10 Qershor 1995, në një kopje të vetme në arabisht, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalente.

## **ANEKSI I**

### **KRITERET E PËRBASHKËTA PËR ZGJEDHJEN E ZONAVE TË MBROJTURA DETARE DHE BREGDETARE QË MUND TË PËRFSHIHEN NË LISTËN SPAMI**

#### **A. PARIMET E PËRGJITHSHME**

Palët kontraktuese bien dakord që parimet e përgjithshme të mëposhtme do t'i udhëheqin në punën e tyre për përcaktimin e Listave SPAMI:

a) Konservimi i trashëgimisë kulturore është qëllimi bazë që duhet të karakterizojë SPAMIN. Ndjekja e qëllimeve të tjera siç janë konservimi i trashëgimisë kulturore dhe nxitja e kërkimit shkencor, edukimit, pjesëmarrjes, bashkëpunimit, janë shumë të dëshirueshme në SPAMI dhe përbëjnë një faktor në favor të një qendre për t'u përfshirë në listë, në shkallën që ajo mbetet në harmoni me qëllimet e konservimit.

b) Nuk imponohet asnjë kufi për numrin e përgjithshëm të zonave që duhen përfshirë në listë ose në numrin e zonave që çdo individ mund të propozojë.

Megjithatë Palët bien dakord që qendrat do të zgjidhen mbi një bazë shkencore dhe do të përfshihen në listë në përputhje me cilësitë e tyre, ato pra duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në protokoll dhe kriteret aktuale.

c) Lista SPAMI dhe shpërndarja e tyre gjeografike duhet të përfaqësojë rajonin e Mesdheut dhe biodiversitetin e tij. Për këtë qëllim lista duhet të përfaqësojë numrin më të lartë të mundshëm dhe tipet e habitateve dhe ekosistemet.

d) Lista SPAMI do të përbëjë zemrën e rrjetit që ka për synim ruajtjen efektive të trashëgimisë së Mesdheut. Për të arritur këtë objektiv, Palët do të zhvillojnë bashkëpunimin e tyre dy apo shumë palesh në fushën e konservimit dhe menaxhimit të qendrave natyrore dhe veçanërisht nëpërmjet ngritjes së listave ndërkuftare SPAMI

e) Qendrat e përfshira në SPAMI kanë për të patur një vlerë shembulli dhe modeli për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të rajonit. Për këtë qëllim Palët sigurohen që qendrat në listë të pajisen me një status ligjor të përshtatshëm, masa mbrojtëse, metoda dhe mjete menaxhimi.

## **B. TIPARE TË PËRGJITHSHME TË ZONËS QË MUND TË PËRFSHIHET NË LISTËN SPAMI**

1. Që të jetë e përshtatshme për t'u përfshirë në Listën SPAMI, një zonë duhet të përmbushë të paktën një nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8, paragrafi 2 të protokollit. Disa nga këto kriteret të përgjithshme në disa raste mund të përmbushen nga e njëjta zonë dhe ky kusht vetëm mund të përforcojë përfshirjen e zonës në listë.

2. Vlera rajonale është një kërkesë bazë për një zonë që të përfshihet në Listën SPAMI. Kriteret e mëposhtme duhet të përdoren për vlerësimin e interesit mesdhetar të një zone:

a) unikalitetin

Zona përmban ekosisteme unike ose të rralla si dhe specie të rralla ose endemike.

b) përfaqësimin natyror

Zona ka procese, komunitete apo habitate ose karakteristika natyrore shumë përfaqësuese.

Përfaqësimi është shkalla në të cilën një zonë përfaqëson një tip habitati, proceset ekologjike, komunitetin biologjik, tiparet fiziografike ose karakteristikat të tjera natyrore.

c) Diversitetin

Zona ka një diversitet të lartë specimesh, komunitetesh, habitatesh dhe ekosistemesh.

d) Natyrshmërinë

Zona ka një shkallë të lartë natyrshmërie si rezultat i mungesës ose nivelit të ulët të shqetësimit nga aktivitetet e njeriut dhe degradimi.

e) Prania e habitateve që janë kritike për speciet e rrezikuara, të kërcënuara dhe endemike.

f) Përfaqësimi kulturor

Zona ka një vlerë të lartë përfaqësimi në lidhje me trashëgiminë kulturore për shkak të aktiviteteve tradicionale me vlera të shëndosha mjedisore të integruara me natyrën që ndihmojnë mirëqënien e popullsisë lokale.

3. Për t'u përfshirë në listën SPAMI, një zonë që ka interes shkencor, edukativ ose estetik duhet respektivisht të paraqesë një vlerë të veçantë për kërkime në fushën e shkencave natyrore ose për aktivitetet e edukimit dhe ndërgjegjësimin mjedisor ose mund të kenë tipare natyrore të rëndësishme, peisazhe etj.

4. Përveç kriterit themelor të specifikuar në nenin 8, paragrafi 2 të protokollit duhet të konsiderohen një numër karakteristikash dhe faktorësh si të favorshëm për përfshirjen e qendrës në listë. Këto përfshijnë:

a) ekzistencën e rreziqeve që mund të dëmtojnë vlerat ekologjike, biologjike estetike ose kulturore të zonës;

b) angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në përgjithësi dhe veçanërisht të komunitetit shkencor në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të zonës-,

- c) ekzistencën e një organizmi që përfaqëson publikun, sektorët profesional, joqeveritar dhe komunitetin shkencor që është i përfshirë në zonë;
- d) ekzistenca në zona për mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm.
- e) ekzistenca e një plani menaxhimi bregdetar të integruar brenda kuptimit të nenit 4, paragrafi 3 (e) të konventës.

### **C. STATUSI LIGJOR**

1. Të gjitha zonat e përshtatshme për përfshirjen në listën SPAMI, duhet të pajisen me një status ligjor që garanton mbrojtjen e tyre efektive afatgjatë.

2. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI, një zonë në të cilën një Palë ushtron sovranitet dhe juridiksion duhet të ketë një status mbrojtjeje të njohur nga pala e interesuar.

3. Në rastin e zonave të ndodhura pjesërisht ose tërësisht pranë detit ose në zona ku nuk janë përcaktuar kufizimet e sovranitetit ose juridiksionit kombëtar, statusi ligjor, plani i menaxhimit, masat e aplikueshme dhe elementë të tjerë të përfshirë në nenin 9, paragrafi 3, të protokollit do të sigurohen nga Palët fqinje të interesuara në propozimin për përfshirjen në listën SPAMI.

### **D- MASAT MBROJTËSE: PLANIFIKUESE DHE MENAXHUESE**

1. Objektivat e konservimit dhe menaxhimit duhet të përcaktohen qartë në tekstet e çdo qendre dhe do të përbëjnë një bazë për vlerësimin e mjaftueshmërisë së masave të marra dhe efikasitetit të zbatimit në rishikimin e Listës SPAMI.

2. Masat mbrojtëse, planifikuese dhe menaxhuese të zbatueshme për çdo zonë duhet të jenë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të konservimit afatshkurtër e afatgjatë dhe të marrë në veçanti parasysh kërcënimet që i bëhen.

3. Masat e mbrojtjes, planifikimit dhe menaxhimit do të bazohen në njohuritë e duhura të elementëve të mjedisit natyror dhe të faktorëve social-ekonomikë dhe kulturorë që karakterizojnë çdo zonë. Në rast të mangësive në njohuritë bazë, një zonë e propozuar në Listën SPAMI duhet të ketë një program për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit që mungojnë.

4. Kompetenca dhe përgjegjësia në administrimin dhe zbatimin e masave të konservimit për zonat e propozuara për t'u përfshirë në Listën SPAMI duhet të përcaktohen qartë në tekstet që zbatohen në secilën zonë.

5. Në lidhje me specifikën që karakterizon çdo qendër të mbrojtur, masat mbrojtëse për SPAMI duhet të kenë parasysh aspektet bazë të mëposhtme:

- a) forcimi i rregullave për lëshimin ose hedhjen e mbetjeve dhe substancave të tjera që direkt ose indirekt prishin integritetin e zonës.
- b) forcimi i rregullave të futjes ose ri-futjes së specieve në zonë;
- c) rregullimi i çdo aktiviteti ose veprimi që dëmton ose shqetëson speciet, ose mund të rrezikojnë statusin e konservimit të ekosistemeve ose specieve ose mund të prishin karakteristikat natyrore, kulturore ose estetike të zonës.
- d) rregullat e aplikueshme në zonat që rrethojnë sipërfaqen në fjalë.

6. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI një sipërfaqe e mbrojtur duhet të ketë një organizëm menaxhues të veshur me fuqi të mjaftueshme si dhe me mjetet dhe burimet njerëzore për të ndaluar dhe / ose kontrolluar aktivitetet që mund të jenë të kundërta me qëllimet e sipërfaqes së mbrojtur.

7. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI një zonë duhet të ketë një plan menaxhimi. Rregullat kryesore të këtij plani menaxhues do të përcaktohen në kohën e përfshirjes në listë dhe do të zbatohen menjëherë. Duhet të paraqitet një plan i detajuar i menaxhimit brenda tre vjetëve nga koha e përfshirjes. Nëse nuk zbatohet një detyrim i tillë zona rrezikohet të hiqet nga lista.

8. Për t'u përfshirë në listën SPAMI zona duhet të ketë një program monitorimi. Ky program duhet të përfshijë identifikimin dhe monitorimin e një numri parametrash të rëndësishëm për zonën në fjalë, për të arritur vlerësimin e gjendjes dhe evolucionin të zonës, si dhe efektivitetin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese që zbatohen në mënyrë që ato të mund të miratohen nëse nevojitet. Për këtë qëllim duhen ndërmarrë studime të mëtejshme.

## **ANEKSI II**

### **LISTA E SPECIEVE TË RREZIKUARA DHE TË KËRCËNUARA PROTOKOLL PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR NDOTJES SË DETIT MESDHE NGA HIDROKARBURET DHE SUBSTANCA TË TJERA TË DËMSHME NË RASTE EMERGJENCE.**

Palët kontraktuese në protokoll,

Duke qenë Palë të një konvente për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja,

Duke njohur ndotjen e lartë të detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme në hapësirën e Detit Mesdhe, që përbën një rrezik për shtetet bregdetare dhe ekosistemet detare,

Duke konsideruar që bashkëpunimi i të gjitha shteteve bregdetare të Mesdheut është i nevojshëm për të luftuar këtë ndotje,

Duke patur parasysh Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, 1973, Konventën Ndërkombëtare në lidhje me "Ndërhyrjen në Detet në Rastet e Dëmeve nga Ndotja me Hidrokarbure", 1969, si dhe protokollin në lidhje me "Ndërhyrjen në Detet në Rastet e Ndotjes Detare nga Substanca të Tjera Përveç Hidrokarbureve", 1973,

Duke patur parasysh më tej Konventën Ndërkombëtare mbi "Përgjegjësinë Civile për Dëmtimet nga Ndotja e Hidrokarbureve", 1969,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

#### **Neni 1**

Palët kontraktuese të këtij protokollit (që këtej e tutje do të quhen "Palë") do të koprojnë në marrjen e masave të nevojshme në rastet e rreziqeve të mëdha për mjedisin detar, bregdetin ose interesa të lidhura me një ose më shumë Palë për shkak të prezencës së sasive masive të hidrokarbureve ose të substancave të tjera të dëmshme që rezultojnë nga raste aksidentale ose akumulim i shkarkimeve të vogla që ndotin ose kërcënojnë të ndotin detin brenda hapësirës së përcaktuar në nenin 1 të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja (që më poshtë do të quhet "konventa").

Protokollin në lidhje me "Bashkëpunimin në Luftën Kundër Ndotjes së Detit Mesdhe nga Hidrokarburet dhe Substancat e Tjera të Dëmshme në Rastet e Emergjencës" (Protokollin i Emergjencës) ishte adoptuar më 16 shkurt 1976 nga Konferenca e Plotfuqishme e Shteteve Bregdetare të Rajonit të Mesdheut për Mbrojtjen e Detit Mesdhe, e mbajtur në Barcelonë. Protokollin hyri në fuqi më 12 shkurt 1978.

#### **Neni 2**

Për qëllim të këtij protokollit, termi "interesa të lidhura" do të thotë interesa të një shteti bregdetar që ndikohet ose kërcënohet direkt dhe që ka të bëjë, ndërmjet të tjerave, me:

- (a) Aktivitetet në ujrat bregdetare, në portet ose estuaret, duke përfshirë aktivitetet e peshkimit;
- (b) Kërkesat historike dhe turistike të hapësirës së marrë në konsideratë, duke përfshirë sportet ujore dhe aktivitetet çlodhëse;

- (c) Shëndetin e popullsisë bregdetare;
- (d) Ruajtjen e burimeve jetësore.

### **Neni 3**

Palët do të përpiqen të mbajnë dhe të promovojnë, ose individualisht ose nëpërmjet koperimit dypalesh ose shumëpalesh, planet kontigjente të tyre dhe mjetet për luftën kundër ndotjes së detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme. Këto mjete do të përfshijnë, në mënyrë të veçantë, pajisje, anije, avionë dhe forca njerëzore të përgatitura për veprime në raste të emergjencës.

### **Neni 4**

Palët do të zhvillojnë dhe aplikojnë, ose në mënyrë individuale ose nëpërmjet koperimit dypalesh apo shumëpalesh, aktivitete monitorimi që mbulojnë hapësirën e Detit Mesdhe me qëllim që të kenë një informacion sa më të saktë mbi situatën e referuar në nenin 1 të këtij protokolli.

### **Neni 5**

Në rastet e çlirimit ose hedhjes së substancave të dëmshme nga anijet, të paketuara, në kontenerë, çisterna portabël, çisterna ose vagona çisternë, Palët do të koprojnë sa më praktikisht në shpëtimin dhe rikuperimin e substancave të tilla në mënyrë të tillë që të reduktohet rreziku i ndotjes së mjedisit detar.

### **Neni 6**

1. Çdo Palë merr përsipër t'i shpërndajë Palëve të tjera informacionin në lidhje me:
  - (a) Organizatën kombëtare kompetente ose autoritetet përgjegjëse për të luftuar ndotjen e detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme;
  - (b) Autoritetet kombëtare kompetente përgjegjëse për marrjen e raporteve të ndotjes së detit nga hidrokarburet dhe substanca të tjera të dëmshme dhe për t'u marrë me çështjet që kanë të bëjnë me masat e asistencës ndërmjet Palëve;
  - (c) Rrugët e reja me anë të të cilave ndotja e detit nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme mund të shmangët, masat e reja për të luftuar ndotjen dhe zhvillimin e programeve kërkimore.

2. Palët të cilat kanë rënë dakord për të shkëmbyer informacion drejtpërdrejt ndërmjet tyre, megjithatë do ta komunikojnë këtë informacion në qendrën rajonale. Kjo e fundit do t'ia komunikojë këtë informacion Palëve të tjera dhe, mbi bazën e reciprocitetit, shteteve bregdetare të hapësirës së Detit Mesdhe të cilat nuk janë Palë të këtij protokolli.

### **Neni 7**

Palët marrin përsipër të kordinojnë përdorimin e mjeteve të komunikimit në dispozicion të tyre me qëllim që të sigurohet, me shpejtësinë dhe cilësinë e nevojshme, marrja, transmetimi dhe shpërndarja e të gjitha raporteve dhe informacionit urgjent që lidhet me incidentet dhe situatat e referuara në nenin 1. Qendra rajonale do të ketë mjetet e nevojshme të komunikimit për ta aftësuar atë që të marrë pjesë në këtë përpjekje të kordinuar dhe në mënyrë të veçantë, të përmbushë funksionet e caktuara asaj nga paragrafi 2 i nenit 10.

### **Neni 8**

1. Çdo Palë do t'i japë instruksione kapitenëve të anijeve që kanë flamurin e saj dhe pilotëve të avionëve të regjistruar në territorin e saj, duke i kërkuar atyre të raportojnë nëpërmjet kanaleve më të shpejta dhe të përshtatshme për rrethanat, dhe në përputhje me aneksin 1 të këtij protokolli, ose të një Pale ose qendre rajonale:
  - (a) Të gjithë aksidentet që shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të detit nga hidrokarburet ose substancat e tjera të dëmshme;
  - (b) Prezenca, karakteristikat dhe sipërfaqet ku janë derdhur hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme të vrojtuar në det të cilat përfaqësojnë një kërcënim serioz dhe të dukshëm për mjedisin detar ose bregdetin ose për interesat e një ose më shumë Palëve.

2. Informacioni i mbledhur në përputhje me paragrafin 1 do t'u jetë komunikuar Palëve të tjera që mund të jenë të ndikuara nga ndotja:

(a) Nga pala, e cila ka marrë informacionin, drejtpërdrejt ose në mënyrë të preferueshme, nëpërmjet qendrës rajonale; ose

(b) Nga qendra rajonale.

Në rast të komunikimit direkt ndërmjet Palëve, qendra rajonale do të jetë e informuar për masat e marra nga këto Palë.

3. Si konsekuencë e aplikimit të dispozitave të paragrafit 2, Palët nuk janë të lidhura nga detyrimi i nenit 9, paragrafi 2, i konventës.

#### **Neni 9**

1. Çdo Palë, e përballuar me llojin e situatës së përcaktuar në nenin 1 të këtij protokollit:

(a) do të bëjë vlerësimet e nevojshme të natyrës dhe shtrirjes së dëmeve, emergjencës ose, sipas rastit që mund të paraqitet, tipi dhe sasia e përafërt e hidrokarbureve ose substancave të tjera të dëmshme dhe drejtimi e shpejtësia e rrjedhjes;

(b) do të marrë çdo masë të praktikueshme, për të shmangur ose reduktuar efektet e ndotjes;

(c) do të njoftojë menjëherë të gjitha Palët e tjera, direkt ose nëpërmjet qendrës rajonale, për këto vlerësime dhe ndonjë veprim që ajo ka marrë ose ka për qëllim të marrë për të luftuar ndotjen;

(d) do të vazhdojë të vëzhgojë situatën sa më gjatë të jetë e mundur dhe ta raportojë atë në përputhje me nenin 8.

2. Atje ku aksioni është ndërmarrë për të luftuar ndotjen që vjen nga një anije, të gjitha masat e mundshme do të merren për të ruajtur personat që ndodhen në bord dhe sa më shumë të jetë e mundur, vetë anijen. Çdo Palë që ndërmerr një aksion të tillë do të informojë Organizatën Ndërqeveritare Detare Konsultative.

#### **Neni 10**

1. Çdo Palë që kërkon asistencë për të luftuar ndotjen nga hidrokarburet dhe substancat e tjera të dëmshme që ndotin ose kërcënojnë të ndotin brigjet e saj, mund të kërkojë asistencë nga Palët e tjera, direkt ose nëpërmjet qendrës rajonale të përmendur në nenin 6, duke filluar me Palët të cilat duken të jenë më të ndikuara nga ndotja. Kjo asistencë mund të përfshijë, në mënyrë të veçantë këshillim eksperti dhe paisjen ose vënien në dispozicion të pales së interesuar të produkteve, pajisjeve dhe fasiliteve të lundrimit detar. Palëve që u janë paraqitur kërkesa, do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të bërë të mundur këtë asistencë.

2. Atje ku Palët e përfshira në një aksion për të luftuar ndotjen nuk mund të bien dakord mbi organizimin e operacionit, qendra rajonale, me aprovimin e tyre, mund të kordinojë aktivitetin e pajisjeve të vëna në veprim nga këto Palë.

#### **Neni 11**

Zbatimi i dispozitave përkatëse të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij protokollit në lidhje me qendrën rajonale do të zgjerohet nëse është e nevojshme, për qendrat sub-rajonale me rastin e krijimit të tyre, duke marrë parasysh objektivat dhe funksionet e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me qendrën rajonale.

#### **Neni 12**

1. Takimet e zakonshme të palëve të këtij protokollit do të mbahen në lidhje me takimet e zakonshme të Palëve kontraktuese të konventës, sipas nenit 14 të konventës. Palët e këtij protokollit mundet gjithashtu të mbajnë takime të jashtzakonshme sipas nenit 18 të konventës.

2. Funkzioni i takimeve të Palëve të këtij protokollit në mënyrë të veçantë:

(a) Të mbajë nën vërejtje zbatimin e këtij protokollit, dhe të konsiderojë efikasitetin e masave të marra dhe nevojën për ndonjë masë tjetër, në mënyrë të veçantë në formën e anekseve;

(b) Të rishikojë dhe amendojë siç kërkohet ndonjë aneks të këtij protokollit;



(c) Të kryejë disa funksione të tjera që mund të jenë të përshtatshme për zbatimin e këtij protokoll.

### **Neni 13**

1. Dispozitat e konventës në lidhje me ndonjë protokoll do të aplikohen duke respektuar protokollin prezent.

2. Rregullat e procedurës dhe rregullat financiare të miratuara në përputhje me nenin 24 të konventës do të aplikohen në lidhje me këtë protokoll, në rast se Palët nuk bien dakord ndryshe.

NË PRANI të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kanë firmosur këtë protokoll.

BËRË në Barcelonë më 16 shkurt. 1976 në një kopje të vetme në gjuhët arabe, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalente dhe të vlefshëm.

## **ANEKS I**

### **PËRMBAJTJA E RAPORTIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 8 TË KËTIJ PROTOKOLLI**

1. Çdo raport do të përmbajë, sa më shumë të jetë e mundur, në përgjithësi:

- (a) Identifikimin e burimit të ndotjes (identitetin e anijes, nëse është e mundur);
- (b) Pozicionin gjeografik, kohën dhe datën e ndodhjes së incidentit ose të vëzhgimit të tij;
- (c) Kushtet e erës dhe detit që dominonin në zonë;
- (d) Atje ku ndotja vjen nga një anije, detajet e duhura në lidhje me kushtet e anijes.

2. Çdo raport do të përmbajë, kurdoherë që të jetë e mundur, në mënyrë të veçantë:

- (a) Një tregues të qartë ose përshkrimin e substancave të dëmshme, duke përfshirë emrat teknikë korrektë të substancave të tilla (emrat tregtarë nuk duhet të jenë të përdorur në vend të emrave korrektë teknikë);
- (b) Një deklaram ose vlerësim të sasive, koncentrimeve dhe kushtet e mundshme të substancave të dëmshme të shkarkuara ose që mund të shkarkohen në det;
- (c) Kur ka lidhje, një përshkrim të ngarkesës dhe standartet identifikuese;
- (d) Emrin e dërguesit, pritësit ose prodhuesit.

3. Çdo raport duhet të tregojë qartë, kur është e mundur, nëse substanca e dëmshme e shkarkuar ose që mund të shkarkohet në det është hidrokarbur ose një lëndë helmuese, substancë e ngurtë apo e gaztë, dhe nëse një substancë e tillë ishte ose është transportuar rifuxhio ose në një formë të paketuar, në konteinerë, çisterna portabël, ose çisterna dhe vagona çisternë.

4. Çdo raport do të jetë i plotësuar nga një informacion përkatës, të kërkuar nga personi që merr raportin ose nëse konsiderohet e përshtatshme nga personi që e dërgon atë.

5. Ndonjë nga personat referuar në nenin 8, paragrafi 1 i këtij protokoll do të:

- (a) Plotësojë sa të jetë e mundur, raportin fillestar, si të nevojshëm, me informacionin që ka të bëjë me zhvillimet e mëtejshme;
- (b) Përmbahet sa më shumë të jetë e mundur, kërkesave për informacion shtesë nga shtetet e dëmtuara nga ndotja.

# **PROKOLL KU PËRFSHIHEN ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA DHE LLOJSHMËRIA BIOLOGJIKE**

Palët kontraktuese në këtë protokoll

Duke qenë Palë të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja, miratuar në Barcelonë në 16 shkurt 1976,

Të ndërgjegjshëm për ndikimet e mëdha të shkaktuara nga aktiviteti i njeriut në mjedisin detar aktual dhe për më në përgjithësi në ekosistemet mesdhetare që kanë tipare kryesore mesdhetare,

Duke i dhënë rëndësi mbrojtjes dhe si rrjedhim përmirësimit të gjendjes së trashëgimive natyrore e kulturore mesdhetare, veçanërisht nëpërmjet krijimit të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura dhe ruajtjes e mbrojtjes së specieve të rrezikuara,

Duke marrë në konsideratë instrumentet e miratuara nga UNCED dhe veçanërisht nga Konventa për Biodiversitetin (Rio de Zhaneiro 1992),

Të ndërgjegjshëm se kur ekziston rreziku për pakësime të rëndësishme apo humbje të biodiversitetit, mungesa e qartësisë shkencore nuk duhet të justifikojë zvarritjen e masave ndaluese apo minimizuese të rrezikut,

Duke marrë në konsideratë se të gjitha Palët kontraktuese duhet të bashkëpunojnë për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, shëndetin dhe se ato kanë në këtë drejtim përgjegjësi të përbashkëta, por të diferencuara,

Ranë dakord si më poshtë:

## **PJESA I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Përkufizime**

Për qëllimet e këtij protokoll:

(a) “Konventa” nënkupton Konventën për Mbrojtjen e Detit Mesdhe ndaj Ndotjes, miratuar në Barcelonë në 16 shkurt 1976 dhe amenduar në Barcelonë në 1995;

(b) “Biodiversitet” nënkupton Llojshmërinë midis organizmave të gjalla nga të gjitha burimet, përfshi ndërmjet të tjerash, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore si dhe komplekset ekologjike ku bëjnë pjesë; kjo përfshin llojshmërinë brenda specieve, ndërmjet specieve dhe të ekosistemeve.

(c) “Specie të Rrezikuara” nënkupton çdo specie që është në rrezik për t'u zhdukur në të gjithë kufirin apo në pjesë të kufijve që kushtëzojnë ekzistencën e saj.

(d) “Specie endemike” nënkupton çdo specie kufijte e ekzistencës së të cilave kufizohen në një zonë të kufizuar gjeografike.

(e) “Specie të kërcënuara” nënkupton çdo specie që sipas parashikimeve ka të ngjarë të zhduket në një të ardhme të parashikueshme dhe mbijetesa e të cilave është e pamundur në qoftë se faktorët që çojnë në pakësimin numerik ose degradim të habitatit, vazhdojnë të ekzistojnë.

(f) “Statusi i konservimit të specieve” nënkupton shumën e influencave vepruese tek speciet që mund të ndikojnë në numrin dhe shpërndarjen e qëndrueshme afatgjatë të tyre.

(g) “Palë” nënkupton Palët kontraktuese në këtë protokoll.

(h) “Organizatë” nënkupton organizatën që referohet në nenin 2 të konventës.

(i) “Qendër” nënkupton Qendrën e Aktivitetit Rajonal për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura.

## Neni 2

### Mbulimi gjeografik

1. Zona në të cilën aplikohet ky protokoll do të jetë zona e Detit Mesdhe siç është përcaktuar në nenin 1 të konventës. Aty përfshihet gjithashtu:

- shtrati i detit dhe nëntoka e tij
- ujrat, shtrati i detit dhe nëntoka e tij në pjesën me drejtim nga toka që shërben si linjë kryesore nga e cila matet rritja e territorit detar dhe shtrirja e tij, në rastet e rrjedhave ujore sipërfaqësore tokësore, deri në kufirin e ujrave të ëmbla:
- zonat e territoreve bregdetare, përcaktuar dhe parashikuar nga çdo Palë, përfshi tokat e lagëta.

2. Asnjë në këtë protokoll, ose asnjë akt i miratuar në bazë të këtij protokoll, nuk do të paragjykojë të drejtat, qëllimet dhe synimet legale të çdo shteti për sa i përket ligjit për detin, veçanërisht për natyrën dhe shtrirjen e zonave detare, për ndarjen e zonave detare midis shteteve mes brigjeve përkatëse pranë apo përballë tyre, për lirinë e lundrimit në det të hapur, të drejtën dhe modalitetet e kalimit nëpërmjet kanaleve të përdorura për lundrim ndërkombëtar dhe të drejtën e kalimit të pafajshëm në detet territoriale si dhe natyrën e shkallën e juridiksionit të shtetit bregdetar, shtetit të flamurit dhe shtetit të portit.

3. Asnjë akt ose aktivitet i ndërmarrë në bazë të këtij protokoll nuk do të përmbajë apo përbëjë baza për padi, kundërshti apo grindje për ndonjë pretendim për sovranitetin apo juridiksionin kombëtar.

## Neni 3

### Detyrimet kryesore

1. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme :

- (a) për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe ekologjike zonat me vlera të veçanta natyrore dhe kulturore, sidomos nëpërmjet krijimit (shpalljes) së Zonave Veçanërisht të Mbrojtura.
- (b) për të mbrojtur, ruajtur dhe menaxhuar speciet e kërcënuara ose të rrezikuara të florës dhe faunës.

2. Palët do të bashkëpunojnë, direkt apo nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare. në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike në zonat ku ky protokoll do të aplikohet.

3. Palët do të identifikojnë dhe hartojnë inventarët e komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike që konsiderohen si të rëndësishëm për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

4. Palët do të miratojnë strategjitë, planet e programet për konservimin e shumëllojshmërisë biologjike dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve biologjike bregdetare e detare dhe do t'i integrojnë ato në sektorët e tyre përkatës apo në politikat ndërsektoriale.

5. Palët do të monitorojnë komponentet e shumëllojshmërisë biologjik të referuara në paragrafin 3 të këtij neni dhe do të identifikojnë proceset dhe kategoritë e aktiviteteve të cilat kanë apo kanë të ngjarë të kenë ndikime negative të rëndësishme në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike, dhe të monitorojnë efektet e tyre.

6. Çdo Palë do të zbatojë masat e përcaktuara në këtë protokoll pa paragjykuar sovranitetin apo juridiksionin e Palëve apo shteteve të tjera. Çdo masë e marrë nga njëra Palë për përforcimin e këtyre masave do të bëhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

**PJESA II**  
**MBROJTJA E ZONAVE**  
**SEKSIONI 1 - ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA**

**Neni 4**

**Objektivat**

Objektivi i zonave veçanërisht të mbrojtura është të sigurojë mbrojtjen:

(a) e tipeve përfaqësuese të ekosistemeve detare dhe bregdetare me përmasa të përshtatshme dhe të pranueshme për të siguruar mbijetesën afatgjatë të tyre dhe të ruajë shumëllojshmërinë biologjik të tyre;

(b) e habitateve që janë në rrezik për t'u zhdukur në zonat e shpërndarjes natyrore të tyre në Mesdhe apo që kanë një zonë natyrore shpërndarjeje të reduktuar si pasojë e regresit të tyre ose për arsye të zonave të kufizuara të tyre;

(c) e habitateve kritike për të garantuar mbijetesën, riprodhimin dhe përtë-ritjen e specieve endemike, të rrezikuara dhe të kërcënuara të florës e faunës.

(d) e zonave me rëndësi të veçantë për interesa shkencore, estetike, kulturore, dhe edukative.

**Neni 5**

**Shpallja e zonave veçanërisht të mbrojtura**

1. Çdo Palë mund të krijojë zona veçanërisht të mbrojtura në zonat detare dhe bregdetare që janë nën juridiksionin apo sovranitetin e saj.

2. Nëse një Palë, ka për qëllim shpalljen e një zone veçanërisht të mbrojtur në një territor nën juridiksionin dhe sovranitetin e tij, por që kufizohet apo është vazhdim i një zone në sovranitetin dhe juridiksionin e një Palë tjetër, autoritetet kompetente të të dy Palëve duhet të angazhohen në bashkëpunim, me qëllim arritjen e marrëveshjeve për masat që do të ndërmerren dhe veç të tjerash do të vlerësojnë mundësinë e pales tjetër për shpalljen e zonës veçanërisht të mbrojtur korresponduese apo të marrin, masa të tjera të përshtatshme.

3. Nëse një Palë ka për qëllim shpalljen e një zone veçanërisht të mbrojtur në një territor nën juridiksionin dhe sovranitetin e saj dhe që kufizohet apo është vazhdim i një zone nën juridiksionin apo sovranitetin e një Palë tjetër që nuk është Palë në këtë protokoll, pala e parë duhet të përpiqet të bashkëpunojë me shtetin jo anëtar të protokollit sipas paragrafit të mësipërm.

4. Nëse një shtet që nuk është Palë e këtij protokollit ka për qëllim të shpallë një zonë veçanërisht të mbrojtur në kufi të një zone që është nën sovranitetin apo juridiksionin e një shteti që është Palë e këtij protokollit, ky i fundit duhet të përpiqet të bashkëpunojë me të parin sipas paragrafit 2.

**Neni 6**

**Masat mbrojtëse**

Palët, duke respektuar ligjin ndërkombëtar dhe duke marrë parasysh karakteristikat e secilës prej zonave veçanërisht të mbrojtura, duhet të marrin masat e nevojshme mbrojtëse dhe në vecanti:

(a) forcimin e zbatimit të protokolleve të tjera të konventës dhe të traktateve të tjera përkatëse në të cilat ato janë Palë;

(b) ndalimin e shkarkimit apo hedhjes së mbetjeve apo substancave të tjera që mund të dëmtojnë direkt ose tërthorazi integritetin e zonës veçanërisht të mbrojtur;

(c) rregulloren e kalimit, ndalimit apo të ankorimit të anijeve;

(d) rregulloren për futjen e çdo specjeje jo indigjene në zonën veçanërisht të mbrojtur, apo futjen e specieve gjenetikisht të modifikuara, si dhe futjen apo rifutjen e specieve që ekzistojnë aktualisht ose kanë ekzistuar më parë në zonën veçanërisht të mbrojtur;

(e) rregulloren ose ndalimin e çdo aktiviteti ku përfshihet shfrytëzimi dhe modifikimi i tokës apo shfrytëzimi i nëntokës në pjesë të territorit të zonës, shtratit të detit apo nëntokës së tij;

- (f) rregullore për çdo aktivitet shkencor
- (g) rregullore apo ndalime të peshkimit, gjuetisë, marrjen e kafshëve dhe korrjen e bimëve apo shkatërrimin e tyre, si dhe tregëtinë e kafshëve, pjesëve të kafshëve, bimëve, pjesëve të bimëve, që gjallojnë apo kanë origjinën në zonën veçanërisht të mbrojtur.
- (h) rregullore dhe po qe e nevojshme edhe ndalime për çdo aktivitet apo akt tjetër që mund të dëmtojë apo shqetësojë speciet ose që mund të kërcënojnë gjendjen e konservimit të ekosistemit apo specieve apo që mund të dëmtojë karakteristikat natyrore apo kulturore të zonës veçanërisht të mbrojtur;
- (i) çdo masë tjetër që ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së proceseve ekologjike e biologjike dhe pejsazhit.

## **Neni 7**

### **Planifikimi dhe menaxhimi**

1. Palët, në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar, miratojnë planifikimin, menaxhimin, masat e mbikqyrjes dhe të monitorimit për zonat veçanërisht të mbrojtura.
2. Këto masa duhet të përfshijnë për çdo zonë veçanërisht të mbrojtur:
  - (a) zhvillimin dhe miratimin e planit të menaxhimit që specifikon kuadrin ligjor dhe institucional dhe masat menaxhuese dhe mbrojtëse të aplikueshme;
  - (b) monitorimin e vazhdueshëm të proceseve ekologjike, habitateve, dinamikave të popullatave, pejsazheve, si dhe ndikimet e aktiviteteve të njeriut;
  - (c) pjesëmarrjen aktive të popullsisë e komuniteteve lokale, sipas rastit, në menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, përfshi asistencën për banorët lokalë që mund të preken nga shpallja e këtyre zonave;
  - (d) miratimi i mekanizmave për të financuar nxitjen dhe menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura si dhe për zhvillimin e aktiviteteve që sigurojnë menaxhimi përkon me objektivat e këtyre zonave;
  - (e) rregulloret e aktiviteteve në përputhje me objektivat për të cilat është shpallur zona e mbrojtur dhe kushtet e lejeve përkatëse.
  - (f) trainimin e menaxherëve dhe personelit të kualifikuar teknik, si dhe zhvillimin e një infrastrukture të përshtatshme.
3. Palët duhet të sigurojnë që planet kontigjente kombëtare të përfshijnë masa për t'u përgjigjur incidenteve që mund të shkaktojnë dëmtime apo përbëjnë kërcënime në zonat veçanërisht të mbrojtura.
4. Kur shpallen zona veçanërisht të mbrojtura, zona që përfshijnë njëkohësisht territore detare e tokësore, Palët duhet të përpiqen të sigurojnë kordinimin e administrimit dhe menaxhimit si një e pandarë.

## **SEKSIONI 2: ZONAT VEÇANËRISHT TË MBROJTURA ME RËNDËSI PËR MESDHEUN.**

### **Neni 8**

#### **Hartimi i listës së zonave veçanërisht të mbrojtura me rëndësi për Mesdheun**

1. Me qëllim që të nxisë bashkëpunimin në menaxhimin dhe konservimin e zonave natyrore, si dhe në mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe habitateve të tyre, Palët duhet të hartojnë një "Listë të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura me Rëndësi për Mesdheun", e cila që këtej e tutje do të referohet nga ne si në origjinal "Lista SPAMI".
2. Lista SPAMI mund të përfshijë zonat që:
  - janë të rëndësishme për konservimin e komponentëve të shumëllojshmërisë biologjike në Mesdhe;
  - përmbajnë ekosisteme specifike në zonën e Mesdheut apo habitate të specieve të rrezikuara;
  - paraqesin rëndësi të veçantë në nivelet shkencore, estetike, kulturore apo edukative.
3. Palët bien dakord:
  - (a) të njohin rëndësinë e veçantë të këtyre zonave për Mesdheun;

(b) të përmbushin masat e aplikueshme për SPAMI-in dhe të mos autorizojnë apo të ndërmarrin ndonjë aktivitet që mund të jetë në kundërshtim me objektivat për të cilat është shpallur SPAMI.

## **Neni 9**

### **Procedura për hartimin dhe listimin e spami-it**

1. SPAMI mund të krijohet, duke ndjekur procedurën e parashikuar në paragrafin 2 deri 4 të këtij neni, në: (a) zonat detare dhe bregdetare në sovranitetin ose juridiksionin e Palëve; (b) zonat që ndodhen pjesërisht apo plotësisht në detet me rëndësi të lartë ndërkombëtare.

2. Propozimet për përfshirjen në listë mund të paraqiten:

(a) nga pala e interesuar, nëse zona është e vendosur në një hapësirë të përcaktuar, mbi të cilën ajo ushtron sovranitetin dhe juridiksionin e saj-

(b) nga dy apo më shumë Palë kufitare në rast se përfshihen në zona pjesërisht apo plotësisht në detet me rëndësi të lartë ndërkombëtare;

(c) nga Palët kufitare që përfshihen në zonat ku kufijtë e sovranitetit dhe juridiksionit kombëtar nuk janë përcaktuar ende.

3. Palët që bëjnë propozime për përfshirjen në listën SPAMI, duhet të paraqesin në Qendër një raport paraprak që do të përmbajë informacione për vendndodhjen gjeografike të zonës, karakteristikat ekologjike dhe fizike, statusin e saj legal, planet e menaxhimit dhe mënyrat e zbatimit të tyre, si edhe në vlerësim të gjendjes për të justifikuar rëndësinë në Mesdhe:

(a) Kur propozimi formulohet sipas paragrafit 2(b) dhe 2(c) të këtij neni, Palët e interesuara duhet të konsultohen me njëra-tjetrën me synim sigurimin e vazhdueshmërisë së masave menaxhuese dhe mbrojtëse të propozuara, si dhe për mënyrat e zbatimit të tyre;

(b) Propozimet e bëra në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të tregojnë masat e aplikueshme për mbrojtje dhe menaxhim të zonës si dhe për mënyrat e zbatimit të tyre.

4 Procedura për përfshirjen e zonës së propozuar në listë është si më poshtë:

(a) për çdo zonë, propozimi duhet t'u parashtrahet Pikave Fokale Kombëtare, të cilat duhet të ekzaminojnë konformitetin e saj me udhëzuesin dhe kriteret e përshtatura sipas nenit 16;

(b) nëse një propozim i bërë në përputhje me nënparagrafët 2(a) të këtij neni përmbush udhëzimet dhe kriteret e përbashkëta, pas vlerësimit, organizata do të informojë "Mbledhjen e Palëve" e cila do të vendosë të përfshijë zonën, në listën SPAMI

(c) nëse një propozim i bërë në përputhje me nënparagrafët 2(b) dhe 2(c) të këtij neni përmbush udhëzimet dhe kriteret e përbashkëta, Qendra duhet t'ia kalojë atë organizatës, e cila do të informojë "Mbledhjen e Palëve". Vendimi për përfshirjen e zonës në Listën SPAMI duhet të ndërmerret me mirëkuptimin e Palëve kontraktuese, që gjithashtu do të aprovojnë masat e aplikueshme të menaxhimit në zonë.

5. Palët të cilat propozuan përfshirjen e zonës në listë, duhet të zbatojnë masat mbrojtëse dhe konservuese të specifikuara në propozimet e tyre në përshtatje me paragrafin 3 të këtij neni. Palët kontraktuese duhet të marrin përsipër të respektojnë rregullat e caktuara. Qendra duhet të informojë organizatat ndërkombëtare kompetente për listën dhe masat e marra në SPAMI.

6. Palët mund ta rishikojnë listën SPAMI. Për këtë Qendra duhet të përgatisë një raport.

## **Neni 10**

### **Ndryshimet në statusin e SPAMI-t**

Nuk duhet të bëhen ndryshime në përcaktimet e kufijve apo statusin legal të një zone tashmë të përfshirë në SPAMI, apo në heqjen e një pjesë ose të gjithë kësaj zone, veçse në rastet kur këto ndryshime justifikohen nga arsye të rëndësishme, duke marrë parasysh ruajtjen e mjedisit dhe për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë protokoll, duhet të ndiqet një procedurë e ngjashme për krijimin e SPAMI-t dhe përfshirjen e tij në listë.

## **PJESA III**

### **MBROJTJA DHE RUAJTJA E SPECIEVE**

#### **Neni 11**

##### **Masat kombëtare për mbrojtjen dhe ruajtjen e specieve**

1. Palët duhet të menaxhojnë speciet e florës dhe faunës me qëllim mirëmbajtjen e tyre në një gjendje të favorshme konservimi.

2. Palët, në zonat që janë nën sovranitetin ose juridiksionin ndërkombëtar të tyre, do të identifikojnë dhe hartojnë listat e specieve të kërcënuara dhe të rrezikuara të florës e faunës dhe do të japin statusin e mbrojtjes për këto specie. Palët duhet të rregullojnë, dhe kur është e nevojshme të ndalojnë aktivitetet që kanë efekte negative në speciet e lartpërmendura apo habitatet e tyre dhe të realizojnë menaxhimin, planifikimin dhe masa të tjera për sigurimin e një gjendjeje të favorshme konservimi të këtyre specieve.

3. Në lidhje me speciet e mbrojtura të faunës, Palët duhet të kontrollojnë dhe kur është e përshtatshme të ndalojnë:

(a) marrjen, zotërimin apo vrasjen (përfshi këtu sa më shumë të jetë e mundur edhe rastet kur marrja, zotërimi apo vrasja janë rastësore), tregëtimin komercial, transportin dhe ekspozimin për qëllime komerciale të këtyre specieve, vezëve të tyre, pjesëve apo produkteve të tyre;

(b) sa më shumë të jetë e mundur, shqetësimin e faunës së egër, veçanërisht gjatë periudhave të shtimit, inkubacionit, dimërimit apo migrimit, si dhe në periudha të tjera të streseve biologjike.

4. Palët, përveç masave të specifikuara në paragrafët e mësipërme, duhet të kordinojnë përpjekjet e tyre, nëpërmjet aksioneve dy apo shumëpaleshe, duke përfshirë nëse nevojitet, marrëveshjet për mbrojtjen dhe përtëritjen e specieve shtegtare, kufijtë e gjallimit të të cilave shtrihen në zonat ku aplikohet ky protokoll.

5. Në lidhje me speciet e mbrojtura të florës dhe pjesës së produkteve të tyre, Palët duhet të rregullojnë, kur është e nevojshme, të ndalojnë të gjitha format e shkatërrimit apo shqetësimit, përfshi këputjen, mbledhjen, prerjen, shkuljen me githë rrënjë, zotërimin e tyre, tregëtimin komercial, apo transportin dhe ekspozitat për qëllime komerciale të këtyre specieve.

6. Palët duhet të formulojnë dhe miratojnë masa dhe plane me qëllim riprodhimin “ex-situ”, veçanërisht riprodhimin e mbyllur (artificial ose me menaxhim intensiv), të faunës së mbrojtur dhe përhapjen e florës së mbrojtur.

7. Palët duhet të përpiqen, direkt apo nëpërmjet Qendrës, të konsultohen me shtetet kufitare që nuk janë Palë të këtij protokollit, me qëllim kordinimin e përpjekjeve për menaxhimin dhe mbrojtjen e specieve të kërcënuara apo rrezikuara.

8. Palët duhet të bëjnë parashikime, kur ka mundësi, për rikthimin e specieve të mbrojtura të eksportuara apo të marra ilegalisht. Palët duhet të përpiqen për rifutjen e këtyre specieve në habitatet e tyre natyrore.

#### **Neni 12**

##### **Masat e bashkëpunimit për mbrojtjen dhe konservimin e specieve**

1. Palët duhet të marrin masat e bashkëpunimit për sigurimin dhe konservimin e florës dhe faunës të listuara në anekset e këtij protokollit që lidhen me Listën e Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara dhe listës së specieve, shfrytëzimi i të cilave është i rregulluar me ligj.

2. Palët duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe ripërtëritjen optimale të specieve të faunës dhe florës të listuara në aneksin që i referohet Listës së Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara, duke përshtatur në nivel kombëtar masat e nxjerra për këtë qëllim në paragrafët 3 dhe 5 të nenit 11 të këtij Protokollit.

3. Palët duhet të ndalojnë shkatërrimin apo dëmtimin e habitateve të specieve të listuara në Aneksin e Listës së Specieve të Rrezikuara dhe Kërcënuara dhe duhet të formulojnë e zbatojnë planet e veprimit për mbrojtjen dhe ripërtëritjen e tyre. Ato duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë në zbatimin e planeve përkatëse të veprimit tashmë të miratuara.

4. Palët, në bashkëpunim me organet ndërkombëtare kompetente, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e konservimit të specieve të listuara në aneksin e listës së specieve, shfrytëzimi i të cilave është i rregulluar me ligj dhe në të njëjtën kohë të autorizojnë dhe rregullojnë me ligj shfrytëzimin e këtyre specieve, duke siguruar dhe mirëmbajtur në këtë mënyrë një gjendje të favorshme të konservimit të tyre.

5. Kur kufijtë e zonës së një specieje të rrezikuar apo kërcënuar shtrihen në të dy anët e një kufiri kombëtar apo në limitet që ndajnë territoret apo zonat nën sovranitetin e juridiksionin e të dy Palëve të këtij protokollit, këto Palë duhet të bashkëpunojnë me qëllim sigurimin e mbrojtjes e konservimit dhe nëse është e nevojshme, ripërtëritjes së këtyre specieve.

6. Kur parashikohet se nuk ka zgjidhje të tjera të favorshme dhe se përjashtimet nuk dëmtojnë mbijetesën e popullatave të specieve të tjera, Palët mund të pranojnë edhe përjashtime për sa i përket aktiviteteve të ndaluara të përshkruara, për speciet e listuara në aneksin e protokollit, për qëllime shkencore, edukuese apo menaxhuese, të dobishme për sigurimin e mbijetesës së specieve apo parandalimin e dëmtimeve të rëndësishme. Këto përjashtime duhen t'u njoftohen Palëve kontraktuese.

### **Neni 13**

#### **Futja e specieve jointdigjene ose gjenetikiisht të modifikuara**

1. Palët duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e futjeve të qëllimta apo aksidentale të specieve jointdigjene ose atyre të modifikuara gjenetikiisht në habitatet natyrore dhe të ndalojnë futjen e atyre specieve që mund të kenë ndikime të rënda në ekosistemin, habitatet apo speciet në zonat ku aplikohet ky protokoll.

2. Palët duhet të përpiqen të zbatojnë të gjitha masat e mundshme për të larguar speciet që janë futur ndërkohë, kur nga vlerësimi shkencor rezulton se këto specie shkaktojnë apo mund të shkaktojnë dëmtime në ekosistem, habitat apo specie në zonat ku zbatohet ky protokoll.

## **PJESA VI**

### **DISPOZITAT E PËRBASHKËTA PËR ZONAT E MBROJTURA DHE SPECIET**

#### **Neni 14**

##### **Amendamentet e anekseve**

1. Procedurat për amendamentet për anekset e këtij protokollit parashtrihen në nenin 23 të kësaj konvente.

2. Të gjitha amendamentet e propozuara të paraqitura për shqyrtim në Mbledhien e Palëve Kontraktuese do t'i nënshtrohen një vlerësimi paraprak në mbledhjen e Pikave Fokale Kombëtare.

#### **Neni 15**

##### **Inventarët**

Çdo Palë kontraktuese duhet të hartojë inventare të plota të:

(a) zonave në të cilat ato ushtrojnë sovranitetin e juridiksionin dhe përmbajnë ekosisteme të rralla apo të ndjeshme, që janë rezervuare të shumëllojshmërisë biologjike, që janë të rëndësishme për speciet e rrezikuara apo kërcënuara;



(b) specieve të florës dhe faunës që janë të rrezikuara ose të kërcënuara.

#### **Neni 16**

##### **Udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta**

Palët duhet të miratojnë:

- (a) kriteret e përbashkëta për zgjedhjen e zonave të mbrojtura detare e bregdetare që duhen përfshirë në Listen SPAMI dhe që do të vihen si aneks në protokoll;
- (b) kriteret: të përbashkëta për përfshirjen e specieve të tjera në anekset
- (c) udhëzues për shpalljen dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura.

Udhëzuesi dhe kriteret e referuara më sipër në paragrafët (b) dhe (c) mund të amendohen nga mbledhja e Palëve në bazë të propozimeve të bëra nga një ose më shumë Palë.

#### **Neni 17**

##### **Vlerësimi i ndikimit në mjedis**

Në procesin e planifikimit për të marrë vendime për projekte industriale dhe aktivitete që mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në zonat e mbrojtura, speciet dhe habitatet e tyre, Palët do të vlerësojnë dhe marrin në konsideratë ndikimin direkt ose indirekt, të çastit ose afatgjatë, përfshi impaktin e grumbulluar të projekteve dhe aktiviteteve që u përmenden.

#### **Neni 18**

##### **Integrimi i aktiviteteve tradicionale**

1. Në formulimin e masave mbrojtëse, Palët do të marrin parasysh jetesën tradicionale dhe aktivitetet kulturore të popullatave të tyre lokale. Ato do të bëjnë përjashtime nëse është e nevojshme për të përballuar nevoja të tilla. Asnjë përjashtim i lejuar për këto arsye:

(a) Nuk do të rrezikojë si ruajtjen e ekosistemeve të mbrojtura në bazë të këtij protokollit ashtu dhe proceset biologjike që kontribuojnë në ruajtjen e atyre ekosistemeve;

(b) nuk do të shkaktojë zhdukjen, ose pakësimin e ndjeshëm të numrit të individëve që përbëjnë popullatën ose speciet e florës e faunës, në veçanti speciet shtegtare ose endemike, të rrezikuara ose të kërcënuara.

2. Palët që ofrojnë përjashtime nga masat mbrojtëse do të informojnë Palët kontraktuese.

#### **Neni 19**

##### **Publiciteti, informimi, ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi**

1. Palët do t'i japin publicitetin e duhur ngritjes së zonave veçanërisht të mbrojtura, kufijve të tyre, rregullave të aplikueshme dhe përcaktimit të specieve të mbrojtura, habitateve të tyre dhe rregullave të aplikueshme.

2. Palët do të përpiqen të informojnë publikun për interesin dhe vlerat e zonave veçanërisht të mbrojtura e speciet dhe për dijet shkencore që mund të fitohen nga pikëpamja e ruajtjes së natyrës dhe këndvështrime të tjera. Ky informacion duhet të ketë një vend të vetin në programet edukative. Palët duhet gjithashtu të përpiqen të nxisin pjesëmarrjen e publikut të tyre dhe të organizatave të ruajtjes në masat që janë të nevojshme për mbrojtjen e zonave dhe specieve respektive, duke përfshirë dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.

#### **Neni 20**

##### **Kërkimet shkencore, teknike dhe menaxhuese**

1. Palët do të inkurajojnë dhe zhvillojnë kërkime shkencore dhe teknike në lidhje me qëllimet e këtij protokollit. Ato gjithashtu do të inkurajojnë dhe zhvillojnë kërkime shkencore për përdorimin e qëndrueshëm të zonave veçanërisht të mbrojtura dhe menaxhimin e specieve të mbrojtura.

2. Palët do të konsultohen, kur është e nevojshme, me njëra-tjetrën dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente për të identifikuar, planifikuar dhe ndërmarrë kërkime shkencore e teknike dhe programe monitoruese të nevojshme për identifikimin dhe monitorimin e zonave dhe specieve të mbrojtura dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të marra për të zbatuar planet e menaxhimit dhe përmirësimit.

3. Palët do të këmbëjnë, direkt ose nëpërmjet Qendrës, informacion teknik dhe shkencor lidhur me programet kërkimore dhe menaxhuese aktuale të planifikuara si dhe rregullat e tyre. Brenda mundësive maksimale, ato do të koordinojnë programet e tyre kërkimore dhe menaxhuese dhe do të përpiqen së bashku të përcaktojnë ose standartizojnë procedurat e tyre.

4. Në kërkimet teknike dhe shkencore, Palët do të japin prioritet për SPAMI-n dhe speciet e përfshira në anekset e këtij protokollit.

## **Neni 21**

### **Kooperimi reciprok**

1. Palët, direkt ose me asistencën e Qendrës ose organizatave ndërkombëtare të interesuara, do të ndërtojnë programe bashkëpunimi për të koordinuar vendosjen, konservimin, planifikimin dhe menaxhimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, si dhe seleksionimin, menaxhimin dhe konservimin e specieve të mbrojtura. Do të këtë shkëmbime të rregullta të informacionit lidhur me karakteristikat e zonave dhe specieve të mbrojtura, eksperiencën e fituar dhe problemet e ndeshura.

2. Palët, në rastin më të parë, do t'u komunikojnë Palëve të tjera, shteteve që mund të jenë të prekura dhe Qendrës, çdo situatë që rrezikon ekosistemet e zonave veçanërisht të mbrojtura ose mbijetesën e specieve të mbrojtura të florës dhe faunës.

## **Neni 22**

### **Asistenca reciproke**

1. Palët do të kooperojnë, direkt ose me asistencën e Qendrës ose të organizatave ndërkombëtare të interesuara, në formulimin, financimin dhe implementimin e programeve të asistencës reciproke dhe asistencës për vendet në zhvillim që shprehin nevojën për këtë asistencë me synim zbatimin e këtij protokollit.

2. Këto programe do të përfshijnë edukimin mjedisor të publikut, trainimin e personelit shkencor teknik dhe menaxhues, kërkimin shkencor, blerjen, përdorimin, hartimin, zhvillimin e pajisjeve të duhura dhe transferimin e teknologjisë mbi kushtet e avantazhit që do të bien dakord Palët e interesuara.

3. Palët, në çështje të asistencës reciproke, do të japin prioritet për SPAMI-n dhe speciet e përcaktuara në anekset e këtij protokollit.

## **Neni 23**

### **Raportet e palëve**

Palët do të paraqesin në mbledhjet e zakonshme të Palëve, raportin për zbatimin e këtij protokollit, veçanërisht për:

- (a) statusin dhe gjendjen e zonave të përfshira në listën e SPAMI-t;
- (b) çdo ndryshim në përcaktimin e kufijve ose statusin ligjor të SPAMI-t dhe specieve të mbrojtura;
- (c) përjashtimet e mundshme të lejuara nga nenet 12 dhe 18 të këtij protokollit.

## **PJESA V**

### **Dispozitat institucionale**

#### **Neni 24**

##### **Pikat fokale kombëtare**

Secila Palë do të caktojë një Pikë Fokale Kombëtare që do të shërbejë si lidhje me Qendrën për aspektet teknike dhe shkencore të zbatimit të këtij protokoll. Pikat Fokale Kombëtare do të takohen periodikisht për të kryer funksionet që rrjedhin nga ky protokoll.

#### **Neni 25**

##### **Koordinimi**

##### **Neni 25**

##### **Koordinimi**

1. Organizata është përgjegjëse për kordinimin e zbatimin e këtij protokoll. Për këtë qëllim, do të ketë mbështetje nga Qendra, të cilës mund t'i besojë funksionet e mëposhtme:

(a) ndihmë ndaj Palëve, në bashkëpunim me organizatat kompetente ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, në:

- caktimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura veçanërisht në zonën që aplikohet ky protokoll;
- drejtimin e programeve të kërkimit teknik dhe shkencor siç përcaktohet në nenin 20 të këtij protokoll;
- drejtimin e shkëmbimit të informacionit teknik dhe shkencor midis Palëve siç përcaktohet në nenin 20 të këtij protokoll;

- përgatitjen e planeve të menaxhimit për zonat dhe speciet veçanërisht të mbrojtura;

- zhvillimin e programeve të bashkëpunimit në vijim të nenit 21 të këtij protokoll;

- përgatitjen e materialeve edukative për grupe të ndryshme.

(b) mbledhjen dhe organizimin e takimeve të Pikave Fokale Kombëtare dhe sigurimin e shërbimeve të sekretarisë.

(c) formulimin e rekomandimeve për udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta në vijim të nenit 16 të këtij protokoll;

(d) krijimin dhe aktualizimin e një baze të dhënash për zonat veçanërisht të mbrojtura, speciet e mbrojtura dhe të tjera që i përkasin këtij protokoll;

(e) përgatitjen e raporteve dhe studimeve teknike që mund të kërkohen për zbatimin e këtij protokoll;

(f) përpunimin dhe zbatimin e programeve të trainimit të përmendura në nenin 22, paragrafi 2.

(g) kooperimin me organizatat qeveritare dhe joqeveritare rajonale dhe ndërkombëtare që kanë lidhje me zonat dhe speciet e mbrojtura, me kusht që të respektohen specifikat e çdo organizate dhe nevoja për të shmangur dublimin e aktiviteteve;

(h) zbatimi i funksioneve të caktuara në planet e veprimit të miratuara në kuadër të këtij protokoll;

(i) kryerja e çdo funksioni tjetër të caktuar nga Palët.

#### **Neni 26**

##### **Takimet e palëve**

1. Takimet e zakonshme të Palëve të këtij protokoll do të mbahen në varësi të takimeve të zakonshme të Palëve kontraktuese të konventës mbajtur sipas nenit 18 të Konventës. Palët mundet gjithashtu të mbajnë takime të jashtëzakonshme në përputhje me këtë nen.

2. Takimet e Palëve të këtij protokoll kanë qëllim të veçantë:

(a) të shqyrtojnë zbatimin e këtij protokoll;

(b) të mbikqyrin punën e organizatës dhe të Qendrës në lidhje me zbatimin e këtij protokoll dhe të sigurojnë orientim politik të aktiviteteve të tyre;

(c) të konsiderojnë efikasitetin e masave të marra për menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave dhe specieve, të shohin nevojat për masa të tjera, veçanërisht në formën e anekseve dhe amendamenteve të këtij protokoll dhe anekseve të tij;

- (d) të miratojnë udhëzuesit dhe kriteret e përbashkëta të parashikuara në nenin 16 të këtij protokoll;
- (e) të shqyrtojnë raportet e transmetuara nga Palët sipas nenit 23 të këtij protokoll, si dhe çdo informacion tjetër përkatës, të cilin Palët e transmetojnë nëpërmjet Qendrës;
- (f) t'u bëjnë rekomandime Palëve mbi masat që do të merren për zbatimin e këtij protokoll;
- (g) të ekzaminojnë rekomandimet e takimeve të Pikave Fokale Kombëtare sipas nenit 24 të këtij protokoll;
- (h) të vendosin për përfshirjen e një hapësire në listën SPAMI, në përputhje me nenin 9, paragrafi 4 i këtij protokoll;
- (i) të ekzaminojnë ndonjë çështje tjetër që ka të bëjë me këtë protokoll;
- (j) të diskutojnë dhe vlerësojnë përjashtimet e lejuara nga Palët në përshtatje me nenin 12 dhe 18 të këtij protokoll.

## **PJESA VI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 27**

##### **Efektet e protokollit në legjislacionin kombëtar**

Klauzolat e këtij Protokoll nuk do të prekin të drejtën e Palëve për të marrë masa të brendshme më të repta për zbatimin e këtij protokoll.

#### **Neni 28**

##### **Marrëdhëniet me palët e treta**

1. Palët duhet të ftojnë shtetet që nuk janë Palë të këtij protokoll dhe organizatat ndërkombëtare të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij protokoll.
2. Palët duhet të marrin përsipër miratimin e masave të përshtatshme në përputhje me ligjin ndërkombëtar, për t'u siguruar se askush nuk do të angazhohet në aktivitete që janë në kundërshtim me parimet apo qëllimet e këtij protokoll.

#### **Neni 29**

##### **Nënshkrimi**

Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Barcelonë me 10 qershor 1995 dhe në Madrid nga 11 qershori 1995 deri më 10 qershor 1996 nga Palët kontraktuese në konventë.

#### **Neni 30**

##### **Ratifikimi, pranimi ose miratimi**

Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentat e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të jenë të depozituara në Qeverinë e Spanjës, e cila do të marrë përsipër funksionet e sekretariatit.

#### **Neni 31**

##### **Afrimi**

Që nga 10 qershori 1996, ky protokoll do të jetë i hapur për afrim për çdo shtet dhe grupim ekonomik rajonal i cili është Palë e konventës.

#### **Neni 32**

##### **Hyrja në fuqi**

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit, miratimit të tij, ose afrimit të protokollit.

2. Nga data e hyrjes në fuqi, ky protokoll do të zëvendësojë Protokollin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura të Mesdheut të vitit 1982, në marrëdhënie ndërmjet Palëve për të dy instrumentat.

Ky protokoll është firmosur në prani të nënshkruesve të autorizuar nga qeveritë e tyre për këtë qëllim. NË DËSHMI nënshkruesit, duke qenë të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

BËRË në Barcelonë, më 10 Qershor 1995, në një kopje të vetme në arabisht, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalente.

## **ANEKSI I**

# **KRITERET E PËRBASHKËTA PËR ZGJEDHJEN E ZONAVE TË MBROJTURA DETARE DHE BREGDETARE QË MUND TË PËRFSHIHEN NË LISTËN SPAMI**

### **A. PARIMET E PËRGJITHSHME**

Palët kontraktuese bien dakord që parimet e përgjithshme të mëposhtme do t'i udhëheqin në punën e tyre për përcaktimin e Listave SPAMI:

a) Konservimi i trashëgimisë kulturore është qëllimi bazë që duhet të karakterizojë SPAMIN. Ndjekja e qëllimeve të tjera siç janë konservimi i trashëgimisë kulturore dhe nxitja e kërkimit shkencor, edukimit, pjesëmarrjes, bashkëpunimit, janë shumë të dëshirueshme në SPAMI dhe përbëjnë një faktor në favor të një qendre për t'u përfshirë në listë, në shkallën që ajo mbetet në harmoni me qëllimet e konservimit.

b) Nuk imponohet asnjë kufi për numrin e përgjithshëm të zonave që duhen përfshirë në listë ose në numrin e zonave që çdo individ mund të propozojë.

Megjithatë Palët bien dakord që qendrat do të zgjidhen mbi një bazë shkencore dhe do të përfshihen në listë në përputhje me cilësitë e tyre, ato pra duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në protokoll dhe kriteret aktuale.

c) Lista SPAMI dhe shpërndarja e tyre gjeografike duhet të përfaqësojë rajonin e Mesdheut dhe biodiversitetin e tij. Për këtë qëllim lista duhet të përfaqësojë numrin më të lartë të mundshëm dhe tipet e habitateve dhe ekosistemet.

d) Lista SPAMI do të përbëjë zëmren e rrjetit që ka për synim ruajtjen efektive të trashëgimisë së Mesdheut. Për të arritur këtë objektiv, Palët do të zhvillojnë bashkëpunimin e tyre dy apo shumë palesh në fushën e konservimit dhe menaxhimit të qendrave natyrore dhe veçanërisht nëpërmjet ngritjes së listave ndërkufitare SPAMI

e) Qendrat e përfshira në SPAMI kanë për të patur një vlerë shembulli dhe modeli për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të rajonit. Për këtë qëllim Palët sigurohen që qendrat në listë të pajisen me një status ligjor të përshtatshëm, masa mbrojtëse, metoda dhe mjete menaxhimi.

### **B. TIPARE TË PËRGJITHSHME TË ZONËS QË MUND TË PËRFSHIHET NË LISTËN SPAMI**

1. Që të jetë e përshtatshme për t'u përfshirë në Listën SPAMI, një zonë duhet të përmbushë të paktën një nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8, paragrafi 2 të protokollit. Disa nga këto kriteret të përgjithshme në disa raste mund të përmbushen nga e njëjta zonë dhe ky kusht vetëm mund të përforcojë përfshirjen e zonës në listë.

2. Vlera rajonale është një kërkesë bazë për një zonë që të përfshihet në Listën SPAMI. Kriteret e mëposhtme duhet të përdoren për vlerësimin e interesit mesdhetar të një zone:

a) unikalitetin

Zona përmban ekosisteme unike ose të rralla si dhe specie të rralla ose endemike.

b) përfaqësimin natyror

Zona ka procese, komunitete apo habitate ose karakterisika natyrore shumë përfaqësuese. Përfaqësimi është shkalla në të cilën një zonë përfaqëson një tip habitati, proceset ekologjike, komunitetin biologjik, tiparet fiziografike ose karakteristika të tjera natyrore.

c) Diversitetin

Zona ka një diversitet të lartë speciesh, komunitetesh, habitatesh dhe ekosistemesh.

d) Natyrshmërinë

Zona ka një shkallë të lartë natyrshmërie si rezultat i mungesës ose nivelit të ulët të shqetësimit nga aktivitetet e njeriut dhe degradimi.

e) Prania e habitateve që janë kritike për speciet e rrezikuara, të kërcënuara dhe endemike.

f) Përfaqësimi kulturor

Zona ka një vlerë të lartë përfaqësimi në lidhje me trashëgiminë kulturore për shkak të aktivitetëve tradicionale me vlera të shëndosha mjedisore të integruara me natyrën që ndihmojnë mirëqënien e popullsisë lokale.

3. Për t'u përfshirë në listën SPAMI, një zonë që ka interes shkencor, edukativ ose estetik duhet respektivisht të paraqesë një vlerë të veçantë për kërkime në fushën e shkencave natyrore ose për aktivitetet e edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor ose mund të kenë tipare natyrore të rëndësishme, peisazhe etj.

4. Përveç kriterit themelor të specifikuar në nenin 8, paragrafi 2 të protokollit duhet të konsiderohen një numër karakteristikash dhe faktorësh si të favorshëm për përfshirjen e qendrës në listë. Këto përfshijnë:

a) ekzistencën e rreziqeve që mund të dëmtojnë vlerat ekologjike, biologjike estetike ose kulturore të zonës;

b) angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në përgjithësi dhe veçanërisht të komunitetit shkencor në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të zonës-,

c) ekzistencën e një organizmi që përfaqëson publikun, sektorët profesional, joqeveritar dhe komunitetin shkencor që është i përfshirë në zonë;

d) ekzistenca në zona për mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm.

e) ekzistenca e një plani menaxhimi bregdetar të integruar brenda kuptimit të nenit 4, paragrafi 3 (e) të konventës.

### C. STATUSI LIGJOR

1. Të gjitha zonat e përshtatshme për përfshirjen në listën SPAMI, duhet të pajisen me një status ligjor që garanton mbrojtjen e tyre efektive afatgjatë.

2. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI, një zonë në të cilën një Palë ushtron sovranitet dhe juridiksion duhet të ketë një status mbrojtjeje të njohur nga pala e interesuar.

3. Në rastin e zonave të ndodhura pjesërisht ose tërësisht pranë detit ose në zona ku nuk janë përcaktuar kufizimet e sovranitetit ose juridiksionit kombëtar, statusi ligjor, plani i menaxhimit, masat e aplikueshme dhe elementë të tjerë të përfshirë në nenin 9, paragrafi 3, të protokollit do të sigurohen nga Palët fqinje të interesuara në propozimin për përfshirjen në listën SPAMI.

### D- MASAT MBROJTËSE: PLANIFIKUESE DHE MENAXHUESE

1. Objektivat e konservimit dhe menaxhimit duhet të përcaktohen qartë në tekstet e çdo qendre dhe do të përbëjnë një bazë për vlerësimin e mjaftueshmërisë së masave të marra dhe efikasitetit të zbatimit në rishikimin e Listës SPAMI.

2. Masat mbrojtëse, planifikuese dhe menaxhuese të zbatueshme për çdo zonë duhet të jenë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të konservimit afatshkurtër e afatgjatë dhe të marrë në veçanti parasysh kërcënimet që i bëhen.

3. Masat e mbrojtjes, planifikimit dhe menaxhimit do të bazohen në njohuritë e duhura të elementëve të mjedisit natyror dhe të faktorëve social-ekonomikë dhe kulturorë që karakterizojnë çdo zonë. Në rast të mangësive në njohuritë bazë, një zonë e propozuar në Listën SPAMI duhet të ketë një program për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit që mungojnë.

4. Kompetenca dhe përgjegjësia në administrimin dhe zbatimin e masave të konservimit për zonat e propozuara për t'u përfshirë në Listën SPAMI duhet të përcaktohen qartë në tekstet që zbatohen nësecilën zonë.

5. Në lidhje me specifikën që karakterizon çdo qendër të mbrojtur, masat mbrojtëse për SPAMI duhet të kenë parasysh aspektet bazë të mëposhtme:

a) forcimi i rregullave për lëshimin ose hedhjen e mbetjeve dhe substancave të tjera që direkt ose indirekt prishin integritetin e zonës.

b) forcimi i rregullave të futjes ose ri-futjes së specieve në zonë;

c) rregullimi i çdo aktiviteti ose veprimi që dëmton ose shqetëson speciet, ose mund të rrezikojnë statusin e konservimit të ekosistemeve ose specieve ose mund të prishin karakteristikat natyrore, kulturore ose estetike të zonës.

d) rregullat e aplikueshme në zonat që rrethojnë sipërfaqen në fjalë.

6. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI një sipërfaqe e mbrojtur duhet të ketë një organizëm menaxhues të veshur me fuqi të mjaftueshme si dhe me mjetet dhe burimet njerëzore për të ndaluar dhe / ose kontrolluar aktivitetet që mund të jenë të kundërta me qëllimet e sipërfaqes së mbrojtur.

7. Për t'u përfshirë në Listën SPAMI një zonë duhet të ketë një plan menaxhimi. Rregullat kryesore të këtij plani menaxhues do të përcaktohen në kohën e përfshirjes në listë dhe do të zbatohen menjëherë. Duhet të paraqitet një plan i detajuar i menaxhimit brenda tre vjetëve nga koha e përfshirjes. Nëse nuk zbatohet një detyrim i tillë zona rrezikohet të hiqet nga lista.

8. Për t'u përfshirë në listën SPAMI zona duhet të ketë një program monitorimi. Ky program duhet të përfshijë identifikimin dhe monitorimin e një numri parametrash të rëndësishëm për zonën në fjalë, për të arritur vlerësimin e gjendjes dhe evolucionin të zonës, si dhe efektivitetin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese që zbatohen në mënyrë që ato të mund të miratohen nëse nevojitet. Për këtë qëllim duhen ndërmarrë studime të mëtejshme.

Magnoliophyta

*Posidonia oceanica*

*Zostera marina*

*Zostera noltii*

Chlorophyta

*Caulerpa ollivieri*

Phaeophyta

*Cystoseira amentacea* (përfshi *var stricta* dhe *var spicata*)

*Cystoseira mediterranea*

*Cystoseira sedoides*

*Cystoseira spinosa* (përfshi *C. adriatica*)

*Cystoseira zosteroides*

*Laminaria rodriguezii*

Rhodophyta

*Goniolithon byssoides*

*Lithophyllum lichenoides*

*Ptilophora mediterranea*

*Schimmelmannia schousboei*

Porifera

*Asbestopluma hypogea*

*Aplysina* sp. Plur.

*Axinella cannabina*

*Axinella polypoides*

Geodia cydonium  
Ircinia foetida  
Ircinia pipetta  
Petrobiona massiliana  
Tethya sp. plur

#### Cnidaria

Astroides calyculatis  
Errina aspera  
Gerardia savaglia

#### Echinodermata

Asterina pancerii  
Centrostephanus longispinus  
Ophidiaster ophidianus

#### Bryozoa

Hornera lichenoides

#### Mollusca

Ranella oleria (=Argobuccinum olearium = A. giganteum)  
Charonia lampas (= Ch. rubicunda = Ch. nodifera)  
Charonia tritonis (Ch. seguenziae)  
Dendropoma petraeum  
Erosaria spurca  
Gibbula nivosa  
Lithophaga lithophaga  
Luria lurida (= Cypraea lurida)  
Mitra zonata  
Patella ferruginea  
Patella nigra  
Pholas dactylus  
Pinna nobilis  
Pinna rudis (= P. pernula)  
Schilteria achatidea  
Tonna galea  
Zonaria pyrum

#### Crustacea

Ocypode cursor  
Pachylasma giganteum

#### Pisces

Acipenser naccarii  
Acipenser sturio  
Aphanius fasciatus  
Aphanius iberus  
Cetorhinus maximus  
Carcharodon carcharias  
Hippocampus ramuosus  
Hippocampus hippocampus  
Huso huso  
Lethenteron zanandreo  
Mobula mobular  
Pomatoschistus canestrinii  
Pomatoschistus tortonesei



*Valencia hispanica*  
*Valencia letourneuxi*

#### Reptiles

*Caretta caretta*  
*Chelonia mydas*  
*Dermochelys coriacea*  
*Eretmochelys imbricata*  
*Lepidochelys kempii*  
*Trionyx triunguis*

#### Aves

*Pandion haliaetus*  
*Calonectris diomedea*  
*Falco eleonora*  
*Hydrobates pelagicus*  
*Larus audouinii*  
*Numenius tenuirostris*  
*Phalacrocorax aristotelis*  
*Phalacrocorax pygmaeus*  
*Pelecanus onocrotalus*  
*Pelecanus crispus*  
*Phoenicopterus ruber*  
*Puffinus yelkouan*  
*Stema albifrons*  
*Stema bengalensis*  
*Stema sandvicensis*

#### Mammalia

*Balaenoptera acutorostrata*  
*Balaenoptera borealis*  
*Balaenoptera physalus*  
*Delphinus delphis*  
*Eubalaena glacialis*  
*Globicephala melas*  
*Grampus griseus*  
*Kogia simus*  
*Megaptera novaeangliae*  
*Mesoplodon densirostris*  
*Monachus monachus*  
*Orcinus orca*  
*Phocoena phocoena*  
*Physeter macrocephalus*  
*Pseudorca crassidens*  
*Stenella coeruleoalba*  
*Steno bredanensis*  
*Tursiops truncatus*  
*Ziphius cavirostris*

## ANEKSI III

### LISTA E SPECIEVE SHFRYTËZIMI I TË CILAVE ËSHTË I RREGULLUAR

#### Porifera

*Hippospongia communis*  
*Spongia agaricina*  
*Spongia officinalis*  
*Spongia zimocca*

#### Cnidaria

*Antipathes* sp. plur  
*Corallium rubrum*

#### Echinodermata

*Paracentrotus lividus*

#### Crustacea

*Homarus gammarus*  
*Maja squinado*  
*Palinurus elephas*  
*Scyllarides latus*  
*Scyllarus pigmaeus*  
*Scyllarus arctus*

#### Pisces

*Alosa alosa*  
*Alosa fallax*  
*Anguilla anguilla*  
*Epinephelus marginatus*  
*Isurus oxyrinchus*  
*Lamna nasus*  
*Lampetra fluviatilis*  
*Petromyzon marinus*  
*Pironace glauca*  
*Raja alba*  
*Sciaena umbra*  
*Squatina squatina*  
*Thunnus thynnus*  
*Umbrina cirrosa*  
*Xiphias gladius*

# **PROTOKOLLI PËR MBROJTJEN E DETIT MESDHE KUNDËR NDOTJES PREJ EKSPLORIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË SHELFIT KONTINENTAL, SHTRATIT TË DETIT DHE NËNTOKËS SË TIJ**

Palët në këtë Protokoll,

*Duke qenë Palë të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes, miratuar në Barcelonë më 16 Shkurt 1976,*

*Duke mbajtur parasysh Nenin 7 të Konventës në fjalë,*

*Duke patur parasysh rritjen e aktiviteve të eksplorimit dhe shfrytëzimit të shtratit të detit dhe nëntokës së tij,*

*Duke kujtuar që ndotja e krijuar përfaqëson një rrezik serioz për mjedisin dhe njerëzit,*

*Duke dëshiruar mbrojtjen dhe ruajtjen e Detit Mesdhe nga ndotja prej aktiviteve të eksplorimit dhe shfrytëzimit,*

*Duke marrë parasysh Protokollet lidhur me Konventën për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes dhe, në veçanti, Protokollin e Bashkëpunimit për Luftën e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Hidrokarburet dhe Substancat e tjera të Dëmshme në Rastet e Emergjencave, miratuar në Barcelonë më 16 Shkurt 1976, dhe Protokollin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura Mesdhetare, miratuar në Gjenevë më 3 Prill 1982,*

*Duke mbajtur parasysh dispozitat përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit, miratuar në Gjirin Montego në 10 Dhjetor 1982 dhe nënshkruar nga shumë Palë,*

*Duke njohur ndryshimet në nivelin e zhvillimit midis Vendeve bregdetare dhe marrë parasysh aspiratat ekonomike e sociale të vendeve në zhvillim,*

*Ranë dakort si vijon:*

## **KAPITULLI I TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Përkufizime**

Për qëllimet e këtij Protokoll:

(a) “Konventë” do të thotë Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes, miratuar në Barcelonë më 16 Shkurt 1976;

(b) “Organizatë” quhet organizimi i referuar në nenin 17 të Konventës,

(c) “Burime” quhen të gjitha burimet minerare, qofshin të ngurta, të lëngëta ose të gazta;

(d) “Aktivitetet e eksplorimit dhe/ose shfrytëzimit të burimeve në Zonën e Protokollit” (që më poshtë do të quhen “aktivitete”) do të thotë:

- (i) Aktivitetet e kërkimit shkencor për burime në shtratin e detit dhe nëntokën e tij
- (ii) Aktivitetet eksploruese;
  - Aktivitetet sizmologjike; studimet për shtratin e detit dhe nëntokës së tij; marrja e mostrave;
  - Shpimet eksploruese;
- (iii) Aktivitetet shfrytëzuese:
  - Vendosja e një instalimi me qëllim përfitimin e burimeve dhe aktivitetet e lidhura me të;
  - Zhvillimi i shpimeve;
  - Përftimi, trajtimi dhe ruajtja;
  - Transportimi në breg me anë të tubacioneve dhe anijeve;
  - Mirëmbajtja, riparimi dhe operacione të tjera ndihmëse;

(e) “Ndotje” është përcaktuar në nenin 2, paragrafi (a) të Konventës;

(f) “Instalim” nënkupton një strukturë fikse ose lundruese, ose pjesë që lidhen me aktivitetin, që përfshijnë veçanërisht:

- (i) Pajisje shpuese detare fikse ose të lëvizshme;
- (ii) Pajisje prodhuese fikse ose lundruese duke përfshirë pajisjet dinamike-pozicionale;
- (iii) Pajisjet ruajtëse detare duke përfshirë anijet e përdorura për këtë qëllim;
- (iv) Vendet për ngarkimet në det dhe sistemet e transportit për prodhimet e nxjerra, si p.sh. tubacionet nën det;
- (v) Aparaturat e bashkëngjitura dhe pajisjet për ringarkim, përpunim, ruajtje dhe asgjесim të substancave të marra nga shtrati i detit ose nëntoka e tij;

(g) “Operator” do të thotë:

- (i) një person fizik ose juridik që është autorizuar nga Pala që ka në juridiksion zonën ku kryhen aktivitetet (që këtu do të quhet “Palë Kontraktuese”) në përputhje me këtë Protokoll për të kryer aktivitetet dhe/ose që kryen aktivitete; ose
- (ii) një person që nuk ka autorizim sipas kuptimit të këtij Protokollit, por që kontrollon “de facto” këto aktivitete;

(h) “Zona e sigurisë” nënkupton një zonë të caktuar përreth instalimeve në përputhje me përmbajtjen e ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar dhe kërkesave teknike, me shenja dalluese për të siguruar mbrojtjen e anijeve dhe instalimeve;

(i) “Mbetjet” nënkuptojnë substancat dhe materialet e çdo lloji, forme ose paraqitje që rezultojnë prej aktiviteteve të mbuluara nga ky Protokoll që asgjесohen ose mendohet të asgjесohen ose që kërkohet të asgjесohen;

j) “Substanca dhe materiale të dëmshme” kuptohen substancat dhe materialet e çdo lloji, forme ose paraqitje, që mund të shkaktojnë ndotje, nëse shfaqen në Zonën e Protokollit;

(k) “Plani i Përdorimit të Kimikateve” nënkupton një plan të përgatitur prej operatorit të një instalimi detar që përmban:

- (i) Kimikatet që subjekti mendon të përdorë gjatë punës;
- (ii) Qëllimi ose qëllimet për të cilat operatori kërkon të përdorë kimikatet;
- (iii) Përqëndrimet maksimale të kimikateve që operatori mendon të përdorë brenda substancave të tjera, dhe sasi të maksimale që mendohet të përdoren në një periudhë të caktuar;
- (iv) Zonën brenda së cilës kimikati mund të përhapet në det;

(l) “Naftë” kuptohet lënda në formën e naftës së papërpunuar, naftës si lëndë djegëse, tokës së ndotur me naftë, mbeturinat e naftës dhe prodhimet e përpunuara si dhe substancat e përmendura në Aneksin e këtij Protokollit;

(m) “Përzierjet e naftës” kuptohet një përzierje në të cilën ka naftë;

(n) “Mbetje” kuptohen:

- (i) Mbetjet nga kullimi dhe të tjera prej banjove, urinoreve, lavamanëve;
- (ii) Mbetjet prej veprimeve mjekësore (farmacitë, të vjellat e të sëmurëve, etj.) nëpërmjet lavamanëve, tubacioneve dhe të tjera që lidhen me këto veprime;
- (iii) Mbetje të tjera ujore të bashkuara me mbetjet nga kullimi të përmendura më sipër;

(o) “Plehra” kuptohen të gjitha llojet e ushqimeve, mbetjet shtëpiake dhe nga aktivitetet që shkaktohen gjatë kryerjes së një aktiviteti dhe që do të asgjësohen vazhdimisht ose periodikisht, përveç substancave që përcaktohen ose janë listuar në këtë Protokoll;

(p) “Kufiri i ujrave të ëmbla” nënkupton vendin në rrjedhat ujore ku, në rrjedhat e dobta dhe në periudhën e prurjeve të vogla të ujrave të ëmbla, ka një rritje të dukshme të kripëzimit për arsye të prezencës së ujit të detit.

## **Neni 2**

### **Shtrirja gjeografike**

1. Zona në të cilën ky Protokoll do të aplikohet (që këtej do të quhet “Zona e Protokollit”) do të jetë:

(a) Zona e Detit Mesdhe siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës, duke përfshirë shelfin kontinental, shtratin e detit dhe nëntokën e tij;

(b) Ujrat, duke përfshirë shtratin e detit dhe nëntokën e tij, në anën tokësore të basenit nga ku mund të matet pjerësia dhe shtrirja e bregdetit, në rastin e vijave të ujit, deri tek kufiri i ujrave të ëmbla.

2. Çdo Palë në këtë Protokoll (që këtej e tutje në këtë Protokoll do të quhen “Palë”) mund të përfshijë në sipërfaqen e Protokollit zonat e lagëta ose zonat bregdetare të territorit të tyre.

3. Asgjë në këtë Protokoll, dhe as ndonjë akt i përgatitur mbi bazën e këtij Protokollit, nuk do të çenojë të drejtat e çdo Shteti lidhur me përcaktimin e kufijve të shelfit kontinental.

## **Neni 3**

### **Masa të përgjithshme**

1. Palët do të marrin, individualisht ose nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh, të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar, pakësuar, luftuar dhe kontrolluar ndotjen në Zonën e Protokollit që rezultojnë prej aktiviteteve, duke siguruar që teknikat me të përshtatshme mjedisore e ekonomike përdoren për këtë qëllim.

2. Palët duhet të sigurojnë që të gjitha masat janë marrë, në mënyrë që aktivitetet të mos shkaktojnë ndotje.

## **KAPITULLI II**

### **SISTEMI I LEJEVE**

## **Neni 4**

### **Parime të përgjithshme**

1. Të gjitha aktivitetet në Zonën e Protokollit, duke përfshirë ngritjen në qendër të instalimeve që do t’u nënshtrohen paraprakisht një autorizimi me shkrim për eksplorim dhe shfrytëzim nga autoritetet kompetente. Ky autoritet, para se të japë autorizimin duhet të bindet që instalimi është kryer sipas standarteve dhe praktikave ndërkombëtare dhe se operatori ka kompetence teknike dhe aftësi financiare për të kryer aktivitete të tilla. Ky autorizim do të jepet në përputhje me procedurat e duhura siç është përcaktuar nga autoritetet kompetente.

2. Autorizimi do të refuzohet në qoftë se ka të dhëna që aktivitetet e propozuara mund të shkaktojnë efekte të mëdha negative në mjedis që nuk mund të shmangen nga përmbushja e kushteve të parashtruara në autorizim dhe përmendur në Nenin 6, paragrafi 3 i këtij Protokollit.

3. Kur shqyrtohet miratimi për dhënien e vendit të instalimit, Pala Kontraktuese do të sigurohet që asnjë efekt i dëmshëm nuk mund t'u shkaktohet pajisjeve ekzistuese nga ky vend, veçanërisht tubacioneve dhe kablllove.

## **Neni 5**

### **Kërkesat për lejet**

1. Palët duhet të njoftojnë që çdo aplikim për marrë leje ose për rinovimin e saj do të shoqërohet me paraqitjen e një projekti prej operatorit tek autoriteti kompetent dhe që një aplikim i tillë duhet të përmbajë:

(a) Një vëzhgim/studim, mbi efektet e aktivitetit që do të kryhet, mbi mjedisin; autoriteti kompetent duke patur parasysh natyrën, fushën e veprimtarisë, kohëzgjatjen dhe metodat teknike që do të përdoren gjatë aktivitetit si dhe karakteristikat e zonës, mund të kërkojë një vlerësim të ndikimit në mjedis sipas Aneksit IV të këtij Protokollit;

(b) Përshkrimin e kufijve të zonës gjeografike ku kryhet aktiviteti, duke përfshirë zonat e sigurisë;

(c) Të dhëna për kualifikimin profesional dhe teknik të operatorit dhe personelit të tij të instalimit, si dhe përbërjen e ekipit;

(d) Masat siguroese siç specifikohet në Nenin 15;

(e) Planin rezerve të operatorit siç specifikohet në Nenin 16;

(f) Procedurat e monitorimit siç specifikohet në Nenin 19;

(g) Planet për lëvizjen e instalimeve siç specifikohet në Nenin 20;

(h) Masat paraprake për zonat veçanërisht të mbrojtura siç specifikohet në Nenin 21

(i) Sigurimin në përgjithësi ose atë financiar për të mbuluar përgjegjësitë siç përshkruhet në Nenin 27, paragrafi 2(b).

2. Autoriteti kompetent mund të vendosë, për kërkime shkencore dhe aktivitete eksplorimi, të zvogëlojë kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni, duke patur parasysh natyrën, fushën e veprimtarisë, kohëzgjatjen dhe metodat teknike që përdoren në aktivitet dhe karakteristikat e zonës.

## **Neni 6**

### **Dhënia e lejeve**

1. Lejet sipas Nenit 4 do të jepen vetëm pas shqyrtimit prej autoritetit kompetent të kërkesave sipas Nenit 5 dhe Aneksit IV,

2. Çdo leje do të përmbajë aktivitetin dhe kohën e vlefshmërisë së lejes, kufijtë gjeografikë të zonës dhe kërkesat teknike e instalimet e lejuara. Zona e sigurisë do të përcaktohet në një fazë të mëvonshme.

3. Leja mund të përmbajë kushte lidhur me masat, teknikat ose metodat e përcaktuara për të reduktuar në minimum rreziqet dhe dëmet prej ndotjes së krijuar prej aktivitetit.

4. Palët duhet të njoftojnë Organizatën sa më parë për lejet e reja ose ato të rinovuara. Organizata do të mbajë një regjistër për të gjitha instalimet e lejuara në Zonën e Protokollit.

## **Neni 7**

### **Sanksionet**

Çdo Palë do të përcaktojë sanksione që do të zbatohen në rastet e mos zbatimit të detyrimeve të përcaktuara nga ky Protokoll, ose për mos zbatim të ligjeve kombëtare ose rregulloreve për zbatimin e këtij Protokollit, ose për mos plotësimin e kushteve specifike që i bashkangjiten lejes.

## **KAPITULLI III**

### **MBETJET DHE SUBSTANCAT E MATERIALET E DËMSHME OSE të RREZIKSHME**

#### **Neni 8**

##### **Detyrime të përgjithshme**

Pa paragjykuar standartet ose detyrimet në këtë Kapitull, Palët duhet të imponojnë një detyrim të përgjithshëm mbi subjektet për të përdorur teknikat më të mira mjedisore dhe ekonomike dhe të respektojnë standartet e pranuar ndërkombëtare lidhur me mbetjet, si dhe përdorimin, ruajtjen, dhe asgjesimin e substancave e materialeve të rrezikshme e të dëmshme, me qëllim minimizimin e rrezikut të ndotjes.

#### **Neni 9**

##### **Substancat dhe materialet e rrezikshme dhe të dëmshme**

1. Përdorimi dhe ruajtja e kimikateve për aktivitetin do të aprovohet prej autotitetit kompetent, mbi bazën e Planit të Përdorimit të Kimikateve.

2. Pala Kontraktuese mund të rregullojë, kufizojë ose ndalojë përdorimin e kimikateve për aktivitetet në përputhje me udhëzuesit që duhen zbatuar nga Palët.

3. Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, Palët duhet të sigurojnë që çdo substancë dhe material i përdorur për aktivitetin në fjalë të shoqërohet me një përshkrim të përbërësve të përgatitur nga firma që ka prodhuar këto substanca ose materialet.

4. Asgjësimi në Zonën e Protokollit i substancave dhe materialeve të rrezikshme e të dëmshme, që rezultojnë prej aktiviteteve në kuadrin e këtij Protokollit dhe listuara në Aneksin I të këtij Protokollit, është i ndaluar.

5. Asgjësimi në Zonën e Protokollit i substancave dhe materialeve të rrezikshme e të dëmshme që rezultojnë prej aktiviteteve në kuadrin e këtij Protokollit dhe listuara në Aneksin II të këtij Protokollit kërkon, në çdo rast, një leje të veçantë paraprake nga autoritetet kompetente.

6. Asgjësimi në Zonën e Protokollit i substancave dhe materialeve të tjera të rrezikshme e të dëmshme që rezultojnë prej aktiviteteve në kuadrin e këtij Protokollit dhe që mund të shkaktojnë ndotje kërkon një leje paraprake të përgjithshme nga autoriteti kompetent.

7. Lejet sipas paragrafit 5 dhe 6 më sipër do të lëshohen vetëm pas një vlerësimi të kujdesshëm të të gjithë faktorëve të përcaktuar në Aneksin III të këtij Protokollit.

#### **Neni 10**

##### **Nafta e përzierje të saj dhe lëndët e sondat për shpim**

1. Palët duhet të fomulojnë dhe të miratojnë standarte të përbashkëta për asgjesimin e naftës dhe përzierjeve të saj nga instalimet në Zonën e Protokollit:

(a) Këto standarte do të përgatiten në përputhje me kërkesat e Aneksit V, A;

(b) Këto standarte nuk duhet të jenë më pak strikte se sa këto në vazhdim:

(i) Për rrjedhjet e makinerive, lejohet një maksimum përmbajtje naftë e paholluar deri 15 mg/litër;

(ii) Për ujin e përdorur, lejohet një maksimum përmbajtje naftë prej 40 mg/litër si mesatare muaji kalendarik; dhe përmbajtja nuk duhet të kalojë 100 mg/litër,

(c) Palët duhet të përcaktojnë me mirëkuptim se cilat metoda do të përdoren për të analizuar përmbajtjen e naftës.

2. Palët duhet të formulojnë dhe miratojnë standarte për përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve të sondave shpuese dhe të vetë atyre në Zonën e Protokollit. Këto standarte duhet të përgatiten në përputhje me kushtet e Aneksit V, B.

3. Çdo Palë duhet të marrë masa përkatëse për zbatimin e standarteve të miratuara në përputhje me këtë nen ose të zbatojë standarte më strikte në krahasim me ato të miratuara.

## **Neni 11**

### **Ujrat e zeza**

1. Palët Kontraktuese duhet të ndalojnë shkarkimin e ujrave të zeza nga instalimet, në të cilat punojnë përkohësisht 10 ose më shumë persona, në Zonën e Protokollit përveç rasteve kur:

(a) Nga instalimi shkarkohen ujra të zeza pas trajtimit të miratuar prej autoritetit kompetent në një distancë të paktën 4 milje nga toka më e afërt ose instalim i palëvizshëm peshkimi, duke e lënë Palën për të vendosur sipas rastit; ose

(b) Ujrat e zeza nuk janë trajtuar, por shkarkimi kryhet në përputhje me rregullat dhe standartet ndërkombëtare; ose

(c) Ujrat e zeza kalojnë në një impiant trajtimi të miratuar dhe lejuar prej autoritetit kompetent.

2. Pala duhet të imponojë kushte strikte, aty ku është e nevojshme, për arsye të llojit të rrjedhjeve në zonë ose ndonjë zonë në afërsi sipas Nenit 21.

3. Përjashtimet e përmendura në paragrafin 1 nuk do të zbatohen nëse nga shkarkimi prodhohen mbetje të ngurta të dukshme që lundrojnë ose që shkaktojnë ngjyrim, ç'ngjyrim ose ylberizim të ujrave përreth instalimit.

4. Nëse ujrat e zeza janë përzier me mbetje dhe substance e materiale të rrezikshme e të dëmshme që kanë kërkesa asgjësimi të ndryshme, duhet të aplikohen kërkesa më të forta.

## **Neni 12**

### **Plehrat**

1. Pala Kontraktuese duhet të ndalojë asgjësimin në Zonën e Protokollit të prodhimeve dhe materialeve që vijnë;

(a) Materialet plastike, që përfshijnë litarët sintetikë, rrjetat sintetike të peshkimit dhe qeset plastike të plehrave;

(b) Të gjitha plehrat e pa degraduara biologjikisht, duke përfshirë letrat, lecat, qelqet, metalet, shishet, enët e baltës, rërat, rrobat dhe materialet ambalazhuese.

2. Asgjësimi në Zonën e Protokollit i mbetjeve ushqimore duhet të kryhet sa më larg tokës, në përputhje me rregullat dhe standartet ndërkombëtare.

3. Nëse plehrat janë përzier me shkarkime që kanë kërkesa të ndryshme asgjësimi ose shkarkimi, duhen zbatuar kërkesa më strikte.

## **Neni 13**

### **Pajisjet pritëse, udhëzimet dhe sanksionet**

Palët duhet të sigurojnë që:

(a) Subjektet të asgjësojnë në shkallë të mjaftueshme të gjitha mbetjet dhe substancat e materialet e rrezikshme e të dëmshme, pajisjet pritëse në bregdet, përveç rasteve që lejohet ndryshe në këtë Protokoll;

(b) Të jepen udhëzime për personelin lidhur me mjetet e përshtatshme për asgjësim;

(c) Të vendosen sanksione për asgjësimet ilegale.

## **Neni 14**

### **Përjashtime**



Përmbajtja e këtij paragrafi nuk do të aplikohet në rastin e:

(a) Forcave madhore dhe në veçanti për asgjesimin:

- për të mbrojtur njerëzit,
- për të siguruar mbrojtjen e instalimeve,
- në rastin e dëmtimit të instalimeve ose pajisjeve të tyre, me kusht që të gjitha masat paraprake të merren pasi dëmi është konstatuar ose pasi asgjësimi është kryer për të zvogëluar efektet negative.

(b) Shkarkimit në det të substancave që përmbajnë naftë ose substancave e materialeve të dëmshme e rrezikshme që, pas miratimit paraprak të autoritetit kompetent, përdoren me qëllim luftimin e ndotjes prej aksidenteve me qëllim uljen e dëmit për shkak të ndotjes.

2. Sidoqoftë, dispozitat e këtij Neni do të aplikohen në rastet kur subjekti reagon me qëllim për të shkaktuar dëm ose prishje dhe duke ditur që dëmi do të ndodhë.

3. Asgjësimet e kryera në rrethanat sipas paragrafit 1 të këtij Neni duhen raportuar menjëherë tek Organizata dhe/ose nëpërmjet saj ose drejtpërdrejt, tek ndonjë Palë ose Palët që mund të preken, së bashku me të dhëna të plota të rrethanave dhe natyrës së sasisë së mbetjeve ose substancave e materialeve të dëmshme ose rrezikshme të shkarkuara.

## **KAPITULLI IV**

### **MASAT MBROJTËSE**

#### **Neni 15**

##### **Masat e sigurisë**

1. Palët, nën juridiksionin e të cilave janë parashikuar ose kryer aktivitete, duhet të sigurojnë që masat mbrojtëse të jenë ndërmarrë në përputhje me formën, ndërtimin, vendosjen, pajisjet, shënjimin, funksionimin dhe mirë-mbajtjen e instalimeve.

2. Palët duhet të sigurojnë, që në çdo kohë, subjekti ka në instalim pajisje dhe mjete të mjaftueshme, që mirëmbahen në gjëndje të mirë pune, për të mbrojtur njerëzit, parandaluar dhe luftuar ndotjet aksidentale dhe lehtësuar një përgjigje të menjëhershme në rast emergjence, në përputhje me teknikat dhe kushtet më efektive mjedisore dhe të përshtatshme ekonomike të planit të masave paraprake.

3. Autoriteti kompetent duhet të kërkojë një certifikatë të sigurisë dhe përshtatshmërisë për këtë qëllim (që këtej do të quhet “certifikatë”) lëshuar prej një institucioni të njohur përgatitur në përputhje me platformat prodhuese, njësitë shpuese të lëvizshme detare, pajisjet ruajtëse detare, sistemet ngarkuese detare dhe tubacionet e instalimet e tjera siç mund të specifikohet nga Palët.

4. Palët duhet të sigurojnë nëpërmjet inspektimit që aktivitetet janë kryer nga subjekti në përputhje me këtë Nen.

#### **Neni 16**

##### **Planifikimi rezervë**

1. Në rast emergjencash Palët Kontraktuese duhet të zbatojnë në mënyrë të vazhdueshme kushtet e Protokollit për Bashkëpunimin në Luftimin e Ndotjes në Detin Mesdhe prej Hidrokarbureve dhe Substancave të Tjera të Dëmshme në Rastet e Emergjencës.

2. Çdo Palë duhet t’u kërkojë subjekteve që zotërojnë instalimet nën juridiksionin e tij të përgatisin një plan rezervë për të luftuar ndotjen aksidentale, të koordinuar me planin e masave paraprake të Palëve përgatitur në përputhje me Protokollin lidhur me Bashkëpunimin në Luftimin e Ndotjes së Detit Mesdhe prej Hidrokarbureve dhe Substancave të Tjera të Rrezikshme në Rastet e Emergjencave dhe miratuar në përputhje me procedurat e vendosura nga autoritetet kompetente.

3. Secila nga palët duhet të vendosë koordinimin për zhvillimin dhe zbatimin e planeve rezervë. Këto plane duhet të zbatohen në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare kompetente. Planet duhet të jenë në përputhje me kushtet e Aneksit 7 të këtij Protokollit.

### **Neni 17**

#### **Njoftimi**

Çdo Palë duhet t'u kërkojë subjekteve që zotërojnë instalimet nën juridiksionin e tij, të raportojnë pa vonesë tek autoritetet kompetente:

(a) Ndonjë ngjarje gjatë aktivitetit të tyre që shkakton ose që mund të shkaktojë ndotje në Zonën e Protokollit;

(b) Ndonjë ngjarje të vërejtur në det që shkakton ose që mund të shkaktojë ndotje në Zonën e Protokollit.

### **Neni 18**

#### **Asistenca e ndërsjelltë në rastet e emergjencave**

Në rastet e emergjencave, një Palë që kërkon asistencë me qëllim për të parandaluar, pakësuar ose luftuar ndotjen shkakuar nga aktivitetet, mund të kërkojë ndihmë nga Palët, ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet Qendrës Rajonale për Përgjigjen ndaj Emergjencave të Ndotjes Detare në Detin Mesdhe (REMPEC), të cilat duhet të bëjnë të pamundurën për të siguruar ndihmën e kërkuar.

Për këtë qëllim një Palë që është gjithashtu Palë në Protokollin lidhur me Bashkëpunimin për Luftimin e Ndotjes në Detin Mesdhe prej Hidrokarbureve dhe Substancave të Tjera të Rrezikshme në Rastet e Emergjencave duhet të zbatojë kushtet përkatëse të Protokollit në fjalë.

### **Neni 19**

#### **Monitorimi**

1. Subjektit do t'i kërkohej të masë, ose të këtë matur nëpërmjet një institucioni të kualifikuar, ekspert i çështjes, efektet e aktivitetit mbi mjedisin në drejtim të natyrës, fushës së veprimtarisë, kohëzgjatjes, dhe metodave tekni-ke të zbatuara gjatë veprimtarisë dhe karakteristikat e zonës dhe të raportojë periodikisht ose pas një kërkesë të autoritetit kompetent me qëllim vlerësimin prej autoritetit kompetent në përputhje me procedurën vendosur nga autoriteti kompetent në sistemin e tij të autorizimit.

2. Autoriteti kompetent duhet të krijojë, aty ku është e mundur, një sistem kombëtar monitorimi me qëllim për të monitoruar rregullisht instalimet dhe ndikimin e aktiviteteve mbi mjedisin, për të siguruar që kushtet për dhënien e autorizimit janë plotësuar.

### **Neni 20**

#### **Heqja e instalimeve**

1. Subjektit do t'i kërkohej nga autoriteti kompetent të bëjë një instatim që është abandonuar ose që ka dalë nga përdorimi, me qëllim sigurimin e lundrimit të anijeve, duke marrë parasysh udhëzuesit dhe standartet e miratuara nga organizata kompetente ndërkombëtare. Një lëvizje e tillë do të këtë detyrim dhe për përdorime të tjera ligjore të detit, në veçanti peshkimin, mbrojtjen e mjedisit detar, dhe të drejtat e detyrat e Palëve të tjera. Para kësaj lëvizje, subjekti nën përgjegjësinë e tij duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar rrjedhjet ose pikimet prej aktiviteteve.

2. Autoriteti kompetent duhet t'i kërkojë subjektit të heqë tubacionet e abando-nuara ose lëna pas dore sipas paragrafit 1 të këtij Neni ose t'i pastrojë ato në brendësi dhe t'i lerë ose groposë në mënyrë që ato as të mos shkaktojnë ndotje, rrezikojnë lundrimin, pengojnë peshkimin, rrezikojnë mjedisin detar, dhe as mos të ngatërrohen me përdorime të tjera të detit ose me të drejtat dhe detyrat e Palëve të tjera. Autoriteti kompetent duhet të publikojë thellësinë, pozicionin dhe dimensionet e tubacioneve të groposura dhe ky

informacion të paraqitet në një hartë detare dhe t'i njoftohet Organizatës, organizatave të tjera kompetente ndërkombëtare dhe Palëve.

3. Kushtet e këtij Neni aplikohen gjithashtu në instalimet e lëna pas dore ose të braktisura prej ndonjë subjekti leja për të cilët mund të jetë tërhequr ose pezulluar në përputhje me Nenin 7.

4. Autoriteti kompetent duhet të tregojë përmirësimet e mundshme që duhen bërë në aktivitet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit detar.

5. Autoriteti kompetent duhet të rregullojë ndërprerjen ose transferimin e aktiviteteve të lejuara tek personat e tjerë.

6. Në rastet kur subjekti nuk arrin të plotësojë kërkesat e këtij Neni, autoriteti kompetent duhet të ndër marrë, me shpenzimet e subjektit, një veprim të tillë ose veprime që mund të jenë të nevojshme të rregullojnë paaftësinë e subjektit të veprojë.

## **Neni 21**

### **Zonat veçanërisht të mbrojtura**

Për mbrojtjen e zonave të përcaktuara në Protokollin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura Mesdhetare dhe ndonjë zonë tjetër të përcaktuar nga një Palë dhe në mbështetje të qëllimeve të caktuara. Palët duhet të marrin masa specifike në përputhje me ligjin ndërkombëtar ose individualisht ose nëpërmjet bashkëpunimit shumëpalësh ose dypalësh, për të parandaluar, pakësuar, luftuar dhe kontrolluar ndotjen e krijuar nga aktivitetet në këto zona.

Në vijim të masave të përcaktuara në Protokollin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura Mesdhetare për dhënie e lejes, në këto masa do të përfshihen dhe:

- (a) Kufizime ose kushte specifike kur jepet leja për këto zona:
  - (i) Përgatitja dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis;
  - (ii) Caktimi i kushteve speciale në këto zona lidhur me monitorimin,
  - (iii) Lëvizjen e instalimeve dhe ndalimin e ndonjë shkarkimi.
- (b) Shkëmbim intensiv informacioni midis subjekteve, autoriteteve kompetente, Palëve dhe Organizatës lidhur me masat që mund të ndikojnë në këto zona.

## **KAPITULLI V**

### **BASHKËPUNIMI**

## **Neni 22**

### **Programet studimore dhe kërkimore**

Në përputhje me Nenin 13 të Konventës, Palët, aty ku është e mundur, duhet të bashkëpunojnë në nxitjen e studimeve dhe ndërmarrjen e programeve të kërkimit shkencor dhe teknologjik me qëllim përgatitjen e metodave të reja për:

- (a) Ndërmarrjen e aktiviteteve në mënyrë që të minimizohet rreziku i ndotjes;
- (b) Parandalimin, zvogëlimin, luftimin dhe kontrollin e ndotjes, veçanërisht në rastet emergjente.

## **Neni 23**

### **Rregullat, standartet ndërkombëtare dhe praktikatat e procedurat e rekomanduara**

1. Palët duhet të bashkëpunojnë, ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet Organizatës ose organizatave të tjera ndërkombëtare, me qëllim për të:

- (a) Vendosur kritere të përshtatshme shkencore për formulimin dhe caktimin e rregullave, standarteve dhe praktikave e procedurave të rekomanduara ndërkombëtare për të arritur qëllimet e këtij Protokollit;
- (b) Formuluar dhe caktuar rregulla, standarte dhe praktika e procedura të rekomanduara;
- (c) Formuluar dhe përshtatur udhëzues në përputhje me procedurat dhe praktikat ndërkombëtare për të siguruar zbatimin e kushteve të Aneksit VI.

2. Palët duhet që, sa më parë, të përpiqen të harmonizojnë ligjet dhe rregullat e tyre me rregullat, standartet dhe praktikat e procedurat ndërkombëtare sipas paragrafit 1 të këtij Neni.

3. Palët duhet të përpiqen, sa më shumë të jetë e mundur, të shkëmbejnë informacion në përshtatje me politikat, ligjet dhe rregullat e vendeve të tyre dhe t'i harmonizojnë ato duke iu referuar paragrafit 2 të këtij Neni.

## **Neni 24**

### **Asistenca teknike dhe shkencore për vendet në zhvillim**

1. Palët duhet që, drejtpërdrejt ose me ndihmë të organizatave rajonale përkatëse ose atyre ndërkombëtare, të bashkëpunojnë me qëllim për të formuluar dhe zbatuar programet e asistencës për vendet në zhvillim, veçanërisht në fushat e shkencës, legjislationit, edukimit dhe teknologjisë, me qëllim për të parandaluar, zvogëluar, luftuar dhe kontrolluar ndotjen e krijuar prej aktiviteteve në Zonën e Protokollit.

2. Asistenca teknike duhet të përfshijë, në veçanti, trainimin e shkencëtarëve, juristëve dhe teknikëve, si dhe përfitimin, përdorimin dhe prodhimin e pajisjeve të përshtatshme prej këtyre shteteve dhe që duhet të miratohen midis Palëve në fjalë.

## **Neni 25**

### **Informacioni i ndërsjellë**

Palët duhet të informojnë njëra-tjetrën drejtpërdrejt ose nëpërmjet Organizatës për masat e marra, rezultatet e arritura dhe vështirësitë e ndeshura në zbatimin e këtij Protokollit. Procedurat për grumbullimin dhe paraqitjen e këtij informacioni do të përcaktohen në takimin e Palëve.

## **Neni 26**

### **Ndotja ndërkufitare**

1. Çdo Palë duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që aktivitetet nën juridiksionin e saj janë kryer në mënyrë që të mos shkaktojnë ndotje jashtë limiteve të juridiksionit të saj.

2. Një Palë nën juridiksionin e së cilës janë parashikuar ose kryer aktivitete duhet të marrë parasysh ndonjë efekt mjedisor të kundërt, pa i nënvleftësuar efektet që mund të shkaktohen brenda limiteve të juridiksionit të saj ose jashtë tyre.

3. Nëse një Palë konstaton raste kur mjedisi detar është në rrezik të menjëhershëm të dëmtohet, ose është dëmtuar prej ndotjes, ajo duhet menjëherë të njoftojë Palët e tjera që sipas mendimit të saj mund të dëmtohen nga ndotja, si dhe REMPEC-un, dhe të sigurojë një informacion të shpejtë që t'u japë atyre mundësi, për të marrë masat e duhura. REMPEC-U duhet të shpërndajë informacionin menjëherë tek të gjitha Palët që lidhen me rastin.

4. Palët duhet të përpiqen që në përputhje me sistemet e tyre ligjore, mbi bazën e një mirëkuptimi të lejojnë hyrjen e barabartë dhe trajtimin në proceset administrative të personave në vendet e tjera që mund të ndikohen nga ndotja ose efekte të tjera të kundërta që rezultojnë nga aktivitetet e propozuara ose ekzistuese.

5. Kur ndotja e ka origjinën nga territori i një Shteti që nuk është Palë e këtij Protokollit, çdo Palë që preket duhet të përpiqet të bashkëpunojë me Shtetin në fjalë në mënyrë që të bëjë të mundur zbatimin e këtij Protokollit.

## **Neni 27**

## **Përgjegjësitë dhe kompensimi**

1. Palët nisin të bashkëpunojnë sa më parë për formulimin dhe përshtatjen rregullave dhe procedurave për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompensimin e dëmit shkaktohet nga aktivitetet që lidhen me këtë Protokoll, në përputhje me Nenin 16 të kësaj Konvente.

2. Gjatë kryerjes së këtyre procedurave, çdo Palë:

(a) Duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që përgjegjësitë për dëmin e shkaktuar nga aktivitetet t'u detyrohen subjekteve, dhe ato duhet të paguajnë dëmin në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë;

(b) Duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që subjektet do të kenë dhe sigurojnë që të mbulojnë sigurimin ose sigurime të tjera financiare ashtu siç specifikohet nga Palët me qëllim sigurimin e kompensimit të dëmeve të shkaktuar nga aktivitetet në kuadrin e këtij Protokoll.

## **KAPITULLI VI**

### **DISPOZITAT FINALE**

#### **Neni 28**

##### **Caktimi i autoriteteve kompetente**

Çdo Palë duhet të caktojë një ose më shumë autoritete kompetente për të:

- (a) Dhënë, rinovuar dhe regjistruar lejet e dhëna sipas Kapitullit II të këtij Protokoll;
- (b) Lëshuar dhe regjistruar lejet e përgjithshme dhe të veçanta sipas Nenit 9 të këtij Protokoll;
- (c) Lëshuar lejet sipas Aneksit V të këtij Protokoll;
- (d) Aprovuar sistemin e trajtimit dhe regjistrojë impiantin e trajtimit të ujrave të zeza sipas Nenit 11, paragrafi 1, i këtij Protokoll;
- (e) Dhënë aprovimin paraprak për shkarkimet e veçanta sipas Nenit 14, paragrafi 1 (b), i këtij Protokoll;
- (f) Realizuar detyrat lidhur me masat mbrojtëse sipas Nenit 15, paragrafi 3 dhe 4, i këtij Protokoll;
- (g) Kryer funksionet lidhur me planin rezervë siç përshkruhet në Nenin 16 dhe Aneksin VIII të këtij Protokoll;
- (h) Përcaktuar procedurat e monitorimit siç thuhet në Nenin 19 të këtij Protokoll;
- (i) Mbikqyrë heqjen e instalimeve siç thuhet në Nenin 20 të këtij Protokoll.

#### **Neni 29**

##### **Masat kalimtare**

Çdo Palë duhet të formulojë procedura dhe rregullore lidhur me aktivitetet, kur lejohet ose jo, përpara hyrjes në forcë të këtij Protokoll, për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me kërkesat e këtij Protokoll.

#### **Neni 30**

##### **Takimet**

1. Takimet e zakonshme të Palëve duhet të kryhen në përputhje me takimet e zakonshme të Palëve të Konventës që mbahen sipas Nenit 18 të Konventës. Palët mund të mbajnë dhe takime të jashtëzakonshme sipas Nenit 18 të Konventës.

2. Funksionet e takimeve të Palëve të këtij Protokoll do të kryhen ndër të tjera për të:

- (a) Patur nën kontroll zbatimin e këtij Protokoll dhe për të konstatuar efikasitetin e masave të marra dhe atyre të rekomanduara, në veçanti ato në anekse dhe shtojca;
- (b) Rishikuar dhe korigjuar ndonjë aneks ose shtojcë të këtij Protokoll;
- (c) Marrë parasysh informacionin lidhur me lejet e dhëna ose rinovuara në përputhje me Kapitullin II të këtij Protokoll;

(d) Marrë parasysh informacionin lidhur me lejet e lëshuara dhe miratuara të dhëna në përputhje me Kapitullin III të këtij Protokoll;

(e) Përshtatur udhëzuesat sipas Nenit 9 paragrafi 2 dhe Neni 23, paragrafi 1(c), i këtij Protokoll;

(f) Marrë parasysh të dhënat e planit të masave paraprake dhe mjeteve të ndërhyrjes në rastet e emergjencave sipas Nenit 16 të këtij Protokoll;

(g) Vendosur kritere dhe formuluar rregulla, standarte dhe praktika e procedura të rekomanduara në përputhje me Nenin 23, paragrafi 1, i këtij Protokoll, në çdo formë që Palët mund të bien dakort;

(h) Lehtësuar zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave sipas Kapitullit V, në veçanti harmonizimin e legjislacionit kombëtar dhe Komunitetit European në përputhje me Nenin 23, paragrafi 2, të këtij Protokoll;

(i) Parë progresin e arritur në zbatimin e Nenit 27 të këtij Protokoll;

(j) Kryer funksione të tjera që mund të jenë të nevojshme për aplikimin e këtij Protokoll;

### **Neni 31**

#### **Lidhjet me Konventën**

1. Dispozitat e Konventës lidhur me ndonjë Protokoll do të zbatohen në përputhje me këtë Protokoll.
2. Rregullat proceduriale dhe rregullat financiare përgatitur sipas Nenit 24 të Konventës duhet të zbatohen sipas këtij Protokoll, pavarësisht në se Palët e këtij Protokoll bien dakort ndryshe.

### **Neni 32**

#### **Neni i fundit**

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Madrid nga 14 Tetori 1994 deri në 14 Tetor 1995, prej Shteteve Palë në Konventë të ftuara në Konferencën e Përfaqësuesve të Shteteve Bregdetare të Rajonit të Mesdheut për Protokollin e Mbrojtjes së Detit Mesdhe kundër Ndotjes shkaktuar nga Eksplorimi dhe Shfrytëzimi i Shtratit të Detit dhe nëntokës së saj i mbajtur në Madrid më 13 dhe 14 Tetor 1994. Ai do të jetë i hapur për nënshkrim në të njëjtat data për Komunitetin European dhe grupime rajonale ekonomike të ngjashme në të cilët të paktën një anëtar është Vend bregdetar në Zonën e Protokollit dhe ushtron kompetencë në fushat që mbulon ky Protokoll në përputhje me Nenin 30 të Konventës.

2. Ky Protokoll do të t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo aprovimit. Instrumentat e ratifikimit, pranimit ose aprovimit do të depozitohen tek Qeveria Spanjolle, e cila do të marrë përsipër funksionet e Sekretarit.

3. Nga 15 Tetori 1995, ky Protokoll do të jetë i hapur për pranim nga Shtetet sipas paragrafit 1 më sipër, prej Komunitetit European dhe ndonjë grupimi përmendur po në atë paragraf.

4. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së depozitimit e të paktën 6 instrumentave të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, ose hyrjes, në Protokoll prej Palëve sipas paragrafit 1 të këtij Neni.

**NË PRANI** nënshkruarit, të autorizuar, firmosën këtë Protokoll.

## ANEKSI I

### **SUBSTANCAT DHE MATERIALET E DËMSHME OSE TË RREZIKSHME, ASGJËSIMI I TË CILAVE NË ZONËN E PROTOKOLLIT ËSHTË I NDALUAR**

A. Substancat, materialet dhe përbërësit e tyre që vijojnë janë listuar për arsye të Nenit 9, paragrafi 4, të këtij Protokollit. Ato janë zgjedhur kryesisht mbi bazën e toksicitetit, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes biologjike:

1. Mërkuri dhe përbërësit e tij
2. Kadmiumi dhe përbërësit e tij
3. Përbërësat dhe substancat organike që mund të formojnë përbërësa në mjedisin detar<sup>1</sup>
4. Përbërësat dhe substancat organo-fosforike që mund të formojnë përbërësa të tillë në mjedisin detar<sup>1</sup>
5. Përbërësat dhe substancat organo-halogjene që mund të formojnë përbërësa të tillë në mjedisin detar<sup>1</sup>
6. Nafta e papërpunuar, si lëndë djegëse, dheu me naftë, nafta e përdorur për lubrifikime dhe prodhimet e rafinuara
7. Materialet sintetike të qëndrueshme që mund të notojnë, fundosen, ose mbeten pezull dhe që mund të ndërhyjnë në ndonjë përdorim të ligjshëm të detit
8. Substancat që mund të kenë veti kancerogjene, teratogjenike ose të ndryshueshme të vërejtur në mjedisin detar
9. Substancat radioaktive, duke përfshirë mbetjet e tyre, nëse shkarkimet e tyre nuk përputhen me parimet e mbrojtjes radioaktive siç përcaktohet nga organizatat ndërkombëtare kompetente, duke marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit detar

B. Aneksi në fjalë nuk aplikohet për shkarkimet që përmbajnë substancat e listuara në pikën A që janë nën limitet e përcaktuara nga Palët dhe në lidhje me naftën, nën limitet e përcaktuara në Nenin 10 të këtij Protokollit.

## ANEKSI II

### **SUBSTANCAT DHE MATERIALET E DËMSHME E TË RREZIKSHME ASGJËSIMI I TË CILAVE NË ZONËN E PROTOKOLLIT KRYHET ME LEJE TË VEÇANTË**

A. Substancat, materialet e përbërësat që vijojnë janë zgjedhur për qëllimin e Nenit 9, paragrafi 5, të këtij Protokollit

1. Arseniku
2. Plumbi
3. Bakri
4. Zinku
5. Beriliumi (element metalik toksik me ngjyrë të argjente)
6. Nikeli
7. Vanadiumi
8. Kromi
9. Biocidet dhe derivatet e tyre që nuk përfshihen në Aneksin I
10. Seleni
11. Antimoni
12. Molibdeni
13. Titaniumi

14. Kallaji
15. Bariumi (ndryshe nga sulfati i bariumit)
16. Bori
17. Uraniumi
18. Kobalti
19. Taliumi
20. Teluriumi
21. Argjendi
22. Cianidet

B. Kontrolli dhe limiti strikt i shkarkimit të substancave referuar në pikën A duhet të zbatohet në përputhje me Aneksin III.

### ANEKSI III

## FAKTORËT QË DUHEN MARRË PARASYSH PËR DHËNIEN E LEJES

Me qëllim dhënien e lejes sipas Nenit 9, paragrafi 7, vëmendje e veçantë duhet të kushtohet në faktorët që vijnë:

#### **A. Karakteristikat dhe përbërja e mbetjeve**

1. Tipi dhe përmasa e burimit të mbetjes (p.sh. procesi industrial);
2. Tipi i mbetjes (origjina, përbërja mesatare);
3. Forma e mbetjeve (e ngurtë, e lëngët, baltë, e gaztë);
4. Sasia totale (volumi i shkarkuar, p.sh. në vit);
5. Forma e shkarkimit (e vazhdueshme, e ndërprerë, e varijueshme sipas sezonit, etj.);
6. Përqëndrimet në lidhje me përbërësit kryesorë, substancat e listuara në Aneksin I, II dhe të tjera;
7. Karakteristikat fizike, kimike dhe biokimike të mbetjeve.

#### **B. Karakteristikat e përbërësive të mbetjeve sipas rrezikshmërisë së tyre**

1. Qëndrueshmëria (fizike, kimike, biologjike) në mjedisin detar;
2. Toksiciteti dhe efekte të tjera të rrezikshme;
3. Akumulimi në materialet biologjike ose sedimentet;
4. Transformimi biokimik nga ku rezultojnë përbërësa të rrezikshëm;
5. Efekte negative në përmbajtjen dhe bilancin e oksigjenit;
6. Ndjeshmëria ndaj ndryshimeve fizike, kimike, dhe biokimike dhe bashkëveprimi në mjedisin ujor me përbërësa të tjerë detarë që mund të krijojnë efekte biologjikisht të rrezikshme ose të tjera në ndonjë prej përdorimeve të listuara në pikën E më poshtë.

#### **C. Karakteristikat e vendit të shkarkimit dhe pranimit i mjedisit detar**

1. Karakteristikat hidrografike, meteorologjike, gjeologjike dhe topografike të zonës;
2. Vendndodhja dhe tipi i shkarkimit (grykëderdhje, kanal, vend-dalje, etj.) dhe lidhjet e tij me zonat e tjera (si p. sh. zonat e argëtimit, shumëzimit, rritjes dhe peshkimit, tabanet me molusqe) dhe shkarkime të tjera;
3. Dobësia fillestar arritur në pikën e shkarkimit në mjedisin detar të pranuar;
4. Karakteristikat shpërndarëse të tilla si efektet e rrjedhjeve, rrymat dhe era mbi transportin horizontal dhe përzierjet vertikale;
5. Pranimit i karakteristikave të ujit në përputhje me kushtet fizike, kimike, biologjike dhe ekologjike në zonën e shkarkimit;



6. Mundësia e pranimit të mjedisit detar për të pranuar shkarkime nga mbetjet pa krijuar efekte të padëshirueshme.

#### **D. Vlefshmëria e teknologjive të mbetjeve**

Metodat e reduktimit të mbetjeve dhe shkarkimit për derdhjet industriale si dhe për ujrat e zeza shtëpiake duhet të zgjidhen duke marrë parasysh mundësinë dhe vlefshmërinë e:

- (a) Proceseve alternative të trajtimit;
- (b) Metodat e ripërdorimit ose eliminimit;
- (c) Alternativat e asgjësimit në tokë;
- (d) Teknologjitë e përshtatshme për mbetjet e vogla.

#### **E. Dëmtimi potencial i ekosistemit detar dhe përdorimeve të ujit të detit**

1. Efektet mbi njerëzit nëpërmjet ndikimit ndotës mbi:
  - (a) Organizmat e ngrënshe detare;
  - (b) Ujrat e plazheve;
  - (c) Estetikën.
2. Efektet mbi ekosistemet detare, në veçanti burimeve të gjalla, specieve të rrezikuara dhe habitateve kritike.
3. Efektet mbi përdorimet e tjera të ligjshme të detit në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

## **ANEKSI IV**

### **VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS**

Çdo Palë duhet të kërkojë që vlerësimi i ndikimit në mjedis të përmbajë të paktën:

- (a) Një përshkrim të kufijve gjeografikë të zonës brenda të cilëve do të kryhet aktiviteti, përfshirë dhe zonat mbrojtëse aty ku është e mundur;
- (b) Një përshkrim të gjendjes së mjedisit të zonës,
- (c) Paraqitje të natyrës, qëllimeve, fushës së veprimit dhe kohëzgjatjes së aktiviteteve të propozuara;
- (d) Një përshkrim të metodave, instalimeve dhe mjeteve të tjera për tu përdorur, alternativat e mundshme për këto metoda dhe mjete;
- (e) Një përshkrim të efekteve të parashikuara direkte ose indirekte, afatshkurtër e afatgjatë të aktiviteteve të propozuara mbi mjedisin, duke përfshirë faunën, florën dhe ekuilibrin ekologjik;
- (f) Një deklaratë ku përshkruhen masat e propozuara për reduktimin në minimum të rrezikut të dëmit mbi mjedisin si rezultat i kryerjes së aktivitetit të propozuar, duke përfshirë alternativa të mundshme për këto masa;
- (g) Paraqitje e masave që do merren për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe efekte të tjera të kundërta gjatë dhe pas aktiviteteve të propozuara;
- (h) Përshkrim i metodologjisë së përdorur për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- (i) Njoftim nëse mjedisi i ndonjë Shteti tjetër mund të ndikohet nga aktiviteti i propozuar.

2. Çdo Palë duhet të nxjerrë standarte duke marrë parasysh standartet, rregullat dhe praktikat e procedurat e rekomanduara ndërkombëtare, miratuar në përputhje me Nenin 23 të Protokollit, prej ku vlerësimi i ndikimit në mjedis do të kryhet.

## ANEKSI V

### NAFTA DHE PERZIERJET E SAJ DHE SONDAT E MBETJET SHPUESE

Kushtet e mëposhtme duhet të përshkruhen nga Palët në përputhje me Nenin 10

#### **A. Nafta dhe Përzierjet e saj**

1. Rrjedhjet me përmbajtje të lartë naftë gjatë punës ose nga vetë platforma duhet të kufizohen, devijohen dhe me pas trajtohen si pjesë e prodhimit, por ato duhen trajtuar në një nivel të pranueshëm para shkarkimit, në përputhje me praktikat e nxjerrjes së naftës në tokë;

2. Mbetjet dhe baltrat me naftë rezultuar nga proceset ndarëse duhet të transportohen në breg;

3. Të gjitha masat paraprake do të merren për të minimizuar rrjedhjet e naftës në det prej naftës së mbledhur ose ndezur nga burimet e njohura;

4. Të gjitha masat paraprake duhet të merren për të siguruar që gazrat e rezultuar nga aktiviteti i naftës duhet të digjen ose përdoren në mënyrë të përshtatshme.

#### **B. Mbetjet nga shpimet**

1. Mbetjet nga shpimet do të jenë objekt i kërkesave të mëposhtme:

(a) Përdorimi dhe asgjësimi i lëngjeve shpuese do të jenë objekt i Planit të Përdorimit të Kimikateve dhe kërkesave të Nenit 9 të këtij Protokollit;

(b) Asgjësimi i shpimeve do të bëhet ose në tokë ose në det në një vend ose zonë të përshtatshme që caktohet nga autoriteti kompetent.

2. Mbetjet shpuese me naftë do të jenë objekt i kërkesave të mëposhtme:

(a) Këto lëngje shpuese do të përdoren vetëm në rast se kanë toksicitet të ulët dhe vetëm pasi subjektit i është dhënë një leje nga autoriteti kompetent kur ai ka verifikuar këtë nivel toksiciteti;

(b) Asgjësimi në det i lëndëve të tilla është i ndaluar;

(c) Asgjësimi i lëngjeve shpuese në det do të lejohet vetëm me kusht që një pajisje efikase kontrolli për materialet e ngurta të jetë instaluar dhe vepron përshtatshëm, në mënyrë që pika e shkarkimit të jetë nën sipërfaqen e ujit dhe që përmbajtja e naftës është më pak se 100 gram naftë për kilogram mbetje shpimi të thatë;

(d) Asgjësimi i mbetjeve të tilla shpuese në zonat veçanërisht të mbrojtura është i ndaluar;

(e) Në rastet e shpimeve, duhet të ndërmerret një program për marrjen e mostrave dhe analizën e shtratit të detit në zonën e ndotur.

3. Mbetjet shpuese me diesel:

Përdorimi i këtyre lëndëve shpuese është i ndaluar. Nafta diesel mundet që në raste të veçanta t'i shtohet lëndëve të tjera shpuese në rrethana që përcaktohen nga palët.

## ANEKSI VI

### MASAT MBROJTËSE

Kushtet që vijojnë duhet të përshkruhen nga Palët në përputhje me Nenin 15:

(a) Instalimi duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin që do të përdoret, dhe të jetë skicuar e ndërtuar që të qëndrojë, me ngarkim të plotë, t'i rezistojë kushteve natyrore, duke përfshirë erërat dhe dallgët e forta sipas të dhënave historike të kohës, tërmeteve të mundshëm, kushteve e stabilitetit të shtratit të detit dhe thellësisë së ujit;

(b) Të gjitha fazat e aktiviteteve, duke përfshirë ruajtjen dhe transportin e burimeve të rimbuleshme, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që, i tërë aktiviteti të mund të kontrollohet për arsye sigurie dhe të kryhet në mënyrë sa më të sigurt, dhe subjekti duhet të zbatojë një sistem monitorimi për të gjitha aktivitetet;

(c) Sistemet më të avancuara të sigurisë duhet të përdoren dhe periodikisht të kontrollohen me qëllim minimizimin e rrezikut të rrjedhjeve, derdhjeve, shkaktimeve aksidentale, zjarrit, eksplozionit, shpërthimeve ose ndonjë rreziku tjetër mbi njerëzit ose mjedisin, që një ekip i specializuar që operon dhe mirëmban këto sisteme duhet të jetë prezent dhe që ky ekip të ndërmarrë detyra periodike. Në rastin e instalimeve të lejuara jo të përhershme, duhet të sigurohet ekzistenca e përhershme e një ekipi të specializuar;

(d) Instalimi dhe aty ku është e nevojshme, zona e sigurisë e caktuar, duhet të shënohet në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare për të bërë të ditur rrezikun e prezencës së tij dhe të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e tij;

(e) Në përputhje me praktikat detare ndërkombëtare, instalimet duhet të vendosen në hartat detare dhe bëhet njoftimi atyre që lidhen me këtë;

(f) Me qëllim sigurimin e vëzhgimit të kushteve të mësipërme, personi dhe/ose personat që kanë përgjegjësi për instalimin dhe/ose aktivitetet, duke përfshirë dhe personin përgjegjës për parandalimin e shpërthimeve, duhet të kenë kualifikimet e kërkuara nga autoriteti kompetent, dhe një personel i mjaftueshëm i kualifikuar duhet të jetë i përhershëm. Kualifikim duhet të përfshijë, në veçanti, treiminin e vazhdueshëm lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

## ANEKSI VII

### PLANI REZERVË

#### **A. Plani rezervë i subjektit**

1. Subjektet janë të detyruar të sigurojnë që:

(a) Sistemet e alarmit dhe komunikimit më të përshtatshme ekzistojnë në instalim dhe janë në gjendje të mirë pune;

(b) Alarmi të jepet menjëherë në rastin e një emergjence dhe që ky rast t'i komunikohet menjëherë autoritetit kompetent,

(c) Në bashkëpunim me autoritetin kompetent, transmetimi i alarmit dhe asistenca e koordinimi i saj mund të organizohen dhe vëzhgohen pa vonesë;

(d) Informacion i menjëhershëm rreth natyrës dhe zgjatjes së emergjencës i është dhënë ekipit të instalimit dhe autoritetit kompetent;

(e) Autoriteti kompetent informohet në mënyrë të vazhdueshme rreth ecurisë së asgjësimit të rastit emergjent,

(f) Gjatë gjithë kohës materiale dhe pajisje të mjaftueshme, duke përfshirë vendqëndrimet e anijeve dhe avionëve, janë në gatishmëri për të zbatuar planin e emergjencës;

(g) Metodot dhe teknikat me të përshtatshme i bëhen të njohura ekipit të specializuar sipas Aneksit VI, paragrafi (c), me qëllim luftimin e rrjedhjeve, derdhjeve, shkarkimeve aksidentale, zjarrit, eksplozionit, shpërthimeve dhe ndonjë rreziku tjetër për njerëzit ose mjedisin;

(h) Metodot dhe teknikat me të përshtatshme i bëhen të njohura ekipit të specializuar përgjegjës për reduktimin dhe parandalimin e efekteve të kundërta afatgjata mbi mjedisin;

(i) Ekipi njihet tërësisht planin e masave paraprake të subjektit, dhe praktikot për rastet emergjente kryhen periodikisht në mënyrë që ekipi të këtë njohuri pune për pajisjet dhe procedurat dhe që çdo person njihet detyren e tij brenda planit.

2. Subjekti duhet të bashkëpunojë, mbi bazë institucionale, me subjektet e tjera që janë në gjendje të japin asistencën e nevojshme, në mënyrë që në rastet kur shkalla ose natyra e një emergjence krijon rrezik për të cilin asistencë kërkohet ose duhet kërkuar, kjo asistencë mund të jepet.

## **B. Koordinimi dhe drejtimi kombëtar**

Autoriteti kompetent për rastet e emergjencave të Palëve duhet të sigurojë:

(a) Koordinimin e planit dhe/ose procedurave kombëtare për masat paraprake dhe planin e masave paraprake të subjektit dhe kontrollin e kryerjes së veprimeve, veçanërisht në rastin e efekteve të kundërta të dukshme të emergjencës;

(b) Udhëzimin e subjektit për të ndërmarë veprime për parandalimin, zvogëlimin ose luftimin e ndotjes ose përgatitjen e veprimeve të mëtejshme për këtë qëllim, duke përfshirë vendosjen e rregullit për pajisjet shpuese lehtësuese, ose për të parandaluar subjektin në marrjen e ndonjë veprimi specifik;

(c) Koordinimin e veprimeve me qëllim parandalimin, zvogëlimin ose luftimin e ndotjes ose përgatitjen për veprim të mëtejshëm për këtë qëllim brenda territorit kombëtar me veprime të ndërmarra brenda juridiksionit të Shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare;

(d) Grumbullimin dhe vlefshmërinë e të gjithë informacionit lidhur me aktivitetet egzistuese;

(e) Përgatitjen e një liste aktuale të personave dhe subjekteve që do të njoftohen dhe informohen rreth emergjencës, zhvillimin e saj dhe masave të marra;

(f) Grumbullimin e të gjithë informacionit të nevojshëm lidhur me zgjatjen dhe mjetet e luftimit të problemeve të paparashikuara, dhe shpërndarjen e këtij informacioni tek Palët e interesuara;

(g) Koordinimin dhe vëzhgimin e asistencës sipas pjesës A më sipër, në bashkëpunim me subjektin;

(h) Organizimin dhe nëse është e nevojshme, koordinimin e veprimeve specifike duke përfshirë ndërhyrjen me ekspertë teknikë dhe personel të trajnuar me pajisje e materiale të nevojshme;

(i) Komunikimin e menjëhershëm të autoriteteve kompetente me Palët që mund të ndikohet prej një paparashikimi për t'i dhënë atyre mundësinë për të marrë masat përkatëse aty ku është e nevojshme;

(j) Parashikimin e asistencës teknike për Palët e tjera, nëse është e nevojshme;

(k) Komunikimin e menjëhershëm me organizmat ndërkombëtare kompetente me qëllim shmangien e rrezikut për lundrimin dhe aktivitete të tjera.

## **SHTOJCË**

### **LISTA E LLOJEVE TË NAFTËS**

#### **Tretësirat e asfaltit**

- Përbërësit e përzier
- Rrjedhjet nga sipër
- Mbetjet e rrjedhshme të paholluara

#### **Naftat**

- E pastër
- Nafta e papërpunuar
- Përzierjet që përmbajnë naftë të papërpunuar
- Nafta diesel
- Nafta lëndë djegëse No. 4
- Nafta lëndë djegëse No. 5
- Nafta lëndë djegëse No. 6
- Nafta lëndë djegëse e mbetur
- Nafta për rrugët
- Nafta e transformatorëve
- Nafta aromatike (duke përjashtuar naftën bimore)
- Naftat lubrifikuese dhe përbërësit e përzier
- Nafta si mineral
- Nafta e motorrëve
- Nafta e përshkueshme
- Nafta e boshteve
- Nafta e turbinave

#### **Holluesit**

- Rrjedhjet e paholluara
- Përbërësit ushqyes që marrin flakë

#### **Nafta gaz**

#### **E plasaritur**

#### **Lëndët Djegëse Reaktive (LDR)**

- LDR-1 (Vajguri)
- LDR-3
- LDR-4
- LDR-5 (Vajguri, Lëndët e patretshme)
- Lënda Djegëse Turbo
- Vajguri
- Alkooli Mineral

#### **Nafta**

- Tretësat
- Nafta
- Nafta e Distiluar

Përbërësit e përzier të gazolinës  
Bazike - lëndë djegëse  
Acide  
Të përbëra - lëndë djegëse

#### **Gazolinat**

Mbi mbulesat (natyrore)  
Makinat  
Aviacioni  
Rrjedhjet e paholluara  
Nafta lëndë djegëse No. 1 (Vajguri)  
Nafta lëndë djegëse No. 1 -D  
Nafta lëndë djegëse No. 2  
Nafta lëndë djegëse No. 2 -D

*1 Me përjashtim të atyre që janë biologjikisht të rrezikshme ose që shndërrohen shpejt në substancë biologjikisht të rrezikshme*

# **PROKOLLI MBI PARANDALIMIN E NDOTJES SË DETIT MESDHE NGA LËVIZJET NËRKUFITARE TË MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE ASGJËSIMIN E TYRE<sup>1</sup>**

Palët kontraktuese të këtij protokolli,

Duke qenë palë të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe ndaj Ndotjes, e miratuar në Barcelonë më 16 Shkurt 1976 dhe e përmirësuar me 10 Qershor 1995,

Të ndërgjegjshëm për rrezikun që kërcënon mjedisin e Detit Mesdhe i shkaktuar nga lëvizjet ndërkuftare dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme,

Të bindur se rruga më efikase e mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit detar nga rreziqet që paraqesin mbetjet e rrezikshme është paksimi dhe eliminimi i prodhimit të tyre, për shembull nëpërmjet zëvendësimit dhe metodave të tjera të prodhimit të pastër,

Duke njohur dëshirën në rritje për ndalimin e lëvizjeve ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin në shtetet e tjera, veçanërisht në vendet në zhvillim,

Duke patur parasysh Deklaratën e Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin dhe veçanërisht parimin 14, i cili thotë se shtetet “duhet të bashkëpunojnë efektivisht për të frenuar ose parandaluar zhvendosjen dhe kalimin në shtete të tjera të çdo lloj aktiviteti ose substancës që shkaktojnë dëmtim të rëndë të mjedisit ose që njihen se janë të dëmshme për shëndetin e njeriut”,

Duke qenë në dijeni për shqetësimin ndërkombëtar në rritje lidhur me nevojën për t’u siguruar se ndotja e krijuar në një shtet të mos kalojë në një shtet tjetër dhe këmbëngulës në këtë objektiv, të nevojës për të pakësuar lëvizjet ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme në një minimum sa të jetë e mundur, me një qëllim final të ndalimit të këtyre lëvizjeve,

Duke njohur gjithashtu se çdo shtet ka të drejtën sovrane për të ndaluar hyrjen, kalimin ose asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme në territorin e tyre,

Duke patur parasysh klauzolat përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit të vitit 1982,

Duke patur parasysh gjithashtu Konventën e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre, e miratuar më 22 Mars 1989, dhe veçanërisht Nenin 11, dhe vendimet I/22, II/12 dhe II/I të miratuara respektivisht nga Mbledhjet e Parë, e Dytë dhe e Tretë e Konferencës së Palëve të Konventës së Bazelit,

Aq më tepër duke patur parasysh se shumë shtete, ndërmjet tyre palë kontraktuese të Konventës së Barcelonës, kanë marrë masa dhe kanë hyrë në marrëveshje ndërkombëtare të ngjashme me Konventën e Bazelit për të ndaluar lëvizjet ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme, për shembull, Konventa e IV-t ACP/EEC e firmosur në Londër më 15 Dhjetor 1989 nga Bashkimi Ekonomik Europian dhe Shtetet Afrikanë, Karaibet dhe Grupi i Paqësorit, si dhe Konventa e Bamakos mbi Ndalimin e Importit në Afrikë dhe Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare dhe Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme brenda Afrikës, e miratuar nën kujdesin e Organizatës së Bashkimit Afrikan me 30 Janar 1991,

Aq më tepër duke njohur ndryshimet në nivelet e zhvillimit ekonomik dhe ligjor ndërmjet shteteve të ndryshme Mesdhetare, dhe duke pranuar që mbetjet e rrezikshme nuk duhet të lejohen të transportohen duke përfituar nga këto pabarazi ekonomike dhe ligjore për të dëmtuar mjedisin dhe mirëqënien sociale të vendeve në zhvillim,

Duke patur parasysh gjithashtu faktin që rruga me efikase e zgjidhjes së kërcënimeve të shkaktuara nga mbetjet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin qëndron në pakësimin ose bile në ndalimin e transferimit të aktiviteteve që krijojnë mbetje të rrezikshme,

Kanë miratuar si më poshtë:

## **Neni 1**

### **Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij protokollit:

(a) “Konventë” nënkupton Konventën për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja, e niratuar në Barcelonë më 16 shkurt 1976 dhe e përmirësuar më 10 Qershor 1995;

(b) “Palë” nënkupton një palë kontraktuese të këtij protokollit në përputhje me nenin 29, paragrafi 1 të konventës;

(c) “Mbetjet” nënkupton substancat ose objektet që asgjësohen ose destinohen të asgjësohen ose që kërkohen të asgjësohen sikurse parashikon legjisllacioni kombëtar;

(d) “Mbetje të rrezikshme” nënkupton mbetjet ose kategoritë e substancave të përcaktuara në nenin 3 të këtij protokollit;

(e) “Asgjësim” nënkupton çdo operacion të përcaktuar në shtojcën III të këtij protokollit:

(f) “Lëvizje ndërkufitare” nënkupton çdo lëvizje të mbetjeve të rrezikshme, ose mbetjeve të tjera, nga një zonë nën juridiksionin kombëtar të një shteti për ose nëpër një zonë nën juridiksionin kombëtar të një shteti tjetër, drejt ose nëpër një zonë që nuk është nën juridiksionin kombëtar të ndonjë shteti, me kusht që të paktën dy shtete të përfshihen në lëvizjen,

(g) “Vendi ose pajisja e aprovuar” nënkupton një vend ose pajisje për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, i cili është i autorizuar ose lejohet të përdoret për këtë qëllim nga autoriteti përkatës i shtetit ku ndodhet vendi ose pajisja.

(h) “Autoritet kompetent” nënkupton çdo autoritet qeveritar i zgjedhur nga një palë për të qenë përgjegjës, brenda zonave të tilla gjeografike që pala i mendon të përshtatshme për marrjen e njoftimit të një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme, ose mbetjeve të tjera dhe për çdo informacion që ka lidhje me të dhe për përgjigjen ndaj këtij njoftimi;

(i) “Metodat e prodhimit të pastër” nënkuptojnë ato metoda që paksojnë ose evitojnë krijimin e mbetjeve të rrezikshme në përputhje me Nenet 5 dhe 8 të këtij protokollit;

(j) “Administrim i përshtatshëm nga ana mjedisore” i mbetjeve të rrezikshme, nënkupton marrjen e të gjitha hapave praktikë për t’u siguruar që mbetjet e rrezikshme janë grumbulluar, transportuar dhe asgjësuar (përfshirë dhe kujdesin e mëtejshëm të vendeve të depozitimit) në mënyrë të tillë që do të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin ndaj efekteve të dëmshme që mund të vijnë nga këto mbetje;

(k) “Zonë nën juridiksionin kombëtar të një shteti” nënkupton çdo sipërfaqe tokësore, detare ose hapsirë ajrore brenda së cilës një shtet ushtron përgjegjësinë administrative dhe rregullatore në përputhje me ligjin ndërkombëtar, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit;

(l) “Shteti i eksportit” nënkupton një palë, prej së cilës është planifikuar të fillojë ose fillohet një lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme;



(m) “Shteti i importit” nënkupton një palë, prej së cilës është planifikuar ose ndodh një lëvizje ndërkuftare e mbetjeve të rrezikshme për qëllim asgjësimin e tyre ose për qëllim shkarkimi para asgjësimit në një zonë që nuk është nën juridiksionin kombëtar të ndonjë shteti;

(n) “Shteti tranzit” nënkupton çdo shtet, përveç atij të eksportit dhe importit, nëpërmjet të cilit planifikohet ose ndodh një lëvizje e mbetjeve të rrezikshme;

(o) “Eksportues” nënkupton çdo person nën juridiksionin e shtetit të eksportit, i cili bën përgatitjet për eksportimin e mbetjeve të rrezikshme,

(p) “Importues” nënkupton çdo person nën juridiksionin e shtetit të importit, i cili bën përgatitjet për importimin e mbetjeve të rrezikshme;

(q) “Prodhues” nënkupton çdo person aktiviteti i të cilit prodhon mbetje të rrezikshme ose, në qoftë se ky person nuk është i njohur, personi që i zotëron dhe/ose i ka nën kontroll këto mbetje,

(r) “Asgjësim” nënkupton çdo person drejt të cilit transportohen mbetjet e rrezikshme dhe i cili kryen asgjësimin e këtyre mbetjeve;

(s) “Trafik ilegal” nënkupton çdo lëvizje ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme siç përcaktohet në nenin 9;

(t) “Person” nënkupton çdo person fizik ose juridik;

(u) “Vende në zhvillim” nënkupton ato vende që nuk janë shtete anëtare të Organizatës për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (OECD), (1)

(v) “Vende të zhvilluara” nënkupton ato vende që janë shtete anëtare të Organizatës për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (OECD)<sup>2</sup>; (1)

(z) “Organizatë” nënkupton organizmin e përcaktuar në Nenin 2 (b) të Konventës.

## **Neni 2**

### **Zona e protokollit**

1. Ky protokoll do të zbatohet për:

(a) Mbetjet që i përkasin çdo kategorie në nenin 1 të këtij protokollit;

(b) Mbetjeve që nuk janë përfshirë në paragrafin (a) të mësipërm, por janë përcaktuar si, ose janë konsideruar të jenë, mbetje të rrezikshme nga legjislacioni vendas i shtetit të eksportit, importit ose tranzit;

(c) Mbetjet që kanë ndonjë karakteristikë që përmbahet në shtojcën 11 të këtij protokollit;

(d) Substancat e rrezikshme që janë ndaluar ose janë të skaduara, ose ato të cilave i është anuluar ose refuzuar regjistrimi nga veprimet rregullatore të qeverisë në vendin e prodhimit ose të eksportit, për arsye të shëndetit të njeriut ose mjedisit, ose kanë qenë hequr vullnetarisht nga regjistrimi qeveritar të kërkuara për përdorim në vendin e prodhimit ose të eksportit.

2. Mbetjet që rezultojnë nga operacionet normale të anijeve, shkarkimi i të cilave mbulohet nga një instrument tjetër ndërkombëtar, janë të përjashtuara nga qëllimi i këtij protokollit.

3. Prodhuesi, eksportuesi ose importuesi, në vartësi të rrethanave, duhet të kenë parasysh përgjegjësinë për të kontrolluar me autoritetet kompetente të shtetit të eksportit, importit ose të tranzitit, para lëvizjes ndërkuftare të saj, në se një mbetje e caktuar nuk është subjekt i këtij protokollit.

## **Neni 4**

### **Përkufizimet kombëtare të mbetjeve të rrezikshme**

1. Çdo palë e konventës duhet, brenda 6 muajve të bërjes palë, të informojë Organizatën për mbetjet, përveç atyre të dhëna në listën e shtojcës 1 të këtij protokollit, të konsideruara ose të përcaktuara si të rrezikshme sipas legjislacionit të vet kombëtar, dhe për çdo kërkesë në lidhje me procedurat e lëvizjes ndërkufitare të zbatueshme për mbetje të tilla.

2. Çdo palë duhet të informojë vazhdimisht Organizatën për çdo ndryshim të rëndësishëm në lidhje me informacionin që ka qenë dërguar në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Organizata duhet të informojë të gjitha palët për informacionin që është marrë në bazë të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Palët duhet të jenë përgjegjëse për të vënë në dispozicion të eksportuesve informacionin e dërguar për të nga Organizata në bazë të paragrafit 3 të këtij neni.

## **Neni 5**

### **Detyrimet e përgjithshme**

1. Palët duhet të marrin tërë masat e duhura për të ndaluar, pakësuar dhe eliminuar ndotjen e zonës së protokollit, e cila mund të shkaktohet nga lëvizjet ndërkufitare dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme.

2. Palët duhet të marrin tërë masat e duhura për të pakësuar në minimum dhe ku është e mundur, të eliminojnë prodhimin e mbetjeve të rrezikshme.

3. Palët duhet gjithashtu të marrin tërë masat e duhura për të pakësuar në minimum lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe në se është e mundur të eliminojnë këtë lëvizje në Mesdhe. Për të arritur këtë qëllim, palët kanë të drejtën të ndalojnë individualisht ose kolektivisht importin e mbetjeve të rrezikshme. Palët e tjera duhet të respektojnë këtë vendim sovran dhe nuk duhet të lejojnë eksportin e mbetjeve të rrezikshme drejt shteteve që kanë ndaluar importin e tyre.

4. Për shkak të klauzolave të veçanta që kanë të bëjnë me lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme nëpërmjet teritorit detar të një shteti tranzit, sipas nenit 6.4 të këtij protokollit, tërë palët duhet të marrin masat e duhura ligjore, administrative dhe të tjera brenda zonës nën juridiksionin e tyre për të ndaluar eksportin dhe tranzitimin e mbetjeve të rrezikshme për në vendet në zhvillim, dhe palët që nuk janë shtete anëtare të Bashkimit Europian (1) duhet të ndalojnë tërë importet dhe tranzitimet e mbetjeve të rrezikshme.

5. Palët duhet të bashkëpunojnë me agjensitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale me qëllim që të parandalojnë trafikun ilegal dhe duhet të marrin masat e duhura për të arritur këtë qëllim, përfshirë masat e ndëshkimit kriminal në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

## **Neni 6**

### **Lëvizja ndërkufitare dhe procedurat e njoftimit**

Në raste të jashtëzakonshme, kur nuk është e ndaluar me ndonjë mënyrë tjetër, kur mbetjet e rrezikshme nuk mund të asgjësohen në një mënyrë të përshtatshme mjedisore në një vend ku ato janë prodhuar, lëvizjet ndërkufitare të këtyre mbetjeve mund të lejohen në qoftë se:

1. Është marrë parasysh situata e veçantë e vendeve Mesdhetare në zhvillim, të cilat nuk kanë as aftësitë teknike as edhe pajisjet asgjësuese për një administrim të përshtatshëm mjedisor të mbetjeve të rrezikshme.

2. Autoriteti kompetent i shtetit të importit siguron që mbetja e rrezikshme është depozituar/asgjësuar në një vend ose pajisje të miratuar me aftësitë teknike për depozitim/asgjësimin e përshtatshëm mjedisor.

3. Lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme bëhet me njoftim paraprak me shkrim të shtetit të eksportit siç përcaktohet në shtojcën IV të këtij protokollit, dhe pëlqim paraprak me shkrim të shtetit/ëve të

importit dhe të shtetit/eve të tranzitit. Ky paragraf nuk zbatohet në kushtet e kalimit nëpërmjet territorit detar, të cilat janë të dhëna në paragrafin 4 të këtij neni.

4. Lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme nëpërmjet territorit detar të një shteti tranzit bëhet vetëm me njoftimin paraprak nga shteti i eksportit të shtetit të tranzitimit, siç përcaktohet në shtojcën IV të këtij protokollit. Pas marrjes së njoftimit, shteti tranzit i bën të njohur shtetit të eksportit tërë detyrimet lidhur me kalimin nëpërmjet territorit të detit në zbatim të ligjit ndërkombëtar dhe klauzolave përkatëse të legjislacionit të vendit të vet, i miratuar në përputhje me ligjin ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit detar. Kur është e nevojshme, shteti tranzit mund të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Kjo procedurë duhet të përfundojë brenda afateve të dhëna nga Konventa e Bazelit.

5. Çdo shtet i angazhuar në lëvizje ndërkufitare sigurohet që kjo lëvizje është në përputhje me standartet ndërkombëtare të sigurisë dhe garancisë financiare dhe veçanërisht me procedurat dhe standartet e vendosura në Konventën e Bazelit.

## **Neni 7**

### **Detyrimi i riimportimit**

Shteti i eksportit duhet të ri-importojë mbetjet e rrezikshme, në qoftë se lëvizja ndërkufitare nuk mund të përfundojë për arsye të pamundësisë së realizimit të kontratave lidhur me lëvizjen dhe depozitimin/asgjësimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, çdo shtet tranzitimi nuk duhet të kundërshtojë, vonojë ose ndalojë kthimin e këtyre mbetjeve për në shtetin e eksportit, pasi të jenë informuar ashtu siç duhet nga shteti i eksportit.

## **Neni 8**

### **Bashkimi rajonal**

1. Në përputhje me nenin 13 të konventës, palët duhet të bashkëpunojnë sa më shumë që të jetë e mundur në fushat shkencore dhe teknologjike që lidhen me ndotjen nga mbetjet e rrezikshme, veçanërisht në zbatimin dhe zhvillimin e metodave të reja për pakësimin dhe eliminimin e mbetjeve të rrezikshme të prodhuara nëpërmjet metodave të prodhimit të pastër.

2. Për këtë qëllim, palët duhet të dorëzojnë raporte vjetore në Organizatë, lidhur me mbetjet e rrezikshme që ato prodhojnë dhe transferojnë brenda zonës së protokollit, me qëllim që t'i japin mundësi Organizatës të përgatisë një inventar të mbetjeve të rrezikshme.

3. Palët duhet të bashkëpunojnë në marrjen e masave për të zbatuar arritjet pozitive të bazuara në parandalimin e problemeve të ndotjes që rezultojnë nga mbetjet e rrezikshme, lëvizja ndërkufitare si dhe depozitimi apo asgjësimi i tyre.

## **Neni 9**

### **Trafiku ilegal**

1. Për qëllime të këtij protokollit, çdo lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me këtë protokoll ose me rregullat e tjera të ligjit ndërkombëtar, do të konsiderohet si trafik ilegal.

2. Secila palë duhet të plotësojë legjislacionin kombëtar të nevojshëm për të parandaluar dhe dënuar trafikun ilegal, përfshirë dënimet kriminale të tërë personave të angazhuar në të tilla aktivitete ilegale.

3. Në rastin e një trafiku ilegal, i kryer nga prodhuesi ose eksportuesi, shteti i eksportit duhet të sigurohet që mbetjet në fjalë janë marrë përsëri nga eksportuesi ose prodhuesi ose, në qoftë se është e nevojshme, nga vetvetja, në shtetin e eksportit brenda 30 ditëve nga koha kur trafiku ilegal është konstatuar dhe se janë marrë masat ligjore përkatëse ndaj kundravajtësit/ve.

4. Në rastin e një trafiku ilegal, të kryer nga importuesi ose asgjësuesi/depozituesi, shteti i importit duhet të sigurohet që mbetjet në fjalë janë asgjësuar me metoda të përshtatshme nga ana mjedisore nga

importuesi brenda 30 ditëve nga koha kur trafiku ilegal është konstatuar nga shteti i importit. Në qoftë se nuk është e mundur, shteti i importit duhet të sigurohet që mbetjet janë marrë përsëri nga eksportuesi ose prodhuesi ose, në qoftë se është e nevojshme, nga vetja, në shtetin e eksportit. Autoritetet kompetente të shteteve të importit ose të eksportit duhet të sigurohen se janë filluar procedurat ligjore ndaj kundravajtësit në përputhje me këtë protokoll.

5. Në rastet kur përgjegjësia për trafikun ilegal nuk mund të përcaktohet as nga eksportuesi ose prodhuesi, e as nga importuesi ose asgjësuesi, palët e interesuara ose palët e tjera, në mënyrë të përshtatshme, do të sigurojnë përmes bashkëpunimit, që mbetjet në fjalë të asgjësohen sa më shpejt që të jetë e mundur në një mënyrë të përshtatshme mjedisore, në shtetin e eksportit, në shtetin e importit ose kudo tjetër që të jetë e përshtatshme.

6. Palët duhet të dërgojnë, sa më shpejt që të jetë e mundur, tërë informacionin përkatës për trafikun ilegal në Organizatë, e cila do ta shpërndajë këtë informacion për të gjitha palët kontraktuese.

7. Palët duhet të bashkëpunojnë për të siguruar që të mos ndodhë trafiku ilegal. Sipas kërkesës, Organizata do të ndihmojë palët në identifikimin nga ana e tyre të rasteve të trafikut ilegal dhe do të qarkullojë menjëherë për tek palët e interesuara çdo informacion që ka marrë lidhur me trafikun ilegal.

8. Organizata do të ndërmarrë koordinimin e nevojshëm me Sekretariatën e Konventës së Bazelit, lidhur me parandalimin dhe monitorimin efektiv të trafikut ilegal të mbetjeve të rrezikshme. Ky koordinim duhet të bazohet kryesisht në:

(a) Shkëmbimin e informacionit mbi rastet ose ato që supozohen raste të trafikut ilegal në Mesdhe dhe në koordinimin e veprimeve për të zgjidhur raste të tilla,

(b) Sigurimin e asistencës në fushën e ndërtimit të kapaciteteve, përfshirë përmirësimin e legjislacionit kombëtar dhe të strukturave përkatëse në shtetet e Mesdheut me qëllim parandalimin dhe dënimin e trafikut ilegal të mbetjeve të rrezikshme;

(c) Ngritjen e një mekanizmi për të parandaluar dhe monitoruar trafikun ilegal të mbetjeve të rrezikshme në Mesdhe.

## **Neni 10**

### **Asistenca për vendet**

Palët duhet, direkt ose me asistencën e organizatave kompetente, organizatave të tjera ndërkombëtare ose nëpërmjet komunikimit dypalësh, të bashkëpunojnë me qëllim që të formulojnë dhe zbatojnë programet e asistencës financiare dhe teknike për vendet në zhvillim për zbatimin e këtij protokollit.

## **Neni 11**

### **Transmetimi i informacionit**

Palët duhet të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet Organizatës për masat e marra, rezultatet e arritura dhe nëse lind nevoja, për vështirësitë e ndeshura në zbatimin e këtij protokollit. Procedurat për grumbullimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni do të përcaktohet në mbledhjet e palëve.

## **Neni 12**

### **Informacioni për publikun dhe pjesëmarrja e tij**

1. Në rastet e jashtëzakonshme, në të cilat lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme është lejuar, bazuar në nenin 6 të këtij protokollit, palët duhet të sigurohen që është vënë në dispozicion për publikun i tërë informacioni i duhur, i transmetuar nëpërmjet rrugëve të gjykuara të përshtatshme nga palët.

2. Shteti i eksportit dhe shteti i importit duhet, në përputhje me klauzolat e këtij protokollit dhe kur është e mundur dhe e përshtatshme, t'i japin publikut mundësi për të marrë pjesë në procedurat përkatëse me qëllim që të bëhen të njohura mendimet dhe shqetësimet e tij.

## **Neni 13**

## **Verifikimi**

1. Çdo palë, e cila ka arsye të besojë se ndonjë palë tjetër po kryen ose ka kryer shkelje të detyrimeve të tij ndaj këtij protokollit, informon Organizatën dhe në rast të tillë, në të njëjtën kohë dhe menjëherë informon, direkt ose nëpërmjet Organizatës, palën kundrejt së cilës është bërë akuza.

2. Organizata duhet të kryejë një verifikim të përmbajtjes së akuzës nëpër-mjet konsultimit me palët e interesuara dhe paraqet një raport mbi këtë gjë për palët,

## **Neni 14**

### **Përgjegjësia dhe kompensimi**

Palët duhet të bashkëpunojnë me qëllim që të vendosin, sa më shpejt që të jetë e mundur, udhëzuesit përkatës për vlerësimin e dëmit, si edhe rregullat dhe procedurat në fushën e përgjegjësisë dhe kompensimit për dëmin që shkaktohet nga lëvizja ndërkuftare dhe depozitimi/asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme.

## **Neni 15**

### **Mbledhjet**

1. Mbledhjet e zakonshme të palëve do të bëhen së bashku me mbledhjet e zakonshme të palëve kontraktuese të konventës mbajtur sipas nenit 18 të konventës. Palët e këtij protokollit mund të mbajnë gjithashtu mbledhje të jashtëzakonshme në përputhje me nenin 18 të konventës.

2. Funksionet e mbledhjeve të palëve do të jenë :

(a) Për të mbajtur nën shqyrtim zbatimin e këtij protokollit dhe për të marrë në konsideratë çdo masë shtesë, përfshirë dhe ato në formën e shtojcave;

(b) Të shqyrtojë dhe të përmirësojë këtë protokoll dhe çdo shtojcë, si të duket e përshtatshme;

(c) Të përgatisë dhe të miratojë programet, metodat dhe masat në përputhje me nenet përkatëse të këtij protokollit,

(d) Të shqyrtojë çdo informacion të paraqitur nga palët në Organizatë ose në mbledhjet e palëve, në përputhje me nenet përkatëse të këtij protokollit.

## **Neni 16**

### **Miratimi i programeve dhe masave shtesë**

Mbledhja e palëve do të miratojë me dy të tretat e shumicës çdo program dhe masë shtesë për parandalimin dhe eliminimin e ndotjes nga lëvizjet ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre.

## **Neni 17**

### **Dispozita finale**

1. Dispozitat e konventës për çdo protokoll do të zbatohen edhe për këtë protokoll.

2. Rregullat e procedurave dhe rregullat financiare të miratuara në përputhje me nenin 24 të konventës do të zbatohen në lidhje me këtë protokoll, në qoftë se palët e këtij protokollit nuk bien dakord ndryshe.

3. Ky protokoll do të jetë i hapur për firmë në Izmir më 1 Tetor 1996 dhe në Madrid nga 2 Tetori 1996 deri në 1 Tetor 1997 nga çdo shtet palë në këtë konventë. Do të jetë gjithashtu i hapur në të njëjtat ditë për firmë nga Komuniteti Evropian ose nga ndonjë grupim ekonomik rajonal i ngjashëm nga të cilët të paktën një anëtar është shtet bregdetar i zonës së protokollit dhe ushtron kompetenca në fushat e mbuluara nga ky protokoll.

4. Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentat e ratifikimit, miratimit ose pranimit do të depozitohen në Qeverinë e Spanjës, që do të luajë rolin e sekretarit.

5. Nga 2 Tetor 1997, ky protokoll do të jetë i hapur për firmë nga shtetet e përmendura në paragrafin 3 sipër, nga Komuniteti Evropian dhe çdo grupim i referuar në atë paragraf.

6. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të 6 (gjashtë) instrumentave të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit të prokollit të përmendura në nenin 3 të këtij neni.

Ky protokoll është firmosur në prani të nënshkruesve të autorizuar nga Qeveritë e tyre për këtë qëllim.

Bërë në Izmir më 1 Tetor 1996 në një kopje në arabisht, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, ndërkohë që tekstet në të katër gjuhët janë ekuivalente.

## ANEKSI I

### KATEGORITË E MBETJEVE SUBJEKT I KËTIJ PROTOKOLLI

#### A. MBETJET E RREZIKSHME

YO Të gjithë mbetjet që përmbajnë ose janë të kontaminuara nga lëndë radioaktive, koncentrimi ose veti radioaktive, që rrjedhin nga aktiviteti njerëzor.

Y1 Mbetjet klinike nga shërbimi mjekësor në spitale, qendra dhe klinika mjekësore

Y2 Mbetje prej prodhimit dhe përgatitjes së produkteve farmaceutike.

Y3 Mbetje farmaceutike barnash e medikamentesh.

Y4 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të biocideve dhe fitofarmaceutikëve.

Y5 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të kimikateve mbrojtëse për drurin.

Y6 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të solventeve organikë.

Y7 Mbetje prej trajtimit me nxehtësi dhe operacioneve të temperimit që përmbajnë cianure.

Y8 Mbetje vajrash minerale të papërshtatshme për përdorimin fillestar.

Y9 Mbetje vajrash, uji, hidrokarbure / përzierje ujrash, emulsione.

Y10 Mbetje substancash dhe artikujsh që përmbajnë ose janë të ndotura prej bifenileve ( PCB ) të poliklorinuar dhe / ose trefenileve të poliklorinuar (PCB) dhe / ose bifenileve të poliklorinuar (PBB).

Y11 Mbetje të mbeturinave të katranit të rrjedhura prej përpunimit, distilimit dhe çdo trajtimi pirolitik.

Y12 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të bojrave (shkrimi) ngjyruese, pigmenteve bojrave ( për të lyer ) vernikë.

Y13 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të rrëshirës, lateksit, plasticideve, lëndëve ngjitëse, tutkallit

Y14 Mbetje substancash kimike që rrjedhin prej punës kërkimore dhe zhvillimit të aktiviteteve misionare të cilat nuk janë identifikuar ose janë të reja dhe efektet e të cilave mbi njeriun dhe mjedisin nuk njihen.

Y15 Mbetje të natyrës eksplozive që nuk i nënshtrohen legjisllacioni tjetër.

Y16 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të kimikateve fotografike dhe materialeve të përpunimit.

Y17 Mbetje që rrjedhin nga trajtimi sipërfaqësor i metaleve dhe plastikave.

Y18 Mbetje prej operacioneve të asgjësimit të mbetjeve industriale.

**Mbetjet që kanë si përbërës:**

Y19 Karbonilet e metaleve

Y20 Beriliumi; komponimet e beriliumit

Y21 Komponimet e kromit heksivalent (6 valent)

Y22 Përbërësit e bakrit

Y23 Përbërësit e zinkut

Y24 Arsenik dhe përbërësit e arsenikut

Y25 Seleniumi dhe përbërësit e seleniumit

Y26 Kadmiumi dhe përbërësit e kadmiumit

Y27 Antimoni dhe përbërësit e antimonit

Y28 Teluri dhe përbërësit e telurit

Y29 Zhiva dhe përbërësit e zhivës

Y30 Taliumi dhe përbërësit e taliumit

Y31 Plumbi dhe përbërësit e plumbit

Y32 Përbërësat inorganikë të fluorit, florid kalciumi

Y33 Cianure inorganike

Y34 Solucione acide ose acide në formë solucioni

Y35 Solucione bazike ose baza në formë solucioni

Y36 Asbest (pluhur dhe fibra)

Y37 Përbërës fosforik organik

Y38 Cianide organike

Y39 Fenole, përbërës fenolesh duke përfshirë klorofenole

Y40 Etere

Y41 Solvente organikë të halogjenuar

Y42 Solvente organikë përveç solventeve të halogjenuar

Y43 Çdo kongjenor i dibenzo-furanit të poliklorinuar

Y44 Çdo kongjenor i dibenzo - p - dioksidit të poliklorinuar

Y45 Përbërësit organohalogjenor përveç atyre substancave të përmendura në këtë aneks (p.sh. Y39, Y41, Y42, Y43).

## B. MBETJET SHTËPIAKE

Y46 Mbeturinat e mbledhura prej ekonomive shtëpiake, që përfshijnë ujrat e zeza

Y47 Mbetjet që rrjedhin prej djegies të mbeturinave shtëpiake

## ANEKSI II

### LISTA E KARAKTERISTIKAVE TË RREZIKSHME

Klasifikimi sipas Kombeve të Bashkuara	Kodi	Karakteristikat
1	H1	Eksploziv. Një substancë ose mbetje eksplozive është një substancë ose mbetje e ngurtë ose e lëngët e cila në vetvete është e aftë që me reaksion kimik të prodhojë gaz me temperaturë dhe me një shpejtësi të tillë që mund t'i shkaktojë dëme mjedisit rrethues
3	H3	Lëngje të djegshme. Fjala “të djegshme” ka të njëjtin kuptim “djegëse”. Lëngje të djegshme janë lëngje ose përzierje lëngjesh që përmbajnë lëndë të ngurta në solucion ose pezull (psh. bojëra, vernikë etj., duke mos përfshirë substanca ose mbetje të ndryshme prej atyre të klasifikuara mbi bazën e karakteristikave të tyre të rrezikshme) të cilat prodhojnë një avull të djegshëm në temperaturë jo më shumë se 60.5 °C, (testi i Kupës së mbyllur) ose jo me shumë se 65.60 °C, (testi i Kupës së hapur). Meqenëse rezultatet e testeve të hapura dhe të mbyllura nuk janë të krahasueshme në mënyrë strikte, madje edhe rezultatet individuale të së njëjtit test janë shpesh të ndryshme, rregullat që variojnë nga shifrat e mësipërme për të aderuar për diferenca të tilla do të jenë brenda kuptimit të këtij përcaktimi.
4.1	H4.1	Lëndë të ngurta të djegshme. Lëndë të ngurta të djegshme ose mbetje të tjera përveç atyre të klasifikuara si eksplozivë, të cilat sipas kushteve që ndeshin gjatë transportit janë të gatshme për t'u djegur, mund të shkaktojnë ose kontribuojnë me djegie me anë të fërkimit.
4.2	H4.2	Substancat ose mbetjet e prirura për djegie spontane. Substancat ose mbetjet që janë të prirura për ngrohje normale sipas kushteve normale të ndryshuara gjatë transportit ose nxehjes në kontakt me ajrin dhe në këtë mënyrë të prirura për të marrë zjarr.
4.3	H4.3	Substancat ose mbetjet të cilat në kontakt me ujin çlirojnë gaze të djegshme. Substancat ose mbetjet të cilat duke ndërvepruar me ujin janë të prirura të bëhen të djegshme spontanisht ose të prodhojnë gaze të djegshme në sasi të rrezikshme.
5.1	H5.1	Oksidimi Substancat ose mbetjet të cilat ndonëse në vetvete nuk janë domosdoshmërisht të djegshme, duke çliruar oksigjen mund të shkaktojnë ose kontribuojnë në djegien e materialeve të tjerë.
5.2	H5.2	Perokside organike.



Substancat ose mbetjet organike të cilat përmbajnë strukturën bivalente -0-0. Janë substanca termalisht jo të qëndrueshme, të cilat mund të kalojnë një proces dekompozimi vetëshpejtues ekzotermik.

6.1 H6.1 Helmuese (Akute).

Substanca ose mbetje të prirura të shkaktojnë vdekje, dëmtime serioze, ose që dëmtojnë shëndetin e njeriut në qoftë se kapërdihen, merren me frymë ose me kontakt me prekje.

6.2 H6.2 Substancat infektuese

Substancat dhe mbetjet që përmbajnë mikroorganizma ose toksinat e tyre që njihen ose dyshohen se shkaktojnë sëmundje kafshëve dhe njerëzve.

8 H8 Gërryesit

Substanca ose mbetje me veprim kimik të cilat shkaktojnë dëmtim serioz kur bien në kontakt me indet e gjalla, ose me rast pikimi do të dëmtojnë materialisht madje dhe të shkatërrojnë mallra të tjera ose mjetet e transportit, apo gjithashtu mund të shkaktojnë rreziqe të tjera.

9 H10 Çlirimi i gazeve në kontakt me ajrin ose ujin

Substancat ose mbetjet të cilat në kontakt me ajrin ose ujin janë të prirura të çlirojnë gaze toksike në sasi të rrezikshme.

9 H11 Toksike (të vonuara ose kronike).

Substanca ose mbetje të cilat, në qoftë se merren me frymë, treten ose në qoftë se ato depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë efekte të vonuara ose kronike, duke përfshirë karcinogjenikët.

9 H11 Ekotoksike

Substanca ose mbetje të cilat në qoftë se çlirohen paraqesin ose mund të paraqesin efekte negative të menjëhershme ose të vonuara për mjedisin me anë të bioakumulimit dhe/ose efekte toksike mbi sistemet biotike.

9 H13 Të aftë që pas asgjësimit të çlirojnë

ndonjë material tjetër për shembull llum i lëngët, i cili posedon çdo njërin prej karakteristikave të dhëna me lart.

### ANEKSI III OPERACIONET E ASGJËSIMIT

Lista e operacioneve të asgjësimit që përmbahet në këtë aneks reflekton ato të cilat ndodhin ose kanë ndodhur në praktikë. Nuk reflekton domosdosh-mërisht listën e operacioneve të asgjësimit të pranuar. Në vijim të neneve 5 e 6 të këtij protokollit, mbetjet e rrezikshme në çdo rast duhet të menaxhohen në harmoni me mjedisin.

#### **A. Operacionet që nuk çojnë në mundësinë e riaftësisimit të burimeve, riciklimit, reklamimit, të ripërdorimit direkt ose të përdorimeve alternative.**

Seksioni A përfshin to gjithë operacionet e asgjësimit që ndodhin në praktikë.

D1 Depozitim brenda ose mbi tokë (p.sh. fushë depozitimi për mbetje)

D2 Trajtimi i tokës ( p.sh. biodegradimi i mbeturinave të lëngshme ose llumra në tokë etj.)

D3 Injektimi i thellë (injektimi i mbeturinave të pompuar në puse, kubet e kripës ose depozitat natyrale, etj.)

D4 Mbyllja sipërfaqësore (vendosja e mbeturinave të lëngëta ose llumrave në gropa të thata, pellgje ose laguna etj.)

D5 Fusha depozimi të projektuara në mënyrë të veçantë (psh. vendosja në qeli të radhitura veçmas të cilat janë të mbuluara dhe të izoluara nga njeriu dhe nga mjedisi etj.)

D6 Shkarkimi në ujë, përveç deteve dhe oqeanëve.

D7 Shkarkimi në dete, oqeanë duke përfshirë edhe futjen në shtratin e detit.

D8 Trajtimi biologjik që nuk specifikohet në ndonjë vend tjetër në këtë shtojcë i cili rezulton në përbërës ose përzierje përfundimtare të cilat flaken tej me anë të ndonjë operacioni të seksionit A.

D9 Trajtimi fiziko-kimik që nuk specifikohet në ndonjë vend tjetër në këtë shtojcë, që rezulton në përbërës ose përzierje përfundimtare që flaken tej me anë të ndonjë prej operacioneve të ndarjes A. (avullimit, tharjes, neutralizimit, përceptimeve etj)

D10 Djegie mbi tokë

D11 Djegie në det

D12 Grumbullimi i përhershëm (vendosja e kontenerëve në një minierë, etj.)

D13 Përzjerja përpara se t'i nënshtrohen njërit prej operacioneve në ndarjen A.

D14 Ripaketimi përpara se t'i nënshtrohen njerit prej operacioneve të ndarjes A.

D15 Grumbullimi që varet në çdo njërin nga operacionet në seksionin A

## **B. Operacionet që mund të çojnë në riaftësimin e burimeve, riciklimin, rikuperimin, përdorimin direkt ose përdorimeve alternative.**

Seksioni B përfshin të gjitha ato operacione në lidhje me materialet e përcaktuara legalisht ose të konsideruara si mbetje të rrezikshme dhe të cilat për ndryshe do të kishin qenë të destinuara për operacionet e përfshira në seksionin A.

R1 Përdorimi si lëndë djegëse (përveç atij në djegie direkte) ose çdo mjet tjetër për të prodhuar energji.

R2 Rikuperimi / regjenerimi i solventeve.

R3 Riciklimi / rikuperimi i substancave organike që nuk përdoren si solvente.

R4 Riciklimi / rikuperimi i metaleve dhe komponimeve të tyre.

R5 Riciklimi / rikuperimi i materialeve inorganike.

R7 Riaftësimi i komponenteve të përdorur në pakësimin e ndotjes.

R8 Riaftësimi i komponentëve të katalizatorëve.

R9 Vajra të përdorura të rirafinuara ose ripërdorime tjera të vajit të përdorur më parë.

R10 Trajtimi i tokës në dobi të bujqësisë ose përmirësimit ekologjik.

R11 Përdorimet e materialeve të mbetjeve të fituara prej njërit prej operacioneve nga R1 deri në R10.

R12 Shkëmbimi i mbetjeve për nënshtrimin ndaj çdo njërit prej operacioneve nga R1 deri në R10

R13 Akumulimi i materialit që synohet dhe nevojitet për çdo operacion në seksionin B.

## **ANEKSI IV (A)**

### **INFORMACIONI QË DUHET TË SIGUROHET NGA NJOFTIMI**

1. Arsyeja për eksportin e mbetjeve
2. Eksportuesi i mbetjeve 1/
3. Prodhuesit e mbetjeve dhe vendi i prodhimit 1/
4. Importuesi dhe asgjësuesi i mbetjeve dhe vendi aktual i asgjësimit 1/
5. Transportuesit e parashikuar të mbetjeve ose agjentët e tyre, në qoftë se njihen 1/
6. Vendi i eksportit të mbetjeve      Autoriteti kompetent 2/
7. Vendet e parashikuara për tranzit.      Autoriteti kompetent 2/
8. Vendi i importimit të mbetjeve,      Autoriteti kompetent 2/
9. Data(t) e projektuara të ngarkesës dhe periudha e kohës gjatë së cilës do të eksportohen dhe intinerari i propozuar (duke përfshirë pikën e hyrjes dhe daljes) 3/
10. Mjetet e parashikuara të transportit (në rrugë automobilistike, hekurudhore, detare, ajrore, ujrat e brendshme).
11. Informacion në lidhje me sigurimin 4/
12. Emërtimi dhe përshkrimi fizik i mbetjeve duke përfshirë numrin Y dhe numrat UN si dhe përbërjen e tyre 5/ dhe informacionin mbi kërkesat e ndonjë trajtimi të veçantë duke përfshirë nevojat emergjente në rast aksidenti.
13. Tipi i paketimit i parashikuar
14. Tipi i parashikuar në peshë/volumi 6/
15. Procesi në të cilin janë prodhuar mbetjet
16. Kodi sipas Aneksit 1, klasifikimet sipas Aneksit 2, numrin H dhe klasifikimin U.N.
17. Metoda e asgjësimit si për Aneksin III
18. Deklarimi prej prodhuesit dhe eksportuesit që informacioni është i saktë.
19. Informacion i transmetuar (duke përfshirë përshkrimin teknik të impiantit) eksportuesit ose prodhuesit nga asgjësuesi i mbeturinave mbi të cilat ky i fundit ka bazuar vlerësimin e tij që nuk ka asnjë arsye të besojë që mbetjet nuk do të trajtohen në një mënyrë të plotë nga ana mjedisore në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit të importit.

20. Informacion në lidhje me kontratën midis eksportuesit dhe asgjësuesit.

#### SHËNIME

1. Emri i plotë dhe adresa, numri i telefonit, teleksit, faksit dhe e-mailit të personit me të cilin duhet kontaktuar
2. Emri i plotë dhe adresa, numri i telefonit, teleteksit, faksit
3. Në rastin e një njoftimi të përgjithshëm që mbulon disa transportime, datat e parashikimit të secilit transportim ose në qoftë se kjo nuk duhet, frekuenca e parashikuar e transportimeve do të kërkohen.
4. Informacioni që duhet të jepet për kërkesat e sigurimit përkatës dhe si plotësohen ato nga eksportuesi, transportuesi dhe asgjësuesi.
5. Natyra dhe koncentrimi i përbërësve më të rrezikshëm në kushtet e toksicitetit dhe rreziqeve të reja të paraqitura nga mbetjet si në trajtim edhe në metodën e propozuar të asgjësimit.
6. Në rastin e një njoftimi të përgjithshëm që mbulon disa transportime, do të kërkohen si sasia totale e vlerësuar dhe sasitë e vlerësuara për çdo transportim individual.
7. Për aq sa kjo është e nevojshme për të vlerësuar reaksionin dhe të përcaktojë përshtatshmërinë e operacionit të propozuar të asgjësimit.

#### ANEKSI IV (B)

### INFORMACION QË DUHET TË JEPET MBI DOKUMENTAT E LËVIZJES

1. Eksportuesi i mbetjeve 1/
2. Prodhuesi(t) e mbetjeve dhe vendi i prodhimit 1/
3. Asgjësuesi i mbetjeve dhe vendi aktual i asgjësimit. 1/
4. Transportuesit (t) e mbetjeve 1/ ose agjentët e tij
5. Data e fillimit të lëvizjes ndërkufitare dhe data (t) dhe nënshkrimi i markës për çdo person që mban përgjegjësi për mbetjet.
6. Mjetet e transportit (rrugë automobilistike, hekurudhore, rrugët e ujrave të brendshme, rrugë detare, ajrore) duke përfshirë vendet e eksportit, tranzitit dhe importit, si edhe pikën e hyrjes dhe daljes ku këto janë caktuar.
7. Përcaktimi i përgjithshëm i mbetjeve/gjendja fizike, emri i duhur i ngarkesës UN dhe klasifikimit numri UN, Y dhe H si të aplikueshme.
8. Informacion mbi kërkesat e trajtimit të veçantë duke përfshirë dhënien emergjente në rast aksidentesh.
9. Tipi dhe numri i paketimeve.
10. Sasia në peshë / volum.
11. Deklarata nga prodhuesit ose eksportuesit që informacioni është i saktë.

12. Deklarata nga prodhuesi ose eksportuesi që përmban asnjë kundërshtim prej autoriteteve kompetente të të gjithë shteteve të interesuara të cilat janë palë.

13. Vërtetimi prej asgjësuesit i marrjes dhe pajisjes në vendin e caktuar të asgjësimit dhe ndikimi i metodës së asgjësimit dhe i datës së përafërt të asgjësimit.

14. Dokumenti i sigurimit, kredi ose garanci tjetër që mund të kërkohet nga palët, siç thuhet në nenin 6, paragrafi 5.

#### SHËNIME

1 Protokollit mbi Parandalimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Lëvizjet Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin është miratuar më 1 Tetor 1996 nga Konferenca e të Plotfuqishmëve të Protokollit mbi Parandalimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Lëvizjet Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre, i mbajtur në Izmir. Protokollit nuk ka hyrë akoma në fuqi.

2 Për qëllimet e këtij protokollit, Monako do të ketë të njëjtat të drejta dhe detyrime si shtetet antare të OECD.